



Financuar nga
Bashkimi Evropian

unicef 
për çdo fëmijë

VLERËSIM

MBI EFEKTIVITETIN E MASAVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËS **VIKTIMË** APO DËSHMITARË TË DHUNËS

Shtator, 2025



Vlerësimi mbi efektivitetin e masave për mbrojtjen e fëmijës viktimë apo dëshmitarë i dhunës është zhvilluar në kuadër të projektit *Mbrojtja e fëmijëve të cenueshëm në Kosovë*, i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian në Kosovë dhe implementuar nga UNICEF në Kosovë¹, në bashkëpunim me Koalicionin e OJQ -ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF.

Mohim përgjegjësie:

Pikëpamjet e shprehura në këtë vlerësim janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikat ose qëndrimet zyrtare të KOMF, UNICEF, dhe BE apo ndonjë institucioni tjetër të përfshirë. Është bërë çdo përpjekje për të siguruar saktësinë e informacionit të paraqitur, bazuar në të dhënat dhe materialet e disponueshme në kohën e hartimit.

Përgatitur nga:

Z. Ardian Klaiqi, Ekspert Ligjor

¹Të gjitha referencat për Kosovën duhet të kuptohen duke iu referuar Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

TABELA E PËRMBAJTJES

KAPITULLI I: SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME	7
1.1. Përmbledhje ekzekutive	7
1.2. Hyrje	8
1.3. Metodologjia	10
1.4. Kufizimet dhe konsideratat etike	12
1.5. Numri i fëmijëve në kontakt me ligjin	12
KAPITULLI II: MBROJTJA E FËMIJËS VIKTIMË DHE DËSHMITARË	18
2.1. Baza Ligjore	19
2.2. Institucionet e mandatuara	22
2.3. Sistemi për mbrojtjen e fëmijës	23
2.4. Risitë ligjore	27
KAPITULLI III: PËRMBYLLJE	30
3.1. Të gjeturat e vlerësimit	31
3.2. Çka është synuar me këto risi dhe sa janë zbatuar ato?	31
3.2.1. Risitë në Kodin e Drejtësisë për të Mitur	32
3.2.2. Risitë në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës	54
3.2.3. Të gjeturat e përmbledhura që ndërlidhen me zbatimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur	64
3.2.4. Të gjeturat e përmbledhura që ndërlidhen me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës	68
3.3. Konkluzion	71
3.4. Rekomandimet	73
3.4.1. Rekomandimet afatshkurta:	73
3.4.2. Rekomandimet afat mesme dhe afat gjate:	77
3.5. Praktikat e mira	79
IV. ANEKSE	81
4.1. Burimet e referencave	82
4.2. Lista e profesionistëve të intervistuar, takimet e zhvilluara dhe grupet fokusit	86

SHKURTESAT

▪ ANJF	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
▪ BE	Bashkimi Evropian
▪ IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
▪ IML	Instituti i Mjekësisë Ligjore
▪ KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
▪ KDFKB	Komiteti për të Drejtat e Fëmijës i Kombeve të Bashkuara
▪ KDM	Kodi i Drejtësisë për të Mitur
▪ KP	Kodi Penal
▪ KPPK	Kodi i Procedurës Penale
▪ KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
▪ KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
▪ KOMF	Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
▪ LMF	Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës
▪ MD	Ministria e Drejtësisë
▪ OAK	Oda Avokatëve të Kosovës
▪ OJQ	Organizata jo-Qeveritare
▪ OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
▪ QPS	Qendra për Punë Sociale
▪ UNICEF	Fondi Emergjent i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
▪ ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave

KAPITULLI I:

SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

1.1. Përmbledhje ekzekutive

Dhuna dhe format e saj të ndërlidhura përbëjnë një kërcënim serioz për mirëqenien fizike, psikologjike dhe emocionale të fëmijëve. Duke marrë parasysh pasojat afatgjata që dhuna mund të ketë në zhvillimin e tyre, komuniteti ndërkombëtar dhe shumë shtete kanë zhvilluar standarde të posaçme për mbrojtjen e fëmijëve, veçanërisht kur ata janë viktimë apo dëshmitarë të veprave penale.

Në këtë kontekst, Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe standardet ndërkombëtare e rajonale kanë nxitur ndërtimin e sistemeve të drejtësisë që vendosin theksin te një qasje miqësore dhe humane ndaj fëmijëve duke synuar mbrojtjen e tyre në të gjitha format, jo vetëm nga kryesit e veprave penale, por edhe nga neglizhenca institucionale apo dështimet profesionale brenda sistemit.

Kosova ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt harmonizimit të kornizës së saj ligjore me këto standarde, përmes miratimit të Kodit të Drejtësisë për të Mitur dhe Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës. Këto dy ligje përfshijnë masa mbrojtëse, garanci procedurale dhe mekanizma institucionale, që synojnë të sigurojnë një mbrojtje të gjithanshme për fëmijët në kontakt me sistemin e drejtësisë.

Ky vlerësim ofron një analizë të thelluar të zbatimit të masave dhe garancive procedurale në praktikën e drejtësisë për fëmijë në Kosovë, përmes shqyrtimit të kuadrit ligjor, strukturës institucionale, praktikave ekzistuese dhe sfidave kryesore në terren.

Pavarësisht përparimeve të arritura me miratimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur dhe Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, vlerësimi tregon se zbatimi praktik i këtyre ligjeve mbetet i mangët dhe shpesh i fragmentuar. Mungesa e njohurive të mjaftueshme profesionale për dispozitat ligjore, vonesat e konsiderueshme në miratimin e akteve nënligjore, mungesa e shërbimeve themelore si shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve viktimë apo një linjë funksionale për raportim, si dhe zbatimi i pjesshëm i masave mbrojtëse të përcaktuara me ligj, kanë ndikuar negativisht në efektivitetin e mbrojtjes së fëmijëve dhe në realizimin e të drejtave të tyre.

Këto mangësi jo vetëm që kufizojnë efikasitetin e sistemit të drejtësisë për fëmijë, por rrezikojnë gjithashtu viktimizimin e mëtejshëm të fëmijëve dhe cenimin e rëndë të drejtave të tyre themelore. Fëmijët viktimë apo dëshmitarë ndodh që nuk marrin trajtimin e duhur psikologjik, mbrojtjen nga rreziku apo ndihmën për t'u rikthyer në një jetë të sigurt dhe të qëndrueshme.

Në këtë kontekst, raporti nënvizon nevojën për ndërhyrje të menjëhershme dhe strategjike për të përmirësuar zbatimin e ligjeve ekzistuese, për të fuqizuar kapacitetet institucionale dhe profesionale, si dhe për të ndërtuar mekanizma bashkërendues ndërmjet institucioneve përkatëse. Një qasje gjithëpërfshirëse dhe e ndjeshme ndaj fëmijës është thelbësore për të garantuar mbrojtje reale dhe jo vetëm formale.

Rekomandimet e vlerësimit synojnë që të përshpejtojnë ndërtimin e një sistemi të drejtësisë për fëmijë që është më funksional, i drejtë, gjithëpërfshirës dhe në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve.

1.2. Hyrje

Në Kosovë, rreth 38% e popullatës është nën moshën 24 vjeçare, ndërsa afërsisht 28% e popullatës është e përbërë nga fëmijë² nën moshën 18 vjeçare³. Kjo përqindje e konsiderueshme e fëmijëve dhe të rinjve ndikon drejtpërdrejt zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, dhe i jep një rëndësi të veçantë garantimit të drejtave të tyre dhe mbrojtjes së tyre nga dhuna, abuzimi dhe neglizhenca. Si pasojë e këtij dinamizmi demografik, qëndrimi dhe trajtimi i fëmijëve, veçanërisht ata që janë në kontakt me ligjin, paraqet një prioritet të rëndësishëm për të ardhmen e Kosovës.



Ky realitet demografik e bën të domosdoshëm ndërtimin e një sistemi funksional të mbrojtjes së fëmijëve, që është i aftë të identifikojë, mbrojë dhe mbështesë fëmijët që janë viktimë apo dëshmitarë të dhunës. Sigurimi i një qasjeje të ndjeshme ndaj moshës dhe nevojave të fëmijëve është thelbësor për të mbrojtur jo vetëm jetën dhe dinjitetin e tyre, por edhe për të mundësuar rehabilitimin dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm në një mjedis të sigurt dhe mbështetës.

Kosova ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të ndërtuar një kornizë ligjore dhe institucionale që i njeh fëmijët si bartës të drejtave të njeriut dhe si pjesëmarrës aktivë në shoqëri. Në këtë kontekst, fëmijët gëzojnë jo vetëm të drejta universale, por edhe të drejta të veçanta që burojnë nga pozita e tyre e ndjeshme dhe nevoja

²Përkufizimet e përdorura në këtë vlerësim do të interpretohen sipas kuptimeve të dhëna në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, Kodin e Drejtësisë për të Mitur, Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe legjislacionin tjetër përkatës në Kosovë.

³Agjencia e Statistikave të Kosovës: Regjistrimi i fundit i popullsisë dhe ekonomive familjare 2024.

për mbrojtje shtesë, veçanërisht në rastet kur ata janë të ekspozuar ndaj dhunës, traumës ose situatave të tjera të rrezikshme.

Trajtimi i fëmijëve që janë viktimë apo dëshmitarë të dhunës kërkon një qasje të kujdesshme, ndër sektoriale dhe të koordinuar mes institucioneve të drejtësisë, shëndetësisë, arsimit dhe shërbimeve sociale. Çdo ndërhyrje ligjore apo institucionale ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e fëmijëve, prandaj duhet të bazohet në parimin e interesit më të mirë të fëmijës dhe në sigurimin e mbrojtjes nga viktimizimi i mëtejshëm.

Në këtë drejtim, gjatë viteve të fundit në Kosovë janë ndërmarrë iniciativa të rëndësishme për përmirësimin e mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve, përfshirë miratimin e ligjeve dhe zhvillimin e procedurave për trajtimin e fëmijëve viktimë apo dëshmitarë të dhunës në mënyrë të dinjitetshme dhe efektive. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të vlerësuar funksionimin praktik të sistemit dhe për të siguruar zbatimin e standardeve ndërkombëtare në të gjitha nivelet e mbrojtjes së fëmijës.

Realizimi i një vlerësimi të tillë bëhet veçanërisht i rëndësishëm në kontekstin e raportimeve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, të cilat shpesh paraqesin një pamje të përzier mbi funksionalitetin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë. Kjo kërkon një qasje analitike për të identifikuar boshllëqet ekzistuese dhe për të rekomanduar përmirësime konkrete.

Raporti i Bashkimit Evropian për Kosovën për vitin 2024 vë në pah *“miratimin e disa akteve nënligjore, por thekson si shqetësim kryesor mungesën e një sistemi të integruar për mbrojtjen e fëmijëve. Kjo përfshin mos funksionalizimin e shtëpive të mbrojtjes, mos funksionimin e linjës ndihmëse si dhe kapacitetet e pambajueshme të Qendrave për Punë Sociale, duke i lënë fëmijët viktimë dhe dëshmitarë pa përkrahjen e nevojshme dhe gjithëpërfshirëse”*.

Këto shqetësime përforcohen nga të dhënat e Anketës së Treguesve të Shumëfishtë (MICS, 2020), ku rezulton se 72% e fëmijëve të moshës 1–14 vjeç përjetojnë formë të disiplinës së dhunshme, ndërsa 1 në 7 prindër apo kujdestarë e konsiderojnë ndëshkimin fizik të domosdoshëm për edukimin e fëmijëve. Ky realitet i dhunës së normalizuar në mjediset familjare dhe sociale tregon për nevojën urgjente të ndërhyrjeve sistematike që mbrojnë fëmijët nga trauma, viktimizimi i mëtejshëm dhe ndikimet afatgjata në zhvillimin e tyre.

Krahasimi i raporteve dhe të gjeturave nga këto dhe burime të tjera tregojnë një mospërputhje të theksuar mes zhvillimeve ligjore dhe strukturave të ngritura për mbrojtjen e fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë, dhe zbatimit të këtyre masave në praktikë. Kjo mospërputhje ndikon drejtpërdrejt në sigurimin e mbrojtjes dhe rehabilitimit të duhur për këta fëmijë, duke e bërë të domosdoshëm realizimin e një vlerësimi gjithëpërfshirës.

Qëllimi i këtij vlerësimi është të analizojë dhe vlerësojë efektivitetin e ligjeve dhe politikave që mbrojnë fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në Kosovë, me një fokus të veçantë në masat ligjore dhe procedurat e zbatimit të tyre në praktikë. Ky vlerësim do të shqyrtojë sfidat që hasen në zbatimin e këtyre masave, të cilat janë thelbësore për sigurimin e mbrojtjes, sigurisë dhe rehabilitimin e fëmijëve që kanë përjetuar dhunë, si dhe për forcimin e mekanizmave ekzistues që sigurojnë mbrojtje efektive dhe të plotë.

Përmes këtij vlerësimi, do të identifikohen mundësitë për përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe avokimin për rritjen e kapaciteteve për mbrojtjen e fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë, përfshirë rritjen dhe alokimin e burimeve profesionale dhe financiare për institucionet përgjegjëse. Gjithashtu, do të shqyrtohet nevoja për forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe krijimin e strukturave më të sigurta dhe efektive për këta fëmijë, për të garantuar që ata të mund të zhvillohen dhe të integrohen në shoqëri në mënyrë të sigurtë dhe të barabartë me fëmijët e tjerë.

1.3. Metodologjia

Përgjatë realizimit të vlerësimit është përdorur një qasje e kombinuar e metodave cilësore dhe sasiore për mbledhjen dhe analizën e të dhënave dhe informacioneve, përfshirë rishikimin e literaturës, intervistat gjysmë të strukturuar dhe diskutimet në fokus grupe përmes punëtorive.

■ *Të dhëna statistikore dhe trendë*

Pjesë e rëndësishme e këtij vlerësimi ishte mbledhja dhe analizimi i të dhënave statistikore të siguruar nga Policia e Kosovës, Baza e të Dhënave në Ministrinë e Drejtësisë dhe një raporti të EULEX lidhur me fëmijët në kontakt me ligjin. Vëmendje e veçantë i është kushtuar statistikave që ndërlidhen me fëmijët viktimë të abuzimit seksual, veprave penale kundër integritetit seksual dhe format e mbrojtjes dhe procedurës së zbatuar për fëmijën viktimë apo dëshmitarë. Përmes

analizës së trendëve krahasuese ndër vite me theks të veçantë vitin 2023 dhe 2024, synohet të vlerësohet jo vetëm zhvillimi institucional dhe ligjor në këtë fushë, por edhe ndikimi praktik i tyre në jetën dhe mirëqenien e fëmijëve që përballen me sistemin e drejtësisë. Këto të dhëna shërbejnë si bazë për identifikimin e boshllëqeve dhe për orientimin e rekomandimeve për përmirësime të mëtejshme në funksion të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve.

■ *Rishikimi i literaturës*

Analiza dhe rishikimi i dokumenteve ka qenë një aspekt i rëndësishëm i zhvillimit të këtij vlerësimi. Janë konsultuar dhe analizuar dokumente dhe literaturë e disponueshme, të rëndësishme për detyrën, gjatë gjithë procesit të hartimit të vlerësimit. Vlerësimi është zhvilluar duke u bazuar në raportin fillestar dhe strukturën e cila është aprovuar nga palët e interesit, si dhe mbi legjislacionin ekzistues, raportet dhe vlerësimet e kryera deri më tani. Literatura e shqyrtuar është e bashkëngjitur në anekset në fund të këtij raporti.

■ *Angazhimi i palëve të interesit përmes konsultimeve aktive*

Gjatë procesit të hartimit, është siguruar komunikim i rregullt me zyrtarët përgjegjës në Ministrinë e Drejtësisë, KOMF dhe UNICEF Kosovë. Të gjitha veprimet dhe draftet janë ndarë dhe koordinuar me këta zyrtarë për të marrë komentet dhe miratimin e tyre përpara ndërmarrjes së hapave të mëtejshëm.

Procesi është udhëhequr nga parimi i besimit dhe pronësisë së institucioneve relevante të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë, me synimin për të arritur koherencë ndërmjet tyre.

Drafti i parë preliminar është prezantuar para Ministrisë së Drejtësisë dhe akterëve tjerë të institucioneve relevante, dhe komentet, sugjerimet dhe vërejtjet e tyre janë integruar në studim. Vlen të theksohet se gjatë gjithë procesit të zhvillimit, opinionet dhe nevojat e përfituesve, kanë qenë në qendër të punës. Është siguruar që zërat dhe pikëpamjet e tyre janë dëgjuar dhe marrë në konsideratë.

1.4. Kufizimet dhe konsideratat etike

Gjatë realizimit të këtij vlerësimi janë respektuar parimet bazë etike, përfshirë vullnetarizmin e pjesëmarrësve, konfidencialitetin, mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën për të refuzuar pjesëmarrjen në cilëndo fazë të procesit. Në veçanti, është treguar kujdes i shtuar gjatë trajtimit të informacionit që ndërlidhet me rastet praktike të ndara gjatë diskutimeve me profesionistët e fushës, duke u shmangur çdo formë rrezikimi ose stigmatizimi të pjesëmarrësve në vlerësim.

Megjithatë, vlerësimi është përballur me disa kufizime që kanë ndikuar në gjerësinë dhe thellësinë e analizës. Këto përfshijnë: qasjen e kufizuar në të dhëna zyrtare dhe statistika të përditësuara, mungesën e raporteve të detajuara mbi zbatimin praktik për format dhe masat mbrojtëse ndaj fëmijëve viktime dhe dëshmitarë në nivel lokal, si dhe kohën e kufizuar për një angazhim më të thelluar me të gjithë akterët përkatës.

Me gjithë dëshirën për të përfshirë zërin e fëmijëve që janë përballur me sistemin e drejtësisë, kjo nuk ka qenë e mundur për shkak të kufizimeve kohore.

Për shkak të këtyre kufizimeve kohore, nuk ishte e mundur të përmbusheshin të gjitha kërkesat formale për përfshirjen e drejtpërdrejtë të fëmijëve në procesin e vlerësimit. Si rrjedhojë, vlerësimi është fokusuar në grumbullimin e të dhënave përmes dokumentacionit ekzistues, intervistave me profesionistë dhe përfaqësues të institucioneve përkatëse, si dhe analizës së literaturës, duke u siguruar që nevojat dhe interesat e fëmijëve të mbeshin në qendër të gjithë procesit analitik.

1.5. Numri i fëmijëve në kontakt me ligjin

Numri i rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës

Gjatë vitit 2023 në Policinë e Kosovës janë raportuar gjithsej 135 raste të veprave penale kundër integritetit seksual e fëmijët si viktimë të këtyre veprave.




TABELA 1: Numri i veprave penale kundër integritetit seksual ku viktimja janë fëmijët

Gjatë vitit 2024 në Policinë e Kosovës janë raportuar gjithsej 101 raste të veprave penale kundër integritetit seksual e fëmijët si viktimë të këtyre veprave.




TABELA 2: Numri i veprave penale kundër integritetit seksual ku viktimja janë fëmijët

Të dhënat e Policisë së Kosovës për vitet 2023 dhe 2024 tregojnë për numra shqetësues lidhur me veprat penale kundër integritetit seksual ku viktimja janë fëmijët. Gjatë vitit 2023 janë regjistruar gjithsej 135 raste të tilla, ndërsa gjatë vitit 2024 ky numër ka rënë në 101 raste. Megjithatë, numri mbetet ende i konsiderueshëm dhe kërkon vëmendje të vazhdueshme nga institucionet përgjegjëse.

Në vitin 2023, veprat më të shpeshta ishin dhunimi me 64 raste, sulmi seksual me 37 raste dhe bashkësia jashtëmartesore me persona nën moshën 16 vjeç me 25 raste. Ndërkohë, janë evidentuar edhe raste të shërbimeve seksuale të viktimës së trafikimit, keqpërdorimit të fëmijëve në pornografi dhe raste të tjera.

Në vitin 2024, me gjithë uljen e përgjithshme të rasteve, vëmendja mbetet e lartë për veprat e dhunimit (35 raste) dhe sulmit seksual (29 raste), të cilat vazhdojnë të jenë më të shpeshtat në këtë kategori. Një rritje të lehtë ka pësuar bashkësia jashtëmartesore me persona nën 16 vjeç, ku janë raportuar 32 raste. Po ashtu, janë evidentuar edhe raste të degradimit të integritetit seksual, mundësimit ose detyrimit në prostitucion dhe marrëdhënieve seksuale brenda familjes, megjithëse në numër më të ulët.

Raste shqetësuese të përfshirjes së fëmijëve si viktima të veprave penale kundër integritetit seksual janë evidentuar edhe në vitet paraprake, siç theksohet në një raport të EULEX-it të publikuar në vitin 2022. Sipas të dhënave statistikore të siguruara nga EULEX⁴, gjatë periudhës 2019 deri në 2021, në Policinë e Kosovës janë raportuar gjithsej 228 raste të klasifikuara si dhunim, ku një përqindje mjaft e madhe janë fëmijë. Shpërndarja vjetore e këtyre rasteve është si vijon:




TABELA 3: Numri i rasteve të dhunimit të raportuara

⁴European Union Rule of Laë Mission in Kosovo. Assessment of the Handling of Rape Cases by the Justice System in Kosovo. Monitoring Report. July 2022

Sipas këtij raporti, një tjetër trend shqetësues i vërejtur është se shumica dërrmuese e viktimave janë vajza të mitura (në 85% të rasteve), siç dëshmohet edhe nga të dhënat e pranuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML), ku të gjithë autorët e dyshuar rezultojnë të jenë meshkuj. Sipas këtyre të dhënave, gjatë periudhës 2019 deri në 2021, janë kryer gjithsej 245 ekzaminime klinike të viktimave të mundshme të dhunës seksuale, nga të cilat 217 kanë qenë femra dhe 28 meshkuj. Shpërndarja vjetore e ekzaminimeve është si vijon: 47 ekzaminime në vitin 2019, 92 në vitin 2020, dhe 106 në vitin 2021.

Numri i rasteve të nxjerra nga databaza⁵ për evidentimin e rasteve të dhunës në familje

Sipas të dhënave për vitin 2023, në këtë databazë janë evidentuar gjithsej 2,715 raste të viktimave të dhunës në familje. Nga këto, 178 raste përfshijnë viktimë të moshës 0 deri në 18 vjeç. Përqindja e rasteve të viktimave të dhunës në familje që i përkasin grup moshës 0–18 vjeç është rreth 6.56% e totalit të rasteve të regjistruara gjatë vitit 2023.




TABELA 4: Numri i viktimave të përgjithshme dhe fëmijëve viktimë tek rastet e dhunës në familje (2024)

Ndërsa, sipas të dhënave për vitin 2024, në këtë databazë janë evidentuar gjithsej 2,988 raste të viktimave të dhunës në familje. Nga këto, 220 raste përfshijnë viktimë të moshës 0 deri në 18 vjeç. Përqindja e rasteve të viktimave të dhunës në familje që i përkasin grupmoshës 0–18 vjeç është rreth 7.36% e totalit të rasteve të regjistruara gjatë vitit 2024.

⁵<https://md.rks-gov.net/publikimet/statistikat/>




TABELA 5: Numri i viktimave të përgjithshme dhe fëmijëve viktimë tek rastet e dhunës në familje (2024)

Në bazë të një krahasimi të dhënave për vitet 2019-2024 del që numri i përgjithshëm i viktimave të dhunës në familje është në rritje në çdo vit me një rritje shqetësuese.




TABELA 6: Trendi i rasteve të veprave penale dhuna në familje ndër vitet 2019-2024

Të dhënat e nxjerra nga kjo databazë për periudhën 2019–2024 tregojnë një rritje të vazhdueshme dhe shqetësuese të numrit të viktimave të dhunës në familje në Kosovë. Numri total i rasteve është rritur nga 1,987 raste në vitin 2019, në 2,988 raste në vitin 2024, duke reflektuar një rritje prej mbi 50% brenda gjashtë vitesh.

Një element konsistent dhe shqetësues në të gjitha vitet është ndarja gjinore e viktimave:

- Gratë dhe vajzat përbëjnë shumicën absolute të viktimave, duke përfaqësuar mesatarisht mbi 75% të rasteve çdo vit.
- Në vitin 2019, nga 1,987 raste, 1,592 ishin femra, ndërsa 386 meshkuj.
- Deri në vitin 2024, kjo shifër është rritur në 2,385 viktima femra dhe 603 meshkuj, duke treguar se megjithëse numri i viktimave meshkuj po rritet në mënyrë graduale, dhuna në familje vazhdon të mbetet një fenomen që prek më së shumti gratë.

Grafiku më sipër e ilustron qartë këtë trend, ku vihet re një ngjitje progresive në të tri kategoritë: totali, femrat dhe meshkujt, por me një dominancë të qartë të viktimave femra.

Mungesa e të dhënave të kategorizuara dhe mospërputhja e të dhënave:

Ngjashëm me vërejtjet lidhur me të dhënat për numrin e kryesve të mitur, edhe në rastin e viktimave të dhunës është evidentuar mungesa e të dhënave të nën-kategorizuara sipas kriterëve kyçe, si: mosha (cilat mosha specifike), forma specifike e dhunës brenda familjes apo cili lloj i dhunës (lloji i veprës penale), si dhe aspekte të tjera statusore dhe kontekstuale. Kjo mungesë e kategorizimit të thelluar e bën të pamundur një analizë gjithëpërfshirëse dhe ndikon negativisht në hartimin e politikave të bazuara në evidencë.

Për më tepër, në disa raste është vërejtur mospërputhje ndërmjet të dhënave të ofruara nga burime të ndryshme institucionale, gjë që krijon pasiguri në lidhje me saktësinë dhe koherencën e informacionit. Këto mangësi e komplikojnë procesin e monitorimit të gjendjes në terren, zvogëlojnë besueshmërinë e raportimit dhe pengojnë marrjen e vendimeve të informuara për ndërhyrje të synuara dhe efektive.

KAPITULLI II:

**MBROJTJA E
FËMIJËS VIKTIMË
DHE DËSHMITARË**

2.1. Baza Ligjore

Legjislacioni vendor

Në Kosovë ekziston një korpus i gjerë i akteve juridike që rregullojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve, përfshirë fëmijët në kontakt me ligjin, duke filluar nga Kushtetuta si akti më i lartë juridik, e deri te aktet nënligjore që përcaktojnë standardet e zbatimit praktik.

Edhe pse Kosova nuk është formalisht nënshkruese e konventave ndërkombëtare për shkak të statusit të saj ndërkombëtar, neni 22 i Kushtetutës së Kosovës siguron zbatimin e drejtpërdrejtë të një numri të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ndër të cilat përfshihet edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës (paragrafi 7). Kushtetuta jo vetëm që e inkorporon këtë Konventë në rendin e brendshëm juridik, por gjithashtu i jep përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera në rast konflikti, duke theksuar se:



“Të drejtat dhe liritë e garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.”

Duke marrë parasysh këtë bazë kushtetuese, si dhe nevojën për mbrojtje të posaçme të fëmijëve për shkak të papjekurisë së tyre fizike dhe mendore, neni 50 i Kushtetutës rregullon drejtat themelore të fëmijëve, duke përcaktuar në paragrafin 1 se: *“Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre.”* Ndërsa në paragrafin 4 të njëjtit nen, përcaktohet qartë parimi i interesit më të mirë të fëmijës, duke theksuar se: *“Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.”*

Gjithashtu, në nenin 31, paragrafi 7, që ka të bëjë me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Kushtetuta përcakton se: *“Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.”*

Bazuar në dispozitat përkatëse të Kushtetutës, është zhvilluar një kornizë e gjerë ligjore që synon mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve, në veçanti të atyre që janë në

kontakt me ligjin. Në këtë drejtim, bazën themelore të infrastrukturës ligjore për drejtësinë për të fëmijë e përbëjnë këto akte kryesore:

- Kodi i Drejtësisë për të Mitur (Kodi Nr. 06/L-006)
- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (Ligji Nr.06/L-084)
- Ligji për Familjen (Ligji nr. 2004/32)
- Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare (Ligji nr. 08/L-255)

Një sistem penal i paanshëm, efektiv dhe human duhet të garantojë respektimin e të drejtave themelore të dyshuarve dhe autorëve të veprave penale, por edhe të viktimave, duke u mbështetur në parimin se viktimat duhet të trajtohen me dinjitet, respekt dhe ndjeshmëri. Fëmijët, si një kategori veçanërisht e cenueshme, për shkak të karakteristikave të tyre personale ose rrethanave të veprës penale, kanë nevojë për mbrojtje dhe trajtim të përshtatur me nevojat e tyre specifike.

Në përputhje me trendet globale dhe zhvillimet më të fundit në fushën e mbrojtjes së fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë, Kodi i Drejtësisë për të Mitur i vitit 2018 ka reflektuar këto përparime përmes përfshirjes së një sërë masash të avancuara. Ky zhvillim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi të drejtësisë për të mitur më gjithëpërfshirës, fleksibil dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare, i cili synon trajtimin, mbrojtjen, rehabilitimin si dhe ri-integrimin e fëmijëve në familje dhe shoqëri.

Në këtë kontekst, Kodi i Drejtësisë për të Mitur i vitit 2018 (Kodi Nr. 06/L-006) solli një sërë ndryshimesh dhe risish që synojnë avancimin e mbrojtjes dhe trajtimit të fëmijës si viktimë apo dëshmitar i veprës penale. Ky Kod paraqet një qasje bashkëkohore dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, duke përforcuar një sistem drejtësie që bazohet në parime si: interesi më i mirë i fëmijës, qasja miqësore, rehabilitimi dhe ri-integrimi i tij në shoqëri.

Ndryshimet e përfshira në këtë Kod shënojnë një kthesë të qartë në orientimin e sistemit të drejtësisë për fëmijë në Kosovë, duke i dhënë përparësi masave mbrojtëse ndaj fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë. Në këtë drejtim, pjesa e pestë e Kodit, përmes dy kapitujve dhe 26 neneve, rregullon aspektet e mbrojtjes së fëmijëve si viktimë dhe dëshmitarë në procedurën penale. Kjo përbën edhe ndërhyrjen më të madhe të bërë gjatë rishikimit të Kodit në vitin 2018.

Përmes këtyre dy kapitujve, është arritur që në mënyrë të konsiderueshme të rregullohet procedura e mbrojtjes së fëmijëve në sistemin penal, përmes përcaktimit të parimeve themelore, formave të mbrojtjes, institucioneve të përfshira dhe mekanizmave të nevojshëm të koordinimit ndërinstitutional.

Si një nevojë e kohës dhe për të avancuar më tej mbrojtjen e fëmijëve, veçanërisht atyre viktimë dhe dëshmitarë, në vitin 2019 u miratua Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës. Ky ligj shënon një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi të integruar për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë, në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës.

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës vendos bazat për një sistem të integruar dhe funksional të mbrojtjes së fëmijës, duke përfshirë masat për parandalimin, reagimin dhe mbështetjen ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit. Ai garanton zhvillimin e fëmijës në një ambient të sigurt dhe nxit bashkëpunimin ndërinstitutional në nivel lokal dhe qendror.

Ligji përmban dispozita të detajuara për të drejtat themelore të fëmijës, mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e tyre dhe përcakton përgjegjësinë e aktorëve shtetërorë, komunitetit dhe individëve. Gjithashtu, ai parasheh krijimin e shërbimeve mbështetëse si shtëpi për mbrojtjen e fëmijës, linja të ndihmës, ndihmë juridike dhe shërbime rehabilituese. Për moszbatim të ligjit, parashihen masa ndëshkuese për individë dhe subjekte juridike.

Instrumentet regjionale dhe ndërkombëtare

Masat për mbrojtjen e fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë rrjedhin nga një sërë instrumentesh ndërkombëtare dhe rajonale, të cilat përbëjnë bazën normative për zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi të drejtësisë penale dhe civile që është në përputhje me të drejtat e fëmijës dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve në kontakt me ligjin. Këto instrumente janë të njohura dhe zbatueshme edhe Kosovë.

Instrumentet kryesore ndërkombëtare që shërbejnë si bazë ligjore dhe rregullatorë përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- *Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës* (1989)
- *Protokolli Fakultativ i KDF mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve*, 2000
- *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut* (ECHR), 1950

- *Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual (Konventa e Lanzarote-s), 2007*
- *Konventa e Këshillit të Evropës për Veprim Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 2005*
- *Konventa për Luftimin e Krimeve Trans nacionale të Organizuar (Palermo), 2000, dhe Protokollat përkatëse*
- *Direktiva 2011/93/BE për luftimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë*
- *Direktiva 2012/29/BE për standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit*
- *Direktiva 2011/36/BE për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave*
- *Rezoluta 2005/20 e KB - Udhëzimet në lidhje me çështje të drejtësisë, të cilat përfshijnë fëmijët viktimë dhe dëshmitarë të krimit*
- *Parimet Bazë të përdorimit të programeve të drejtësisë restauruese në çështjet penale 2002/12*
- *Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Veprimet ndaj Fëmijëve në Sistemin e Drejtësisë Penale (1997)*
- *Komentet e Përgjithshme të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, përkatësisht:*
 - *Komenti Nr. 10 (2007) mbi të drejtat e fëmijëve në drejtësinë për të mitur*
 - *Komenti Nr. 12 (2009) mbi të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar*
 - *Komenti Nr. 24 (2019) mbi të drejtën e fëmijës në sistemin e drejtësisë penale*
 - *Udhëzimet e Këshillit të Evropës për një Drejtësi Miqësore për Fëmijët (2010).*

2.2. Institucionet e mandatuara

Në bazë të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, si dhe akteve përkatëse nënligjore, institucionet kyçe për zbatimin efektiv të mbrojtjes së fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë përfshijnë: Prokurorinë, Policinë, Gjykatën, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, Qendrën për Punë Sociale, Ndihma Juridike Falas, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Shtëpia për Mbrojtjen e Fëmijës, Linja e Telefonit Ndihmës, Avokati, Institucioni i Avokatit të Popullit si dhe aktorë të tjerë të sektorit publik dhe joqeveritar.

- **Gjykata:** luan një rol qendror dhe të rëndësishëm në sigurimin e një procesi të drejtë dhe ligjor për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata është e obliguar të marrë masa që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, përfshirë shmangien e kontaktit të drejtpërdrejtë me të dyshuarin apo të pandehurin, intervistimin në hapësira të përshtatshme dhe pjesëmarrjen përmes video-lidhjes apo përdorimit të dhomës së veçantë. Gjykata gjithashtu duhet të urdhërojë që seancat ku dëshmon fëmija të zhvillohen pa praninë e publikut, duke ruajtur konfidencialitetin dhe privatësinë e fëmijës. Në bashkëpunim me të gjithë profesionistët e përfshirë, gjykata mundëson që fëmija të ketë mbështetje psikologjike dhe përfaqësim të interesave të tij gjatë gjithë procesit gjyqësor. Këto masa janë të domosdoshme për të parandaluar ri viktimizimin dhe për të ruajtur mirëqenien emocionale dhe fizike të fëmijës gjatë procedurave ligjore.
- **Prokuroria:** garanton që fëmija viktimë apo dëshmitarë i krimit të jetë i mbrojtur dhe përfaqësuar gjatë gjithë procedurës penale. Prokurori për të mitur është përgjegjës për iniciimin dhe ndjekjen penale të veprave penale ku fëmijët janë të përfshirë si viktimë apo dëshmitarë, duke marrë masa për realizimin e të drejtave të tyre gjatë gjithë procesit gjyqësor. Në rastet kur ka indikacione për dhunë, abuzim apo trafikim, prokurori kërkon masa emergjente mbrojtëse dhe vendos kontakt me Policinë, Qendrën për Punë Sociale, Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndihmë Viktimave, Avokatin, Shtëpinë për Mbrojtjen e Fëmijës/Strehimoret etj. Gjithashtu, Prokuroria siguron që fëmijët të intervistohen sipas konceptit miqësor, në kushte të përshtatshme, duke shmangur kontaktin me të dyshuarin dhe duke përdorur profesionistë të trajnuar për intervistim. Me qëllim mbrojtjen nga ri viktimizimi, prokuroria mund të kërkojë që dëshmia e fëmijës të regjistrohet dhe të përdoret gjatë gjykimit pa pasur nevojë për paraqitje të drejtpërdrejtë në gjykatë.
- **Policia e Kosovës:** është një nga mekanizmat kryesorë në identifikimin, trajtimin dhe referimin e rasteve ku fëmijët janë viktimë apo dëshmitarë të krimit. Në rastet e raportimit të dhunës, abuzimit seksual, trafikimit ose ndonjë forme tjetër të keqtrajtimit, Policia ndërhyr menjëherë për të garantuar sigurinë e fëmijës dhe për të parandaluar dëmtimet e mëtejshme. Në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale dhe Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndihmë Viktimave, Policia referon rastet për mbrojtje emergjente dhe ndihmë psikologjike. Në procedurën penale, ajo gjithashtu kujdeset që fëmija të intervistohet në prani të profesionistëve të trajnuar dhe në ambiente miqësore për fëmijë, duke respektuar standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të miturve nga ri viktimizimi. Njësitë e specializuara në kuadër të Policisë së Kosovës luajnë rol të veçantë në trajtimin e këtyre rasteve.

- **Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave:** funksionon si një njësi e pavarur brenda Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe është përgjegjëse për mbrojtjen dhe përfaqësimin e viktimave të krimit në të gjitha fazat e procedurës penale. Ajo ka zyra në nivel qendror dhe regional në kuadër të prokurorive themelore dhe vepron në mënyrë të vazhdueshme, 24/7, në tërë territorin e Kosovës. Mbrojtësit e viktimave ofrojnë këshillim, përfaqësim dhe ndihmë për viktimat e dhunës në familje, trafikimit me qenie njerëzore, abuzimeve seksuale ndaj fëmijëve, dhunimeve, vrasjeve dhe formave të tjera të krimit. ZMNV ka mandat të institucionalizojë të drejtat e viktimave duke siguruar që ata të kenë qasje në drejtësi, të informohen për të drejtat e tyre, të përfaqësohen në polici, prokurori dhe gjykatë, dhe të referohen për mbështetje shtesë, kur është e nevojshme. Në rastet e fëmijëve viktimë apo dëshmitarë, mbrojtësi i viktimave luan rol kyç në sigurimin e mbrojtjes, mos ri viktimizimin dhe trajtimin e ndjeshëm gjatë gjithë fazave të procedurës penale.
- **Qendra për Punë Sociale:** është institucion kyç në mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve, veçanërisht kur ata janë viktimë apo dëshmitarë. QPS është përgjegjëse për vlerësimin e situatës së fëmijës, identifikimin e nevojave të tij dhe ndërmarrjen e masave për mbrojtje të menjëhershme dhe afatgjatë. Pas pranimit të një rasti nga policia apo institucione të tjera, QPS realizon intervistën fillestare, mbledh informacionin bazë, harton raportin social (anamnezën), dhe merr vendime për vendosjen e fëmijës në një mjedis të sigurt, përfshirë strehimin e përkohshëm në Shtëpitë për Mbrojtjen e Fëmijës nëse është e nevojshme. QPS koordinon veprimet me Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndhimën e Viktimave, Policinë, Prokurorinë, Gjykatat dhe organizatat joqeveritare për të siguruar që fëmija të marrë mbështetje psiko-sociale, ndihmë ligjore dhe mbrojtje nga çdo formë e mëtejshme e dhunës apo keqtrajtimit. Ato gjithashtu luajnë rol në rivlerësimin periodik të rrethanave të fëmijës dhe mbështesin rikthimin e tij në një ambient të sigurt familjar ose alternativa të tjera të kujdesit.
- **Agjencia për Ndhimë Juridike Falas:** është një institucion publik që ofron ndihmë juridike falas në të gjithë territorin e Kosovës, në përputhje me Ligjin për Ndhimë Juridike Falas⁶. Kjo ndihmë përfshin informim dhe këshilla juridike, përpilim të shkresave dhe përfaqësim në procedura civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse. ANJF ofron ndihmë juridike primare (këshillim, asistencë teknike, përfaqësim dhe mbrojtje në të gjitha fazat e procedurave) dhe sekondare (asistencë teknike dhe përfaqësim). Kjo ndihmë është e rëndësishme për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë të veprave penale që kanë nevojë për mbështetje ligjore, duke garantuar qasje të barabartë në drejtësi dhe duke kontribuar në

⁶LIGJI Nr. 04/L-017 & Ligji nr. 08/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-017 për Ndhimë Juridike Falas.

mbrojtjen e të drejtave të tyre përmes përfaqësimit të specializuar e falas në procedura gjyqësore dhe jashtëgjyqësore. Ky shërbim siguron mbështetje juridike për fëmijët dhe familjet e tyre që nuk mund të përballojnë shpenzimet për avokatë. Ai ndihmon fëmijët viktimë dhe dëshmitarë të kenë përfaqësim të duhur në procedurat ligjore dhe të sigurojnë të drejtat e tyre.

- **Instituti i Mjekësisë Ligjore:** ofron shërbime mjeko-ligjore dhe luan rol kyç në trajtimin e rasteve të dhunës, abuzimit dhe keqtrajtimit të fëmijëve. Instituti kryen autopsi mjeko-ligjore, ekzaminime klinike për viktimat e dhunës fizike dhe seksuale, analiza laboratorike të provave, si dhe shërbime tjera me urdhër të gjykatës apo prokurorisë. IML kontribuon në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve përmes ekspertizës së tij profesionale dhe bashkëpunon me institucionet e drejtësisë, përfshirë Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave, Qendrat për Punë Sociale dhe Policinë e Kosovës, për të garantuar mbështetje të integruar për viktimat dhe të miturit.
- **Avokatia:** është profesion i lirë i cili ofron ndihmë juridike dhe përfaqësim ligjor për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procedurat penale apo edhe procedura tjera nëse është e nevojshme (civile administrative dhe kundërvajtëse). Avokati si profesionist është i licencuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës dhe është i angazhuar për të siguruar mbrojtjen e të drejtave dhe interesave fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë, duke siguruar përfaqësim në polici, prokurori, gjykatë apo edhe institucione të tjera. Ai mund të ofrojë shërbime të tilla si këshillim juridik, përpilim të dokumenteve ligjore, përfaqësim dhe ndihmë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përmes procedurave të ndërmjetësimit ose arbitrazhit. Avokati gjithashtu është i angazhuar për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve viktimë të krimit, përfshirë viktimat e dhunës në familje dhe abuzimit, si dhe ndihmën për ata që kërkojnë ndihmë juridike falas.
- **Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP):** ka një rol kyç në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë, duke ofruar mbështetje ligjore, këshilla dhe përfaqësim në procedurat ligjore. IAP siguron që fëmijët të kenë qasje në drejtësi dhe të mos përballen me shkelje të drejtave të tyre, sidomos në raste dhune, abuzimi dhe trafikimi. Përmes ndërhyrjeve dhe masave mbrojtëse, Avokati i Popullit kontribuon në sigurimin e një trajtimi të drejtë dhe të shpejtë për fëmijët, duke monitoruar procedurat ligjore dhe rekomanduar përmirësime të politikave dhe praktikave për mbrojtjen e tyre në sistemin e drejtësisë.
- **Aktorët e tjerë të sektorit publik dhe joqeveritar:** Në përkrahje të këtyre institucioneve, shpeshherë përfshihen edhe organizata të shoqërisë civile, institucione edukative dhe profesionale, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetje të fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë, duke ofruar shërbime të

mbrojtjes, rehabilitimit dhe integritetit social, si dhe duke kontribuar në ngritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetje për zhvillimin e politikave mbrojtëse.

2.3. Sistemi për mbrojtjen e fëmijës

UNICEF-i, në strategjinë e tij për mbrojtjen e fëmijëve të vitit 2008, e përkufizon sistemin si një grup të ligjeve, politikave, rregulloreve dhe shërbimeve që nevojiten për të mbështetur fëmijët në parandalimin dhe reagimin ndaj rreziqeve të mbrojtjes. Ky sistem kërkon koordinim të ngushtë ndërmjet agjencive shtetërore, furnizuesve jo-shtetërorë dhe grupeve komunitare, duke përfshirë gjithashtu sistemet e referimit rutinë për të siguruar që të gjithë aktorët të punojnë në mënyrë të bashkërenduar dhe të efektshme.⁷

Përkufizimi i Sistemit për Mbrojtjen e Fëmijës

“Struktura të caktuara formale dhe informale, funksione dhe kapacitete që janë grumbulluar për të parandaluar dhe reaguar ndaj dhunës, abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve. Një sistem mbrojtjeje për fëmijët është përgjithësisht i pranuar të përbëhet nga këto komponentë: burimet njerëzore, financat, ligjet dhe politikat, qeverisja, monitorimi dhe mbledhja e të dhënave, si dhe shërbimet e mbrojtjes dhe reagimit dhe menaxhimi i kujdesit. Ai përfshin gjithashtu aktorë të ndryshëm – fëmijët, familjet, komunitetet, ata që punojnë në nivel ndërkombëtar ose kombëtar. Më e rëndësishmja janë marrëdhëniet dhe ndërveprimet midis këtyre komponentëve dhe këtyre aktorëve brenda sistemit. Janë rezultatet e këtyre ndërveprimeve që përbëjnë sistemin.”⁸

Në vitin 2012, përkufizimi i sistemit për mbrojtjen e fëmijëve u përmirësua, duke theksuar nevojën për një qasje të integruar që përfshin të gjitha nivelet e qeverisë dhe shoqërisë. Ky sistem ka si qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, si dhe siguron mbështetje për parandalimin e këtyre veprimeve dhe asistencën e fëmijëve që janë viktimë të tyre.⁹

Në një përkufizim tjetër më gjithëpërfshirës sistemi nënkuptohet si një rrjet i koordinuar dhe i integruar i ligjeve, politikave, rregulloreve, dhe shërbimeve që mbështesin parandalimin dhe reagimin ndaj rreziqeve të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve. Këto sisteme janë të lidhura ngushtë me mbrojtjen sociale dhe shtrihen

⁷Po aty,

⁸United Nations Children’s Fund, United Nations High Commissioner for Refugees, Save the Children and Eorid Vision, ‘A better way to protect all children: The theory and practice of child protection systems, conference report’, 2013, p.3.

⁹Po aty,

përtej saj, duke përfshirë sektorë të ndryshëm si drejtësia, mirëqenia sociale, arsimi, shëndetësia dhe siguria.¹⁰

Për të siguruar një mbrojtje të efektshme dhe gjithëpërfshirëse, ky sistem duhet të funksionojë si një mekanizëm i bashkërenduar, me përgjegjësi të qarta për secilin sektor dhe aktor, duke u siguruar që çdo fëmijë të ketë mbrojtjen e nevojshme dhe të sigurt në çdo situatë.

2.4. Risitë ligjore

Gjatë dekadës së fundit, ndryshimet ligjore në Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës kanë sjellë risi të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së fëmijëve viktime dhe dëshmitarë. Këto ndryshime janë thelbësore jo vetëm në aspektin e procedurave ligjore që duhet ndjekur gjatë trajtimit të rasteve, por edhe në aspektin e obligimeve shtetërore për ndërtimin e kapaciteteve të reja institucionale dhe njerezore.

Nëpërmjet këtyre reformave, është forcuar përgjegjësia e institucioneve për të ofruar fëmijëve viktime dhe dëshmitarë shërbime gjithëpërfshirëse, të cilat përfshijnë masa parandaluese, mbrojtëse dhe reaguese, të ndërtuara sipas standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijës në drejtësi penale.

■ *Risitë në Kodin e Drejtësisë për të Mitur:*

Risitë që ka sjellë KDM mbështeten në parimin themelor se viktimat duhet të vlerësohen me drejtësi dhe të trajtohen me respekt e dinjitet. Fëmijët viktime përbëjnë një kategori veçanërisht të cënueshme, si për shkak të karakteristikave të tyre personale, ashtu edhe për shkak të rrethanave të veprës penale. Për këtë arsye, ata duhet të përfitojnë nga një trajtim i përshtatur sipas nevojave dhe situatës së tyre specifike.

Në kuadër të rishikimit dhe ndryshimeve të ndërmarra në vitin 2018, KDM ka përfshirë disa risi të rëndësishme, ku ndër më të theksuarat janë rregullimi i mbrojtjes së fëmijëve si viktime dhe dëshmitarë në procedurat penale. Këto risi trajtohen në pjesën e pestë të Kodit, përmes dy kapitujve dhe gjithsej 26 neneve. Kjo ndërhyrje përfaqëson reformën më të thellë dhe më domethënëse në KDM që nga hyrja e tij në fuqi, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt përputhjes me standardet ndërkombëtare të drejtësisë për fëmijë.

¹⁰The UNICEF Child Protection Systems Strengthening Approach. September 2021. <http://www.unicef.org/media/110871/file/1.%20the%20unicef%20child%20protection%20systems%20strengthening%20approach.pdf>

Përmes këtyre dispozitave, fëmijëve që janë viktimë ose dëshmitarë u garantohet një sërë të drejtash dhe mbrojtjesh specifike, të cilat janë në përputhje të plotë me instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve në sistemin e drejtësisë penale. Këto risi përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- Gjykimin e madhorëve për veprat e kryera ndaj të miturve
- Hetimin e veprave të kryera ndaj fëmijëve nga ana e policëve të specializuar
- Interesin më të mirë të fëmijës si dhe parimet tjera të njohura në fushën e mbrojtjes së fëmijëve
- Veprimet procedurale ku parashikohet marrja në pyetje nga profesionistët dhe nën mbështetjen e psikologëve dhe në ambiente të posaçme, dhe përmes pajisjeve teknologjike, me prezencën e mbrojtësit etj
- Mbrojtjen e fëmijëve për të mos rënë në kontakt me kryesit e veprave penale
- Zyra për mbrojtje dhe ndihmë viktimave
- Mbrojtjen ligjore
- Masat dhe urdhrat mbrojtës
- Gjuha, përkthyesi dhe masat tjera të veçanta
- Ekzaminimet mjekësore dhe marrja e mostrave nga trupi
- Personi mbështetës nga Qendra për Punë Sociale
- Ambientet e pritjes
- Pajisjet në sallën e gjyqit
- E drejta për kthim dhe kompensim

■ **Risite në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës:**

Në kuadër të përpjekjeve për forcimin e mëtejshëm të mbrojtjes së fëmijës si viktimë apo dëshmitar, LMF ka sjellë risi të rëndësishme që përputhen me parimet e KDF dhe legjislacionit tjetër të zbatueshëm. Këto risi kanë ndërtuar një qasje gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e fëmijës, duke theksuar nevojën për krijimin e mekanizmave të rinj, ofrimin e shërbimeve adekuate, si dhe vendosjen e interesit dhe nevojave të fëmijës në qendër të çdo veprimi ligjor dhe procedural.

Këto zhvillime, së bashku me risitë e sjella nga Kodi i Drejtësisë për të Mitur (KDM), garantojnë një sërë të drejtash dhe masash mbrojtëse për fëmijët që janë viktima apo dëshmitarë, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve në sistemin e drejtësisë penale. Ndër risitë kryesore përfshihen, por nuk kufizohen vetëm në:

- Parimet e bazuara në KDF
- Themelimi i Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijës
- Linja Institucionale
- Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës
- Drejtësia miqësore
- Ndihma juridike dhe qasja në organet e drejtësisë
- Ndihma mjekësore, psikologjike, rehabilitimi dhe masat për re integrim etj.



KAPITULLI III: PÄRMBYLLJE

3.1. Të gjeturat e vlerësimit

Në bazë të vlerësimit të realizuar dhe analizës së detajuar mbi efikasitetin e masave për mbrojtjen e fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë në Kosovë, janë identifikuar një sërë të gjeturash kyçe që lidhen me sfidat strukturore dhe pengesat praktike, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zbatimin, efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e këtyre masave.

Nga njëra anë, është konstatuar se Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodi i Drejtësisë për të Mitur janë të avancuar në aspektin e standardeve që përmbajnë, duke dëshmuar një përkushtim të qartë institucional për promovimin e masave mbrojtëse dhe garancioneve procedurale në përputhje me parimin e interesit më të mirë të fëmijës. Ndërsa, nga ana tjetër, vlerësimi ka evidentuar sfida serioze në zbatimin praktik të këtyre dispozitave, ku shumica e institucioneve relevante kanë dështuar të përmbushin në mënyrë të qëndrueshme obligimet që burojnë nga ky kuadër ligjor

Të gjeturat e vlerësimit të realizuar janë kategorizuar në dy grupe kryesore, me qëllim të ofrimit të një pasqyre të qartë dhe të strukturuar mbi efikasitetin e sistemit të drejtësisë për fëmijë në raport me mbrojtjen e fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë:

- Së pari, pjesa që ndërlidhet me atë se çfarë synohet përmes risive të parashikuara në Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, veçanërisht në raport me masat dhe garancionet procedurale; sa janë këto dispozita në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe cili është niveli i zbatimit të tyre në praktikë (shih nënkapitullin 3.2, pjesa tabelare);
- Së dyti, pjesa që ndërlidhet me të gjeturat e përmbledhura lidhur me sfidat dhe pengesat që ndikojnë në zbatimin efektiv të këtyre masave dhe garancioneve, me synimin për të identifikuar faktorët pengues dhe boshllëqet sistematike që ndërlidhen me funksionimin e sistemit të drejtësisë për fëmijë.

3.2. Çka është synuar me këto risi dhe sa janë zbatuar ato?

Me risitë në Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës është synuar fuqizimi i mëtejshëm i sistemit të drejtësisë dhe mbrojtjes për fëmijët në Kosovë, duke siguruar një qasje më gjithëpërfshirëse, të ndjeshme ndaj moshës dhe të drejtuar nga interesi më i mirë i fëmijës.

3.2.1. Risite në Kodin e Drejtësisë për të Mitur

Gjykimi i personave madhorë për vepra penale të kryera ndaj fëmijëve		
Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit?
Kodi i Drejtësisë për të Mitur përfshin dispozita që zgjerohen përtej fushës së zakonshme të aplikimit të tij, për të siguruar mbrojtje efektive për fëmijët viktimë të veprave penale, edhe në rastet kur kryerësit janë persona madhorë. Neni 5, paragrafi 4 përcakton qartë se “Dispozitat e caktuara të këtij Kodi zbatohen ndaj personit madhor për veprat penale të kryera ndaj fëmijëve.” Kjo dispozitë ka për qëllim të sigurojë se fëmija i përfshirë në proces, qoftë si viktimë apo dëshmitar, përfiton nga të gjitha garancitë që ofron Kodi për të Mitur, edhe kur personi nën hetim ose gjykim nuk është i mitur. Në rastë kur zhvillohet procedurë e bashkuar ndaj të miturit dhe personit madhor, neni 44 i Kodit përcakton se një sërë dispozitash (nenet 40-43, 45-47, 60-63 dhe 66) zbatohen gjithmonë në lidhje me të miturin, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e të drejtave të tij gjatë procedurës penale. Po ashtu, nenet 71-73 të Kodit zbatohen pa përjashtim për të miturin në këto raste. Neni 108 i KDM-së përcakton se për një sërë veprash penale të rënda (36 lloj të veprave penale) që kanë si viktimë një fëmijë, edhe kur autori është person madhor, kompetenca i takon gjyqtarit apo trupit gjykues për të mitur. Për pjesët tjera të procedurës, Kodi lejon aplikimin e dispozitave për të rriturit, vetëm nëse ato nuk bien ndesh me mbrojtjen e të miturit dhe me natyrën e procedurës së përbashkët.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës, veçanërisht: Neni 3(1): “Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët... interesi më i mirë i fëmijës do të jetë një konsideratë parësore.” Neni 40(2)(b)(vii): Siguron të drejtën që çdo fëmijë i përfshirë në procedura penale të trajtohet me respekt të plotë për dinjitetin dhe të marrë mbrojtje të përshtatshme. Gjithashtu kjo dispozitë është harmonizuar me: ■ Direktivën 2012/29/BE për vendosjen e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, e cila parashikon mbrojtje të posaçme për fëmijët viktimë, pavarësisht nga statusi i autorit të veprës penale ■ Direktivën 2016/800/BE për garancitë procedurale për fëmijët në procedura penale, e cila, megjithëse kryesisht për fëmijët e akuzuar, mbështet parimin e mbrojtjes së fëmijës në çdo aspekt të procedurës.	Bazuar në intervista me akterë institucionale dhe analizën e vendimeve gjyqësore, rezultojnë se kjo dispozitë ka filluar të zbatohet në një nivel të kënaqshëm. Në të gjitha Gjykatat Themelore, është siguruar përbërja e duhur e trupave gjykues dhe janë respektuar aspektet kryesore procedurale për të miturit, edhe në rastet kur personi në gjykim është madhor. Megjithëse legjislati parashihet që rastet që përfshijnë të mitur të trajtohen nga gjyqtarë të specializuar për të mitur, në praktikë janë evidentuar vështirësi në sigurimin e vazhdimësisë së përcjelljes së rastit nga i njëjti gjyqtar për të mitur. Kjo paraqet sfidë të veçantë sidomos në fazat e procedurës paraprake dhe të kaktimit të masës së paraburgimit ndaj të rriturve të përfshirë në raste ku ka edhe të mitur. Në këto raste, gjyqtari për të mitur zakonisht shmanë pjesëmarrjen në fazat fillestare të procedurës për të mos u përjashtuar më pas nga shqyrtimi gjyqësor, gjë që ndikon në cenimin e vazhdimësisë dhe konsistencës së trajtimit të rasteve të ndjeshme.

Parimet për mbrojtjen e fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë në procedurat gjyqësore

Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Në përputhje me frymën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, çdo fëmijë që përfshihet në procedura gjyqësore si viktimë apo dëshmitar duhet të trajtohet me dinjitet, respekt dhe ndjeshmëri të lartë. Parimet e përfshira në KDM në nenin 110 dhe 111, garantojnë që procedurat të jenë të ndërtruara sipas nevojave të fëmijës: ■ Interesi më i mirë i fëmijës vendoset si konsideratë mbizotëruese në çdo veprim apo vendim që ka ndikim në të; ■ Fëmija trajtohet pa diskriminim, pavarësisht prejardhjes, gjinisë, moshës apo gjendjes shëndetësore; ■ Procedurat duhet të jenë miqësore ndaj fëmijëve, duke respektuar ndjeshmërinë e tyre dhe duke përshtatur qasjen sipas moshës, nivelit të zhvillimit dhe nevojave të veçanta; ■ Garantohet privatësia dhe konfidencialiteti, duke kufizuar çdo ekspozim të panevojshëm të informacionit personal apo të identitetit të fëmijës; ■ Ndalohet publikimi i çdo informacioni që mund të çojë në identifikimin e fëmijës, përveç rasteve kur lejohet shprehimisht nga gjykata; ■ Fëmija ka të drejtë të shprehë mendimet dhe opinionet e tij, të dëgjohet dhe të kontribuojë në vendimmarrjen që ndikon drejtpërdrejt në jetën e tij, veçanërisht gjatë procesit gjyqësor.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Neni 3 – Interesi më i mirë i fëmijës; Neni 12 – E drejta për t'u dëgjuar; Neni 16 – Mbrojtja e privatësisë dhe reputacionit) Udhëzimet e OKB-së për Drejtësinë për Fëmijët Viktimë dhe Dëshmitarë të Krimeve (Parime themelore: dinjiteti, ndjeshmëria, mbrojtja nga rreziku, privatësia, pjesëmarrja) Direktiva 2012/29/BE për vendosjen e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit (parashikon mbrojtje të posaçme për fëmijët viktimë në çdo fazë të procedurës) Direktiva 2016/800/BE për garantitë procedurale për fëmijët në procedura penale (Edhe pse fokusohet në fëmijët e akuzuar, përmban parime të përgjithshme që garantojnë qasje të përshtatshme dhe të drejtë për fëmijët në sistemin e drejtësisë).	Në krahasim me vitet e mëparshme është bërë përparim në aspekt të referimit tek këto parime, me theks të veçantë të parimit të interesit më të mirë të fëmijës. Megjithatë, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës¹¹ nuk e dokumentojnë dhe arsyetojnë gjithmonë këtë parim në vendimet e tyre. Në shumë raste, referenca mbetet më tepër një përshkrim tekstual se sa arsyetim i duhur që do të përputhej me thelbin e vendimit. Në Raportin Vjetor 2022¹², Institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar se në një rast të trajtuar, autoritetet përgjegjëse nuk kanë vepruar në përputhje me interesin më të mirë të fëmijës, duke dështuar të zbatojnë nenin 5 të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës. Në këtë rast, mungesa e kujdesit të duhur për historikun e ndjeshëm të fëmijës, përfshirë përvojat e mëparshme të abuzimit dhe rrezikun për rikthimin e situatave të ngjashme në të ardhmen, u identifikua si shkelje serioze e obligimeve ligjore të institucioneve. (Shih më tepër të gjeturat tek LMF-tabela mbi parimet)

¹¹ Profesionistët për mbrojtjen e fëmijës - nënkupton të gjithë personat, të cilët brenda mandatit të punës së tyre dhe në kontekstin e punës së tyre, janë në kontakt me fëmijën që ka nevojë për mbrojtje, ose kanë detyrë të përmbushin nevojat e fëmijës sipas këtij ligji apo ndonjë ligji tjetër në fuqi, standardi vendor apo ndërkombëtar (Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës Nr.06/L-084).

¹² <https://oik-rks.org/2023/03/31/raporti-vjetor-2022/>

Veprimet procedurale		
Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Neni 112 i KDM, përcakton disa rregulla baza në bazë të cilave të gjitha institucionet dhe profesionistët e përfshirë janë të obliguara të zbatojnë procedurën të posaçme. Këto rregulla përfshijnë por nuk kufizohen në: ■ Qasje të individualizuar dhe të ndjeshme, duke marrë parasysh moshën, gjininë, zhvillimin mendor dhe emocional, ambientin familjar dhe nevojat e veçanta të fëmijës; ■ Marrja në pyetje me ndihmën e profesionistëve (psikologë, pedagogë ose ekspertë të tjerë), në mënyrë që fëmija të ndihet i sigurt dhe i kuptuar; ■ Përdorimi i lokacioneve të përshtatshme ose teknologjive për të shmangur përballjen direkte me të pandehurin dhe për të lehtësuar pjesëmarrjen e fëmijës në mënyrë më të mbrojtur; ■ Kufizimi i marrjes në pyetje në maksimum dy herë; ■ Sigurimi i një përfaqësuesi të autorizuar për fëmijën në të gjitha fazat e procedurës penale; ■ Mundësia për regjistrimin audiovizual të dëshmisë si provë ligjore, dhe detyrimi për shkatërrimin e incizimeve pas një afati prej 5 vitesh nga hyrja në fuqi e vendimit gjyqësor; ■ Detyrimi i gjyqtarit për të njoftuar organin e kujdestarisë në rast se nga procedura dalin prova që tregojnë faktorë që kanë ndikuar në kryerjen e veprës penale, për të mundësuar ndërhyrje sociale dhe mbrojtëse në kohë.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Neni 3 Interesi më i mirë i fëmijës; Neni 12 E drejta për t'u dëgjuar; Neni 16 Mbrojtja e privatësisë; Neni 40 E drejta për trajtim të duhur në drejtësinë penale) Udhëzimet e OKB-së për Drejtësinë për Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë të Krimeve (Përcaktojnë kërkesa për intervistim të ndjeshëm, ambient të përshtatshëm, ndihmën e profesionistëve, mbrojtje ndaj përsëritjes së traumës etj.) Direktiva 2012/29/BE Procedura për mbrojtjen e viktimave fëmijë (Neni 20 deri 24 theksojnë nevojën për intervistim të kufizuar, ambiente të përshtatshme, praninë e psikologëve dhe përdorimin e teknologjisë për shmangien e përballjes me të pandehurin) Direktiva 2016/800/BE (Përfshin parime për ruajtjen e interesit më të mirë të fëmijës, mbrojtjen e privatësisë dhe ofrimin e mbështetjes psikologjike dhe ligjore gjatë procedurës)	Nga këto raste, u evidentuan 16 aktgjykime lirues¹³ (15 raste të lirim të dhe një rast refuzimi të aktakuzës). Arsyet e lirimit ishin të ndryshme, por më së shpeshti lidheshin me mungesën e provave të dhunës, duke përfshirë edhe raste kur nuk kishte dëmtime fizike në zonën gjenitale të viktimës, çka sipas gjykatave e bënte të pamundur vërtetimin e veprës. Një arsye tjetër e përsëritur ishte tërheqja e deklaratës nga ana e viktimës gjatë procedurës gjyqësore. Në një rast, viktimë deklaroi në gjykatë se kishte gënjer, dhe ndonëse raporti mjekësor përmbante dëshmi për mavijosje dhe lëndime trupore, gjykata vendosi aktgjykimin lirues. Në një tjetër rast, ndryshimi i deklaratave të viktimës gjatë fazave të ndryshme të procedurës (polici, prokurori, gjykatë) bëri që deklaratat e saj të konsiderohej jo e besueshme nga trupi gjyqësor. Në disa raste të tjera, gjykatat u mbështetën në konceptin e "përlqimit të nënkuptuar", duke marrë si arsye marrëdhëniet e mëparshme seksuale mes viktimës dhe të akuzuarit. Në një rast tjetër, gjykata arsyetoi lirin me faktin se viktimë kishte shkuar në vendin e ngjarjes me persona të panjohur, dhe prej kësaj nxori përfundimin se ajo kishte dhënë pëlqim të heshtur për marrëdhënie seksuale. Në pothuajse të gjitha aktgjykimet e analizuara, deklaratat e viktimës ka qenë prova kryesore. Viktimë shpesh është intervistuar tri herë: nga policia, prokuroria dhe gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor. Po ashtu, deklaratat e mjekëve dhe raportet e ekspertizës mjeko-ligjore, kur kanë qenë të disponueshme, janë përdorur si prova. Në këtë drejtim, një zhvillim pozitiv është fakti se numri i ekzaminimeve mjekësore të kryera dhe të përdorura në gjykime ka shënuar rritje progresive. Megjithatë, vlerësimet psikologjike të viktimës janë përdorur shumë rrallë si provë. Për më tepër, vetëm në pak raste janë paraqitur prova shtesë si kopje të komunikimeve përmes pajisjeve teknologjike dhe raporte të vendit të ngjarjes (me fotografi) gjatë procedurave gjyqësore përkatëse. Lidhur me secilën nga gjetjet në lidhje me të drejtat procedurale të parashikuara në Nenin 112, ju lutem shihni më poshtë tabelat përkatëse që përmbledhin dhe ilustronin këto të dhëna në mënyrë të detajuar.

¹³ Në lidhje me disa prej aspekteve procedurale të trajtuara në këtë nen, janë krahasuar me gjetjet të përgjigjedhura nga raporti vlerësues i EULEX (European Union Rule of Law Mission in Kosovo. Assessment of the Handling of Rape Cases by the Justice System in Kosovo. Monitoring Report. July 2022), i cili shqyrtoi 36 raste aktgjykime të natyrës së veprave penale kundër integritetit seksual.

Heqja e të drejtave për përkujdesje prindërore

Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Neni 113 I KDM, referohet rastit kur, gjatë zhvillimit të një procedure penale, del në pah se një prind: ■ Keqpërdor detyrat prindërore (p.sh. ushtrim i dhunës etj.); ■ I lë pas dore fëmijët (p.sh. braktisje, mungesë kujdesi bazik); ose ■ Shkel të drejtat e fëmijës (p.sh. e detyron të mos dëshmojë, e manipulon, e frikëson, etj.) Në këto raste, prokurori ka detyrimin ligjor të njoftojë organin e kujdestarisë, në mënyrë që të nisin procedurat jashtë kontestimore për heqjen e të drejtave prindërore. Një dispozitë të ngjashme e përcakton edhe Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës dhe legjislacionit përkatës, “...në situatat kur fëmija është i ekspozuar ndaj rrezikut të menjëhershëm apo të vazhdueshëm, për shkak të dhunës, neglizhencës apo abuzimit seksual nga prindi apo familjarët, autoritetet janë të detyruara të ndërmarrin masa për largimin e tij nga ambienti familjar”. Megjithatë edhe KDM dhe LMF dhe legjislacioni relevant, heqjen e kujdesit, e veçanërisht të drejtës prindërore, <u>e përcakton dhe shikon gjithnjë si masë të fundit</u>. Procedura dhe vendimmarrja duhet gjithmonë të udhëhiqen nga interesi më i mirë i fëmijës. Në rastet kur kujdesi dhe e drejta prindërore është hequr përkohësisht apo pjesërisht, duhet të rishikohet vendimi rregullisht me mundësi rikthimi të kujdesit apo të drejtës.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Neni 3 Interesi më i mirë i fëmijës si parim udhëheqës; Neni 9 E drejta e fëmijës për të mos u ndarë nga prindi, përveç nëse kjo është në interesin më të mirë të tij; Neni 19 – Mbrojtja nga dhuna, abuzimi dhe neglizhenca; Neni 20 – Mbrojtje e posaçme për fëmijët pa kujdes prindëror) Udhëzuesi i Kombeve të Bashkuara për Kujdesin Alternativ për Fëmijët (2009) (Përcakton se ndarja nga prindi duhet të jetë masa e fundit, dhe vendimi të bazohet në interesin më të mirë të fëmijës, me rishikim të rregullt të vendimit për rikthim të mundshëm të kujdesit). Direktiva 2012/29/BE (për të drejtat e viktimave) Nenet që kërkojnë vlerësim individual të rrezikut dhe masave mbrojtëse për viktimat nëse jetojnë me abuzuesin.	Fatkeqësisht nga rastet e analizuara dhe intervistat e zhvilluara del që kjo dispozitë asnjëherë deri më tani nuk është zbatuar në kuptim të heqjes së të drejtës për përkujdesje prindërore. Në disa raste të rralla ka pasur iniciativë për të filluar këtë procedurë mirëpo nuk është vazhduar më tutje. Kjo situatë është tejet shqetësuese, veçanërisht kur fëmija viktimë apo dëshmitar detyrohet të qëndrojë në të njëjtin ambient me abuzuesin, qoftë edhe pas përfundimit të vuajtjes së dënimit penal nga prindi. Një qasje e tillë jo vetëm që bie ndesh me standardet ligjore dhe etike të mbrojtjes së fëmijëve, por rrezikon seriozisht sigurinë dhe mirëqenien e tyre psikologjike dhe fizike. Për më tepër, një ndër gjetjet më shqetësuese lidhet me ndikimin e normave tradicionale dhe presionin e familjes së gjerë, të cilat shpeshherë e pengojnë zbatimin e dispozitës për heqjen e të drejtës për përkujdesje prindërore. Në praktikë, autoritetet hezitojnë të ndërmarrin veprime ligjore për largimin e fëmijës nga një ambient i rrezikshëm dhe abuziv, për shkak të frikës se një ndërhyrje e tillë do të stigmatizonte jo vetëm prindin por edhe tërë familjen apo fisin. Kjo situatë përbën një shembull të qartë të dominimit të normave dhe pritshmërive shoqërore tradicionale mbi parimin themelor të interesit më të mirë të fëmijës. Një qasje e tillë është thellësisht e papranueshme dhe dëshmon për boshllëqe të mëdha në zbatimin e standardeve të mbrojtjes së fëmijëve.

Fshtetësia e informacionit		
Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Neni 115 i KDM thekson detyrimin e të gjithë profesionistëve të përfshirë në çështje penale ku përfshihen fëmijë viktime apo dëshmitarë, që të ruajnë rreptësisht fshtetësinë e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Ky obligim është i vlefshëm për të gjithë, përfshirë policinë, prokurorinë, gjykatat, punëtorët socialë, psikologët, dhe çdo aktor tjetër institucional apo joqeveritar i përfshirë në mbrojtjen e fëmijës. Po ashtu ky nen përcakton përjashtimin e vetëm në rastet e specifikuara në nenin 12 paragraf 3, të KDM kur publikimi apo shpërndarja e informacionit bëhet për qëllime të procedurës apo mbrojtjes ligjore të fëmijës, gjithmonë në mënyrë të kufizuar dhe të kontrolluar.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Neni 16 Mbron të drejtën e fëmijës për privatësi, përfshirë mbrojtjen nga ndërhyrjet e paligjshme në jetën e tij private, familjare, reputacion dhe korrespondencë.) Udhëzimet e OKB-së për Drejtësinë për Fëmijët Viktime dhe Dëshmitarë të Krimeve (Kërkojnë mbrojtjen e identitetit dhe të dhënave personale të fëmijës në çdo hap të procesit penal. Theksojnë se informacioni rreth fëmijës duhet të jetë i qasshëm vetëm për personat përgjegjës dhe vetëm për qëllime të mbrojtjes ose ndjekjes ligjore në përputhje me interesin më të mirë të fëmijës). Direktiva 2012/29/BE për të Drejtat e Viktimave (Parashikon që viktimat e mitura të kenë të drejtën për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale, veçanërisht kur ato janë viktime të dhunës seksuale apo dhunës në familje).	Sa i përket nivelit të zbatimit, megjithëse korniza ligjore është e harmonizuar me standardet ndërkombëtare, zbatimi në praktikë paraqet sfida. (për më tepër rreth të gjeturave shih tabelën që ka të bëjë të drejtën e fëmijës për privatësi....)

Mbrojtja e fëmijëve nga kontakti me kryerësit e veprës penale

Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndër-kombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Neni 116 vendos masa të qarta parandaluese për të mbrojtur fëmijët nga rreziku i kontaktit me të rritur që kanë kryer ose janë nën hetim për vepra penale kundër fëmijëve, duke përfshirë në mënyrë të veçantë veprat penale të parashikuara në kapitullin XX (veprat penale kundër integritetit seksual) të Kodit Penal, siç është dhuni seksual dhe format tjera të abuzimit seksual ndaj fëmijëve. Dispozita përfshin dy drejtime të mbrojtjes: 1. Përfshatimi i detyrueshëm nga pozitat që përfshijnë punë me fëmijë: Çdo person madhor i dënuar me vendim të formës së prerë për një vepër penale të tillë nuk mund të konsiderohet kandidat për punësim apo angazhim në çdo institucion, organizatë apo shërbim që ofron shërbime për fëmijë, qoftë në arsim, shëndetësi, kujdes social, rekreacion, etj. Kjo është një masë mbrojtëse e përhershme, që synon të mbrojë fëmijët nga ekspozimi ndaj personave potencialisht të rrezikshëm; 2. Shmangia e kontaktit në rast të akuzës: Edhe nëse personi nuk është dënuar ende, por është akuzuar për vepër penale ndaj një fëmije, organizatat dhe institucionet që punojnë me fëmijë duhet të marrin masa të menjëhershme për të ndaluar kontaktin e tij me fëmijët. Këto masa mund të përfshijnë: pezullim nga detyra, zhvendosje në detyrë administrative pa kontakt me fëmijë, ose masa tjera mbrojtëse deri në përfundimin e procedurës. Përveç KDM, edhe LMF në nenin 58 përmban një ndalesë të ngjashme ku përcaktohet që: "Personat e dënuar për abuzim seksual, shfrytëzim të fëmijës, mundësim në prostitucion dhe pornografi të fëmijës ndalohej të ushtronte profesione [...] që përfshijnë çdo formë kontakti me fëmijët."	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Nenet 19 dhe 34 kërkojnë nga shtetet palë të mbrojnë fëmijët nga të gjitha format e dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit seksual) Udhëzimet e OKB-së për Drejtësinë për Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë të Krimeve, (theksojnë nevojën për shmangie të kontaktit me kryerësit e veprave penale) Udhëzimet për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve, (kërkojnë verifikim të të kaluarës penale për të gjithë personat që punojnë me fëmijë) Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Shfrytëzimi Seksual (Konventa e Lanzarotës), (detyron shtetet të zbatojnë ndalimin e punësimit të personave të dënuar për abuzim seksual në institucione që punojnë me fëmijë).	Pavarësisht se dispozita është e qartë, zbatimi i saj mbetet sfidues dhe i shokëruar me vonesa të konsiderueshme. Vërehet mungesë e një përcaktimi të qartë të përgjegjësiwe institucionale për monitorimin dhe zbatimin e ndalesës në rastet e ngritjes së aktakuzës apo pezullimit të përkohshëm nga detyra. Gjithashtu, niveli i koordinimit ndër-institucional mbetet i ulët, veçanërisht ndërmjet sistemit të drejtësisë, institucioneve arsimore, sociale dhe atyre shëndetësore, gjë që pengon zbatimin e njëtrajtshëm të këtyre masave parandaluese. Pavarësisht një vonese mbi gjashtëvjeçare, më 5 dhjetor 2024, Këshilli Gjyqësor i Kosovës miratoi Rregulloren Nr. 18/2024, e cila rregullon krijimin e Regjistrat të Personave të Dënuar për Vepra Penale kundër Integritetit Seksual, e cila hyri në fuqi më 1 janar 2025. Megjithatë, deri më tani regjistri nuk është funksionalizuar.

Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
KDM në nenin 119 garanton të drejtën e fëmijës viktimë apo dëshmitar për të qenë i informuar në mënyrë të menjëhershme, të qartë dhe të kuptueshme për të, duke përfshirë gjithashtu edhe përfaqësuesit e tij ligjorë, kujdestarin, mbrojtësin e viktimës apo personin tjetër të autorizuar. Informimi duhet të ndodhë që nga kontakti i parë me sistemin e drejtësisë dhe gjatë gjithë procesit gjyqësor. Kjo dispozitë përfshin informim për aspektet e mëposhtme, dhe ka një kuptim më të gjerë se sa vetëm njoftimi formal për këto të drejta. Ajo nënkupton edhe ndihmën dhe mbështetjen që duhet ofruar fëmijës viktimë apo dëshmitar në lidhje me këto të drejta dhe shërbime që janë dispozicion për ta: ■ Procedurat penale, roli i fëmijës si viktimë apo dëshmitar, mënyra dhe rëndësia e dhënies së dëshmisë, dhe procedurat e intervistimit; ■ Mekanizmat mbështetës, përfshirë caktimin e një përfaqësuesi apo asistenti për fëmijën gjatë procedurës; ■ Orarin dhe vendin e seancave, si dhe masat mbrojtëse që mund të ndërmerren; ■ Mjetet për shqyrtimin e vendimeve që mund të dëmtojnë interesin e fëmijës; ■ Të drejtat e fëmijës viktimë apo dëshmitar, përfshirë mundësinë për kompensim financiar nga kryesi i veprës penale apo nga institucionet; ■ Qasjen në shërbime shëndetësore, psikologjike dhe sociale, si dhe për ndihmë ligjore apo përkrahje emergjente; ■ Të dhëna për progresin e çështjes, përfshirë masa si arrestimi apo paraburgimi i të akuzuarit dhe çdo zhvillim tjetër i rëndësishëm në procesin penal.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Nenet 12 dhe 17 përcaktojnë të drejtën e fëmijës për të marrë informacion të përshtatshëm dhe për të marrë pjesë në proceset që e prekin). Udhëzimet e OKB-së për Drejtësinë për Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë të Krimeve (theksojnë se informimi duhet të jetë i plotë, i vazhdueshëm dhe i përshtatur sipas karakteristikave të fëmijës). Direktiva 2012/29/BE për të Drejtat e Viktimave (përcakton të drejtën e viktimave, përfshirë fëmijët, për të marrë informacion që është i qasshëm, i kuptueshëm dhe i përshtatur, duke përfshirë edhe përdorimin e gjuhës jo-teknike). Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual (Konventa e Lanzarote-s) kërkon që fëmijëve t'u sigurohet informacion i duhur për të kuptuar procesin gjyqësor dhe për të ushtruar të drejtat e tyre). Rregullat e Pekinit dhe Rregullat e Riadhit të OKB-së (edhe pse këto përcaktojnë rregulla për të miturit në konflikt me ligjin, gjithsesi rregullat e tyre mund të zbatohen për shtatshëmrisht edhe për kryesin kur është fjala për mbështetjen e parimit të informimit si pjesë e një procesi të drejtë dhe gjithëpërfshirës për fëmijët në kontakt me drejtësinë).	Fatqeqësisht, kjo e drejtë dhe shumë prej udhëzimeve të përcaktuara në këtë dispozitë nuk zbatohen fare, ose kur zbatohen, kjo ndodh në mënyrë jo të duhur dhe jo në frymën që synon ligji. Informimi që i bëhet fëmijës është kryesisht formal dhe procedural, i kufizuar vetëm në plotësimin e formularëve zyrtarë, në vend se të bazohet në qasjen përmbytëse dhe gjithëpërfshirëse që parashikon ligji. Nuk është rastësi që ligjvënisi ka theksuar: “Kjo dispozitë përfshin informim për aspektet e mëposhtme dhe ka një kuptim më të gjerë sesa vetëm njoftimi formal për këto të drejta...” Ajo që është edhe më shqetësuese është se formularët dhe njoftimet nuk analizohen dhe nuk përshtaten në mënyrë të duhur me moshën dhe statusin procedural të fëmijës viktimë. Kjo është theksuar edhe në një prej gjetjeve të raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit, ku thuhet: “Kur fëmija është dëgjuar si dëshmitar i dëmtuar, nuk ka qenë i mitur, andaj nuk mund të paralajmërohet se mund të ndiqet penalisht, kur dihet fakti se personat nën moshën 14-vjeçare janë penalisht të papërgjegjshëm... Prandaj, në këtë rast autoritetet përgjegjëse kishin dështuar ta zbatonin drejt pjesën e pestë të Kapitullit II të KDM.” Mosbatimi i duhur i dispozitave, ose zbatimi i tyre në formën e një “liste kontrolli”, ka sjellë ri-viktimizim të fëmijës viktimë të abuzimit seksual dhe ka rrezikuar interesin e saj për mbrojtje të duhur. Në të njëjtën kohë, kjo qasje ka mundur të sjellë përfitime procedurale për të pandehurit, gjë që bie ndesh me parimet themelore të drejtësisë për fëmijët. Po ashtu, shqetësues mbetet fakti se profesionistët përgjegjës, përfshirë pjesëtarët e policisë, prokurorët, zyrtarët socialë dhe mbrojtësit e viktimave, nuk komunikojnë dhe veprojnë në mënyrë të koordinuar. Komunikimi ndërmjet tyre shpesh ndodh në mënyrë të izoluar, jo të strukturuar. Një qasje dhe komunikim i tillë ndër institucionale ndodh, vetëm në raste të jashtëzakonshme, kur kemi të bëjmë me raste shumë të rënda ose kur një rast bëhet mediatic dhe mbi institucionet ushtrohet presion publik përmes mediave.

Mbrojtja ligjore		
Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Neni 120 i KDM specifikon qartë detyrimin institucional për të siguruar përfaqësim juridik për fëmijët viktimë të veprave penale. Ky nen bazohet në përshtatshmëri dhe i referohet nenit 63 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (ky nen tani me KPPK të ri është neni 64) dhe zbaton parimin e përfaqësimit të detyrueshëm dhe falas për fëmijët në procedura penale ku ata janë të përfshirë si viktima.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Neni 12 garanton të drejtën e fëmijës për të shprehur mendimin e tij lirshëm dhe përfaqësimin ligjor në procedura që prekin interesat e tij, pastaj nenet 37 dhe 40 nderlidhen me aspektet e të drejtës së fëmijëve për mbrojtje). Udhëzimet e OKB-së për Drejtësinë për Fëmijët Viktimë dhe Dëshmitarë të Krimeve (kërkojnë përfaqësim ligjor falas dhe të detyrueshëm për fëmijët viktimë në të gjitha fazat e procedurës penale). Direktiva 2016/800/BE (kërkon sigurimin e përfaqësimit falas dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktimë gjatë procedurave penale). Udhëzuesi i Këshillit të Evropës mbi Drejtësinë Miqësore të Fëmijëve (Child-friendly Justice Guidelines) (nënvizon nevojën për avokatë të specializuar dhe trajnime të vazhdueshme për trajtimin adekuat dhe ndjeshmërinë ndaj fëmijëve në procesin gjyqësor).	Në aspektin praktik dhe të sigurimit fizik të pranisë së avokatit apo mbrojtës të viktimave, kjo e drejtë zbatohet në të gjitha rastet. Oda e Avokatëve të Kosovës siguron praninë e avokatëve në procedurat përkatëse nëpërmjet angazhimit ex-officio, në të gjitha rastet kur fëmija është viktimë. Kjo praktikë pozitive është vendosur tashtme prej disa vitesh në Kosovë dhe të gjitha shërbimet që ofrohen nga avokatët mbulohen nga buxheti publik. Megjithë këtë praktikë pozitive sa i përket angazhimit të avokatëve dhe prezencës së mbrojtësve të viktimave, dhe faktin se fëmijët nuk paguajnë për shërbimet e mbrojtjes ligjore, profesionistët e intervistuar kanë shprehur dyshime dhe rezerva lidhur me cilësinë e këtyre shërbimeve, dhe nëse ato janë realisht në përputhje me nevojat specifike të fëmijëve viktimë apo dëshmitarë. Një tjetër shqetësim i ngritur ka të bëjë me dallimin e qasjes dhe angazhimit ndërmjet avokatëve të emëruar ex-officio dhe atyre të angazhuar me autorizim të drejtpërdrejtë nga familja e fëmijës. Në rastin kur avokati është angazhuar me autorizim, është vërejtur një përkushtim më i madh dhe një nivel më i lartë serioziteti nga ana e avokatëve. Gjithashtu, është theksuar mungesa e kapaciteteve të specializuara të avokatëve dhe mbrojtësve të viktimave, veçanërisht në drejtim të trajnimeve për komunikim të përshtatshëm me fëmijët, si dhe për garantimin e mbrojtjes së interesit më të mirë të tyre gjatë gjithë procesit gjyqësor dhe hetimor.

Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Neni 122 i KDM i garanton fëmijës viktima apo dëshmitarë jo vetëm të drejtën për përkthim, por thekson edhe përdorimin e një gjuhe të përshtatshme për fëmijët, si dhe sigurimin e masave mbështetëse shtesë sipas nevojave individuale, me synimin për të rritur pjesëmarrjen e fëmijëve në mënyrë të barabartë dhe jo traumatizuese në procedurat ligjore. Në paragrafët vijuese të këtij neni përcaktohen elementet shtesë të cilat e bëjnë më të lehtë komunikimin dhe përfshirjen e fëmijës në procedurë gjyqësore siç janë: 1. Gjuha e thjeshtë dhe e kuptueshme për fëmijën, një element shpesh i anashkaluar në praktikë, por thelbësor për përfshirje të vërtetë; 2. Përkthyes falas, kur fëmija nuk e kupton gjuhën e procedurës; 3. Masa shtesë për ndihmë të veçantë, për fëmijët me: ■ Aftësi të kufizuara; ■ Nevoja të veçanta psiko-sociale; ■ Rrezik për ri viktimizim; ■ Gjendje të cënueshme ekonomike. Të gjitha këto, sigurojnë një mbështetje esenciale për garantimin e të drejtës së fëmijëve për të kuptuar dhe për t'u përfshirë në mënyrë kuptimplotë në proceset gjyqësore ku janë të përfshirë si viktima apo dëshmitarë.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Nenet 12 dhe 13 përcaktojnë të drejtën e fëmijës për të marrë informacion në një formë të përshtatshme dhe të kuptueshme, që garanton pjesëmarrje aktive dhe të lirë). Udhëzimet e OKB-së për Drejtësinë për Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë të Krimeve (kërkojnë përdorimin e një gjuhe të përshtatshme për moshën dhe gjendjen psikologjike të fëmijës, si dhe masa mbështetëse për fëmijët me nevoja të veçanta). Direktiva 2012/29/BE e BE-së (kërkon që informacioni dhe ndërveprimi me viktimat, përfshirë fëmijët, të jenë në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke siguruar përkthyes falas kur është e nevojshme). Udhëzuesi i Këshillit të Evropës mbi Drejtësinë Miqësore të Fëmijëve (Child-friendly Justice Guidelines) (kërkon masa mbështetëse të përshtatura për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe për fëmijët në gjendje të cënueshme).	Përkthyesit gjyqësorë janë të pranishëm në të gjitha rastet kur fëmija nuk flet gjuhën e procedurës. Megjithatë, përkthyesit nuk janë gjithmonë të trajnuar për të komunikuar në mënyrë të ndjeshme dhe të përshtatshme për moshën e fëmijëve, gjë që cenon qasjen gjithëpërfshirëse dhe miqësore për ta. Zakonisht, përkthimi bëhet përmes një fjalori teknik dhe zyrtar, që mund të mos jetë i kuptueshëm për fëmijët, sidomos për ata më të vegjël. Për fëmijët me aftësi të kufizuara, në veçanti për fëmijët e verbër apo ata që janë shurdhë-memecë, ofrohet përkthim dhe komunikim në gjuhën e shenjave. Megjithatë, nuk ka të dhëna të qarta që konfirmojnë përdorimin e gjuhës Braille në komunikim me fëmijët me shikim të dëmtuar, dhe nuk dihet nëse ekzistojnë kapacitete për këtë formë të komunikimit alternativ. Për më tepër, përdorimi i një gjuhe të thjeshtë dhe të përshtatur për fëmijët mbetet i kufizuar, si në komunikimin verbal, ashtu edhe në dokumentacionin që iu dorëzohet fëmijëve.

Gjuha, përkthyesi dhe masa të tjera për ndihmë të veçantë		
Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
		Mungojnë materiale të standardizuara dhe trajnime për përkthyesit, mbi "qasjen miqësore dhe të përshtatshme për fëmijët". Gjithashtu, mungojnë protokolle të qarta për ndihmën e personalizuar për fëmijët me aftësi të kufizuara, përfshirë masa për mbështetje gjatë procedurave. Vendimarrja në lidhje me ofrimin e masave të posaçme ndihmëse zakonisht mbetet në diskrecionin e profesionistëve nga rasti në rast, duke vepruar pa ndonjë udhërrëfyes apo standard të miratuar institucionalisht. Një zhvillim pozitiv që vërehet në kuadër të përpjekjeve për përfshirje dhe sigurim të gjuhës apo masave për ndihmë të veçantë është instalimi i pajisjeve për komunikim në gjuhën e shenjave në disa prej gjykatave të Kosovës. Ky projekt, i mbështetur nga USAID, synon të mundësojë komunikim më të lehtë dhe efektiv për personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe dëgjim, përfshirë të verbrit dhe personat shurdh-mecë. Megjithatë, pavarësisht këtij zhvillimi teknik pozitiv, mungojnë të dhëna zyrtare mbi nivelin e zbatimit praktik të këtyre pajisjeve, si dhe vlerësime të ndikimit të tyre real në përmirësimin e aksesit në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara.

Çka është synuar!	Përputhshmëria me standartet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Neni 123 i KDM vendos kufizime të qarta ligjore për ekzaminimin fizik dhe marrjen e mostrave nga trupi i fëmijës, duke e konsideruar këtë si masë të jashtëzakonshme dhe të kushtëzuar me garanci specifike që synojnë parandalimin e traumave të mëtejshme. Për tu siguruar që fëmija është i mbrojtur dhe që ky veprim procedural të jetë në përputhshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare, në paragrafët vijuese ky nen kërkon këto garanci ligjore: ■ Autorizimi i shkruar i gjykatës: kërkohet që çdo ekzaminim mjekësor apo marrje e mostrave të autorizohet në mënyrë formale dhe vetëm nëse ka arsye të bazuara ligjorisht. ■ Pjesëmarrja e prindit, kujdestarit ose mbështetësit të fëmijës: mbikëqyrja e ekzaminimit nga një i rritur që përfaqëson interesat e fëmijës është e detyrueshme. ■ Dëgjimi i fëmijës dhe pëlqimi i prindërve: përfshirja e fëmijës në vendimmarrje dhe respektimi i integritetit të tij/saj trupor dhe psikologjik. Kujdesi për shëndetin e përgjithshëm: autoritetet janë të detyruara të veprojnë në mënyrë të shpejtë nëse ka dyshime për dëmtim fizik ose psikologjik të fëmijës. Mjekimi duhet të ofrohet bazuar në rekomandimet e profesionistëve shëndetësorë, përfshirë edhe trajtimin spitalor nëse kërkohet.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Nenet 16, 19 dhe 39 garantojnë mbrojtjen e integritetit fizik dhe psikologjik të fëmijës, ndalimin e çdo forme dhune dhe të drejtën për rehabilitim pas traumës). Udhëzimet e OKB-së për Drejtësinë për Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë të Krimeve (kërkojnë që ekzaminimet mjekësore të autorizohen vetëm kur janë rreptësisht të nevojshme, nga autoritetet kompetente, dhe të realizohen në kushte që shmangin traumatizimin e fëmijës). Manuali i OBSH për intervistimin dhe ekzaminimin mjeko-ligjor të viktimave të dhunës seksuale (rekomandon pëlqimin e informuar, praninë e një përfaqësues të fëmijës dhe përdorimin e një qasjeje ndërdisiplinare gjatë ekzaminimit). Direktiva 2012/29/BE e Bashkimit Evropian (kërkon që të gjitha masat që merren ndaj viktimave të dhunës, përfshirë fëmijët, të respektojnë dinjitetin e tyre dhe të shmangin çdo ndërhyrje që mund të shkaktojë traumatizim të mëtejshëm). Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 8 garanton të drejtën për respektimin e jetës private dhe integritetin trupor, duke përfshirë mbrojtjen kundër ndërhyrjeve të panevojshme mjekësore apo institucionale).	Si e gjetur kryesore e evidentuar në analizë në lidhje me ekzaminimet mjekësore, marrja e mostrave nga trupi ekzaminimeve të provave, është mospërputhja e konsiderueshme ndërmjet deklarimeve të profesionistëve të intervistuar dhe fakteve të konstatuara në rastet konkrete, të dokumentuara nga raportet zyrtare, përfshirë ato të Institutit të Avokatit të Popullit. Sipas deklarimeve të profesionistëve, ekzaminimet mjekësore të fëmijëve viktima të dhunës seksuale kryhen brenda afateve ligjore, duke respektuar të drejtën e fëmijës që ekzaminimi të bëhet nga një profesionist i gjinisë së njëjtë, si dhe duke shmangur intervistimin e fëmijës gjatë ekzaminimit mjekësor. Si pjesë e një protokollit të ri të brendshëm, Instituti i Mjekësisë Ligjore raportohet se ka modifikuar qasjen, duke kufizuar komunikimin me fëmijët vetëm në pyetje të natyrës mjekësore, të cilat përdoren për përpilimin e raportit për organet e drejtësisë. Megjithatë, raporti i Avokatit të Popullit dëshmon raste konkrete të shkeljeve serioze, përfshirë vonesa të mëdha në veprimet e institucioneve përgjegjëse. Në raportin Ex-Officio nr. 468/2022 (datë 03.04.2023), që trajton rastin e dhunimit të një 11-vjeçareje, janë dokumentuar këto shkelje kritike: ■ Agjencia Kosovare për Forenzikë ka vonuar 68 ditë për të bërë ekzaminimin dhe tërheqjen e fotove/dëshmive nga telefoni i viktimës dhe 137 ditë për të realizuar ekzaminimin e ADN-së; ■ Instituti i Mjekësisë Ligjore ka dërguar raportin fizik të ekzaminimit në prokurori vetëm pas 90 ditësh. Sipas këtij raporti, këto vonesa kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e hetimeve dhe sigurimin e provave, duke vonuar identifikimin e të dyshuarve dhe duke rrezikuar integritetin e procedurës hetimore dhe të drejtën e fëmijës për drejtësi efektive. Për më tepër, intervistat me profesionistë kanë treguar se jo të gjithë fëmijët viktima të dhunës dërgohen në IML për ekzaminim. Në shumë raste, veçanërisht ato që lidhen me dhunën në familje apo format e tjera të keqtrajtimet, fëmijët fillimisht dërgohen në QKMF ose në qendrat emergjente të spitaleve rajonale. Vetëm më pas, në bazë të raporteve të përpiluar nga këto institucione, prokuroria i kërkon IML-së të japë një ekspertizë mjeko-ligjore. Kjo praktikë paraqet rrezik të lartë për integritetin e provave dhe cenon të drejtën e fëmijës për mbrojtje të specializuar dhe profesionale.

Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Neni 124 i KDM siguron që çdo fëmijë viktimë apo dëshmitar të ketë pranë një person mbështetës të trajnuar, i cili ofron ndihmë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme gjatë gjithë procesit penal, me qëllim mbrojtjen nga ri viktimizimi dhe sigurimin e një përvojë më të ndjeshme. Në paragrafët vijuese të këtij neni, përcaktohen disa kriterë të përgjeshjes si dhe përgjegjësitë e personit mbështetës: -Përzgjedhja e kujdesshme dhe e përshtatshme e personit mbështetës nga ana e Gjykatës, me konsultim të drejtpërdrejtë me fëmijën dhe familjen e tij; -Garancia për kohë të mjaftueshme për ndërtimin e marrëdhënies mes fëmijës dhe personit mbështetës, përpara fillimit të intervistave; -Prania e detyrueshme e personit mbështetës gjatë çdo interviste të fëmijës në kuadër të procedurave penale; -Vazhdimësia e kontaktit të fëmijës me të njëjtin person mbështetës përgjatë gjithë procesit. -Mbikëqyrja nga gjykata e punës së personit mbështetës dhe mundësia për zëvendësim nëse ai nuk vepron në përputhje me detyrat. - Më tutje në nenin 125 të KDM përcaktohen në detaje detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të personit mbështetës, me qëllim sigurimin e një mbështetjeje të vazhdueshme emocionale, praktike dhe ligjore për fëmijën viktimë apo dëshmitar gjatë gjithë procedurës penale. - Sipas neni 134 personi mbështetës ka rol edhe përgjegjësi për të siguruar vazhdimësinë e mbështetjes për fëmijët viktimë apo dëshmitarë edhe pas mbarimit të procesit gjyqësor, duke garantuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme për mbrojtjen e mirëqenies së tyre.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Nenet 3, 12 dhe 39 kërkojnë qasje që kanë në qendër interesin më të lartë të fëmijës, pjesëmarrjen e tij dhe rehabilitimin). Udhëzimet e OKB-së për Drejtësinë për Fëmijët Viktimë dhe Dëshmitarë të Krimeve (përcaktojnë të drejtën e fëmijëve për ndihmë emocionale dhe praktike gjatë gjithë procesit, përmes mbështetjes nga një profesionist i trajnuar). Direktiva 2012/29/BE për të drejtat e viktimave (kërkon ofrimin e mbështetjes për viktimat e mitura përmes ndërhyrjeve të vazhdueshme, përfaqësimit të ndjeshëm dhe rolit të ndërmjetësuesve të trajnuar në sistemin penal). Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi Seksual (Nenet 14 dhe 31 përcaktojnë mbështetjen psikologjike dhe sociale gjatë dhe pas procedurës).	Përkundër faktit se dispozita përbën një risi thelbësore në KDM, zbatimi i saj në praktikë rezultoi thuajse inekzistent. Në shumicën e rasteve, kjo dispozitë ngatërrohet me rolin e zakonshëm të zyrtarëve të shërbimeve sociale pranë QPS-ve. Nga intervistat e zhvilluara me profesionistët, asnjëri prej tyre nuk ka njohuri të qartë mbi ekzistencën e kësaj dispozite në legjislacionin përkatës. Një prej arsyeve kryesore të kësaj mospërfutheje lidhet me mungesën kronike të stafit në QPS-të, si dhe me mbingarkesën e detyrave që burojnë nga kompetencat e gjera të tyre. Këtë sfidë e konfirmon edhe raporti "Analiza e Qendrave për Punë Sociale" i publikuar nga KOMF (Prill 2023), ku ndër të tjera theksohet se: "... krahas numrit të familjeve në nevojë dhe nevojave të komunave për shërbime, numri i zyrtarëve të shërbimeve sociale në QPS është i mangët. Sipas informatave nga QPS-të, ka rënie të numrit të stafit... nuk ka një formulë të definuar që reflekton nevojat reale të popullsisë me numrin e zyrtarëve apo profesionistëve si psikologë apo punonjës social." Për më tepër, një aspekt thelbësor që ndikon drejtpërdrejt në mungesën e zbatimit të kësaj dispozite, dhe që përbën një cenim serioz të të drejtave të fëmijës, është mos funksionalizimi i organit të kujdestarisë në shumicën e komunave të Kosovës. Ky shqetësim ngrihet qartë edhe në Raportin Ex-Officio nr.37/2023 të Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili thekson se: "... në rastin konkret ka shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, përkatësisht të drejtave të fëmijëve, pasi autoritetet përkatëse nuk i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore, e as standardet ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë, në lidhje me formimin dhe funksionalizimin e Organit të Kujdestarisë sipas Ligjit".

Personi mbështetës nga Qendra për Punë Sociale		
Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
		Në vazhdim, raporti përfundon se: "Rrjedhimisht, mos themelimi i këtij organi pamundëson zbatimin e dispozitave të Ligjit Nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodit Nr.06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur..." Këto gjetje dëshmojnë për një hendek të madh ndërmjet kuadrit ligjor progresiv dhe realitetit institucional, duke ndikuar drejtpërdrejt në mungesën e mbrojtjes së duhur ligjore për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë, si dhe në mosrealizimin e detyrimeve të institucioneve për mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës.

Ekzaminimi për zotësinë		
Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Neni 126 i KDM trajton mënyrën dhe kushtet në të cilat mund të realizohet ekzaminimi për zotësinë e fëmijës për të dëshmuar në procesin gjyqësor. Ai ofron garanci që ky proces të mos abuzohet dhe të zhvillohet vetëm kur është i domosdoshëm për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës. ■ Arsyetimi bindës: ekzaminimi për zotësinë kryhet vetëm kur ka arsye bindëse që e justifikojnë këtë hap. Vendimi për ekzaminim duhet të motivohet dhe të regjistrohet në gjykatë. Kriteri themelor për vendimmarrje është interesi më i lartë i fëmijës; ■ Qëllimi i ekzaminimit: synon të përcaktojë nëse fëmija është i zoti ose jo për të kuptuar pyetjet që i drejtohen atij në një gjuhë që është e kuptueshme për të, si dhe rëndësinë që të thuhet e vërteta. Vetëm mosha nuk është e vetmja arsye për të kërkuar ekzaminim për zotësinë; ■ Pjesëmarrësit në ekzaminim: gjyqtari mund të caktojë një psikolog apo ekspert tjetër relevant. Të pranishëm mund të jenë (vet gjyqtari; prokurori, përfaqësuesi i autorizuar; personi mbështetës, prindërit, kujdestari apo persona të tjerë që ndihmojnë mirëqenien e fëmijës); ■ Përjashtimi nga prezenca e ekspertit: Në raste kur eksperti nuk mund të jetë i pranishëm, gjyqtari mund ta realizojë vetë vlerësimin bazuar në pyetjet e përgatitura nga palët; ■ Pyetjet duhet: të jenë të përshtatshme për moshën dhe nivelin e zhvillimit të fëmijës, si dhe të mos lidhen me faktet e rastit penal, por vetëm me vlerësimin e zotësisë për të kuptuar dhe për t'u shprehur me vërtetësi; ■ Ekzaminimet psikologjike/psikiatrike: lejojnë vetëm nëse ka arsye të forta për realizimin e tyre; Ndalesa e përsëritjes: ekzaminimi nuk përsëritet, për të shmangur ngarkesën emocionale dhe traumën dytësore të fëmija.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Nenet 12 dhe 40 njohin të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar dhe për të marrë pjesë në procedurat që e prekin, duke theksuar rëndësinë e vlerësimit të individualizuar dhe jo diskriminues, duke mos përdorur vetëm moshën si kriter). Udhëzimet e OKB-së për Drejtësinë për Fëmijët Viktima dhe Dëshmitarë të Krimeve (përcaktojnë se fëmijët duhet të konsiderohen të aftë për të dëshmuar nëse ata mund të kuptojnë dhe të komunikojnë në mënyrë të përshtatshme, dhe se ekzaminimet për zotësinë duhet të shmangen nëse nuk janë absolutisht të domosdoshme). Udhëzuesi i Këshillit të Evropës për Drejtësi Miqësore për Fëmijët (rekomandon vlerësime të ndjeshme të zotësisë vetëm kur janë të nevojshme, përmes metodave të përshtatshme për zhvillimin dhe psikologjinë e fëmijëve, dhe në mënyrë që të shmangen ri-traumatizimi). Direktiva 2012/29/BE për të drejtat e viktimave, (përshin parime për mbrojtjen e viktimave të mitura përmes procedurave të përshtatshme dhe vlerësimeve jo stigmatizuese). Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka nxjerrë shumë vendime nëpërmjet të cilave ka kritikuar vendet kur fëmijëve u mohohet e drejta për të dëshmuar për shkak të vlerësimeve të panevojshme apo të përsëritura).	Sipas intervistave të realizuara me profesionistë, rezulton se jo në të gjitha rastet zbatohet ekzaminimi për përcaktimin e zotësisë së fëmijës, ndonëse kjo procedurë është e paraparë me ligj. Zakonisht, ky ekzaminim realizohet vetëm në raste kur ekzistojnë dyshime të qarta lidhur me aftësitë mendore ose emocionale të fëmijës, ose në raste kur ka paqartësi lidhur me moshën apo nivelin e kuptimit të tij. Në disa raste, gjyqtarët kanë kërkuar ekzaminimin vetëm për shkak të moshës së ulët të fëmijës, pa pasur tregues të tjerë që justifikojnë një ekzaminim të tillë. Kjo qasje bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit, sipas të cilit mosha nuk duhet të jetë kriteri i vetëm për vlerësimin e zotësisë. Një sfidë e theksuar në zbatimin e kësaj dispozite është mungesa e psikologëve apo ekspertëve të specializuar, e cila bën që, edhe kur realizohet ekzaminimi, ai nuk përbush gjithmonë standardet profesionale dhe etike, dhe nuk garanton mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës. Në disa raste, pyetjet e përdorura gjatë ekzaminimit janë formuluar në mënyrë të gjeneralizuar dhe përfshijnë elemente që prekin faktet penale të çështjes, gjë që bie ndesh me parimin e mbrojtjes së fëmijës nga ndikimi në dëshmi. Gjithashtu, përsëritja e ekzaminimit është eventualeur si problem në rastet kur është kërkuar super-ekspertizë, duke shkaktuar ngarkesë të panevojshme emocionale për fëmijën, dhe rritur rrezikun për dëmtime dytësore psikologjike. Një tjetër mangësi e theksuar është mungesa e një protokollit apo udhëzuesi të detajuar procedural.

Ambientet e pritjes		
Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Neni 127 i KDM, vendos standardet minimale për ambientet fizike dhe organizimin procedural të pritjes së fëmijëve që janë viktimë ose dëshmitarë në procese penale. Qëllimi është të garantohet siguria, privatësia, mirëqenia emocionale dhe mbrojtja nga viktimizimi dytësor. Institucionet e drejtësisë me theks të veçantë policia, prokuroria dhe gjykata duhet të sigurojnë ndër të tjera: ■ Krijimi i ambienteve të posaçme dhe të përshtatshme: të posaçme vetëm për fëmijët; të mobiluara në mënyrë miqësore, komode dhe jo intimidesuese; të kenë lehtësira për fëmijët me nevojat të veçanta; ■ Ndalesa e kontaktit me të pandehurit: ambientet nuk duhet të jenë të dukshme nga të akuzuarit dhe të aksesueshme për të akuzuarit; ■ Ndarja nga dëshmitarët e rritur: kur është e mundur, duhet të ekzistojnë hapësira të ndara nga ato të dëshmitarëve të rritur, për të shmangur kontaktin me të rritur të panjohur që mund të jenë të frikshëm ose dekurajues për fëmijët; ■ Pritja larg sallës së gjyqit: gjyqtari mund të vendosë që fëmija të mos qëndrojë pranë sallës së gjykimit, për të shmangur stresin e pritjes ose përballjen me palë të tjera; ■ Përparësi për dëgjimin e fëmijëve: gjyqtari duhet të prioritetizojë dëshminë e fëmijëve, për të kufizuar ekspozimin dhe pritjen e gjatë në mjediset e gjykatës.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (veçanërisht nenet 3 dhe 19, përcaktojnë që në çdo ndërveprim institucional, interesi më i mirë i fëmijës të jetë parësor, duke përfshirë mbrojtjen nga dhuna, frika dhe stresi emocional). Udhëzimet e OKB-së për Drejtësinë për Fëmijët Viktimë dhe Dëshmitarë të Krimet (kërkojnë mjedise të sigurta, të personalizuara dhe të ndara fizikisht nga të pandehurit, si dhe përjashtimin e fëmijës nga çdo përballje e panevojshme me të dyshuarin apo personat e tjerë që mund të ndikojnë negativisht në mirëqenien e tij). Direktiva 2012/29/BE për standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, (neni 23 dhe 24 theksojnë detyrimin për të ofruar “lehtësira të përshtatshme për viktimat fëmijë”, përfshirë ndarjen nga të dyshuarit dhe të rriturit, dhe minimizimin e kontaktit me ambientet tradicionale të drejtësisë. Udhëzuesi për Drejtësinë Miqësore të Fëmijëve i Këshilli të Evropës (sugjeron që fëmijët të presin dhe të dëgjohen në hapësira jo të frikshme, të përshtatura për moshën dhe nevojat e tyre, dhe që përdorimi i ambientit neutral e të “normalizuar” është thelbësor për uljen e stresit).	Niveli i zbatimit të kësaj dispozite ndryshon dukshëm ndërmjet institucioneve dhe është i varur nga dy tregues kryesorë që derivojnë nga KDM: 1. Themelimi i ambienteve fizike nga institucionet përgjegjëse: Deri më tani, disa stacione të policisë, prokurorisë dhe gjykatave kanë themeluar ambiente të pritjes të konceptuara si “dhoma miqësore për fëmijë”, por ky proces është ende në zhvillim në shumë stacione, prokurori apo gjykata të tjera. Vërehet se krijimi i këtyre hapësirave është bërë në mënyrë jo të standardizuar, duke u bazuar në kontribute dhe qasjet e donatorëve të ndryshëm, pa ndonjë model unifikues institucional. Si rrjedhojë, cilësia dhe përmbajtja e këtyre dhomave ndryshon ndjeshëm nga një institucion në tjetrin. 2. Përdorimi dhe shfrytëzimi i ambienteve të krijuara: Edhe aty ku ekzistojnë dhoma apo ambiente të përafërta, shfrytëzimi i tyre në praktikë mbetet shumë i kufizuar. Nga intervistat me profesionistët rezultojnë se disa nga arsyet më të shpeshta për moszbatim janë: ■ vështirësitë teknike në përdorimin e pajisjeve të instaluar; ■ mungesa e koordinimit ndërinstitucional, përfshirë vonesa nga institucionet që duhet të marrin pjesë në seancë; ■ preferenca për të zhvilluar intervistimin në zyra, për shkak të “thjeshtësisë” logjistike. Këto pengesa ngrenë dyshime serioze nëse ekziston gatishmëri reale për zbatimin e parimit të drejtësisë miqësore për fëmijët në praktikë. Si rrjedhojë, fëmijët viktimë ose dëshmitarë shpesh presin në të njëjtat ambiente me të rriturit, përfshirë të pandehurit apo dëshmitarët e tjerë.

Mbështetja emocionale		
Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Neni 128 i KDM përfuron të drejtën e fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë për mbështetje emocionale gjatë gjithë procesit gjyqësor, me qëllim të mbrojtjes së mirëqenies së tyre psikologjike dhe reduktimit të traumës. Kjo mbështetje përfshin: ■ Praninë e personit mbështetës gjatë procedurave: gjyqtari kompetent lejon që personi mbështetës (krahës prindit, kujdestarit apo përfaqësuesit të autorizuar) të shoqërojë fëmijën gjatë gjithë kohës që merr pjesë në procesin gjyqësor, me qëllim uljen e stresit apo ankthit; ■ E drejta për pushim: personi mbështetës dhe vetë fëmija kanë të drejtë të kërkojnë pushim nga seanca, dhe gjyqtari ka detyrimin të informojë për këtë të drejtë; ■ Përfshirja e prindërve/kujdestarit: gjyqtari mund të largojë prindërit ose kujdestarin nga seanca, vetëm nëse kjo është në interesin më të lartë të fëmijës, për të mbrojtur stabilitetin emocional të tij.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës, (Nenet 3 dhe 12 përcaktojnë të drejtën e fëmijës për mbrojtje dhe përfaqësim të përshtatshëm, në funksion të mirëqenies së tij emocionale). Udhëzimet e OKB-së për Drejtësinë për Fëmijët Viktimë dhe Dëshmitarë të Krimeve (kërkojnë ofrimin e “mbështetjes së vazhdueshme emocionale dhe psikologjike para, gjatë dhe pas procesit gjyqësor”). Direktiva 2012/29/BE mbi të drejtat e viktimave (garanton qasje në mbështetje emocionale dhe psikologjike adekuate dhe prani të një personi shoqërues gjatë procesit, sidomos për fëmijët).	Në mungesë të personit mbështetës nga QPS, edhe kjo dispozitë është zbatuar në mënyrë jo të duhur. Në mungesë të këtij profesionisti, kjo përgjegjësi bie zakonisht mbi psikologët që angazhohen me thirrje nga prokuroria apo gjykata, si dhe mbi prindërit ose kujdestarin, të cilët nuk janë të trajnuar profesionalisht për këtë rol. Psikologu i thirrur nga prokuroria apo gjykata nuk është enkas i angazhuar për të ofruar mbështetjen profesionale të përcaktuar në nenin 128. Ai apo ajo, ndër angazhimet e tjera, luan edhe këtë rol. Megjithatë, roli i tij apo saj është i kufizuar për shkak të fushëveprimit dhe nivelit të detyrave që duhet të kryejë në rastin konkret. Një aspekt tjetër i evidentuar ka të bëjë edhe me të drejtën e fëmijës për pushim. Edhe kjo e drejtë nuk zbatohet në mënyrë mënyrë të rregullt dhe të duhur. Edhe pse kjo e drejtë është e garantuar me standarde ndërkombëtare, zbatimi i saj në praktikë varet nga Prokurori, Gjyqtari apo Avokati, dhe në rastet kur zbatohet kjo nuk i nënshtrohet ndonjë rregulli të kuartë të shkruar por i lihet në diskrecion të këtyre të fundit të kërkojnë pushim. Një kërkesë tjetër e kësaj dispozite është edhe përfshirja e prindërve apo kujdestarëve, e cila ndodh shumë rrallë dhe vetëm në raste ekstreme. Në mungesë të vlerësimeve profesionale psikologjike para seancave, gjyqtari rrallë merr vendime përjashtuese. Edhe atëherë kur merret vendim për përjashtim, zakonisht bëhet për ndonjë arsye që pengon zhvillimin e rregullt të procedurës, më shumë sesa duke u bazuar në interesin më të mirë të fëmijës.

Pajisjet në sallën e gjyqit		
Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Neni 129 i KDM rregullon aspektet e pamjes dhe ndryshimeve fizike dhe funksionale në sallën e gjyqit me qëllim të lehtësimit të pjesëmarrjes së fëmijëve viktimë apo dëshmitarë, duke marrë parasysh nevojat e tyre individuale. Gjyqtari kompetent ka për detyrë të sigurojë që ambienti në sallën e gjyqit të përshatet me nevojat e fëmijës, duke përfshirë: ■ Karrige me ndenjëse të ngritura për të siguruar komoditet dhe pamje të mirë; ■ Asistencë për fëmijët me aftësi të kufizuara, për t'u mundësuar pjesëmarrje të barabartë dhe dinjitoze; ■ Lista e pajisjeve nuk është shteruese, lihen hapësira për rregullime të tjera që gjyqtari i sheh të nevojshme; ■ Vendosja e fëmijës pranë personave mbështetës; ■ Plani i sallës duhet të parashikojë që fëmija, sa herë që është e mundur, të ulët pranë një figure mbështetëse (prind, kujdestar, përfaqësues i autorizuar apo person mbështetës).	Konventa për të Drejtat e Fëmijës, (Neni 3 përcakton që rregullimi i mjedisit gjyqësor për t'u përshatur nevojave të fëmijës është pjesë përbërëse e mbrojtjes së interesit të tij më të mirë si dhe Neni 12 përcakton që për të garantuar këtë të drejtë, ambienti fizik duhet të jetë i tillë që fëmija të ndihet i sigurt dhe i qetë për të komunikuar lirshëm). Udhëzimet e OKB-së për Drejtësinë për Fëmijët Viktimë dhe Dëshmitarë të Krimeve (theksojnë rëndësinë e rregullimit të ambientit gjyqësor për të reduktuar frikën, stresin dhe traumën për fëmijët, përfshirë pajisje të përshatura me moshën dhe aftësinë fizike). Udhëzuesi për Drejtësinë Miqësore të Fëmijëve i Këshilli të Evropës (kërkon që ambienti fizik i gjykatës të jetë “miqësor për fëmijët, jo frikësues, dhe t'u japë atyre ndjenjën e sigurisë dhe mbrojtjes”). Direktiva 2012/29/BE (garanton të drejtën e viktimave të mitura për të dhënë dëshmi në kushte që shmangin frikën dhe shqetësimin, përfshirë përdorimin e pajisjeve ndihmëse, përshatjen e ambientit fizik dhe uljen e kontaktit me të pandehurin).	Nga intervista me profesionistë kjo dispozitë vërehet që nuk kuptohet drejtë. Kjo dispozitë edhe pse në lexim të titullit të nenit krijon përshtypjen që ka të bëjë me pajisjet teknologjike, në fakt ka të bëjë me tepër me orënditë që i mundësojnë fëmijës të ketë qasje më të lehtë në procedurën gjyqësore, që nënkupton pjesëmarrjen e tij gjithëpërfshirëse. Megjithatë në praktikë kjo rrallë ndodh që sallat e gjykatës (gjykatoret), të përshatet apo modifikohen për nevojat e fëmijës. Nga gjykatoret e vizituara ka mungesë pajisjesh/orëndive që janë të kërkuara nga kjo dispozitë si: nuk janë të pajisura me karrige të përshatshme për fëmijët (p.sh., me ndenjëse të ngritura apo mobilje të përshatura me trupin e fëmijës). Në shumicën e rasteve, fëmijët përdorin karrigat e njëta që shërbejnë për të rriturit, çka mund të krijojë ndjenjë diskomforti ose pamundësi për të parë apo dëgjuar mirë. Poashtu ka vështirësi në sigurimin e pajisjeve ndihmëse për fëmijët që janë me aftësi të kufizuara sidomos në rastet kur nuk ka ashenorë apo kur këta janë jashtë funksionit dhe salla e gjyqimit është në katet e epërme.

Pyetje nga pala kundërshtare		
Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Neni 130 i KDM trajton mënyrën e shtrimit të pyetjeve kundrejt fëmijëve viktimë apo dëshmitarë nga pala kundërshtare në procedurat gjyqësore penale, duke vendosur masa mbrojtëse dhe kufizuese për të shmangur cenimin emocional të fëmijës. Shtrimi i pyetjeve duhet të nënshtrohet rregullave si më poshtë -Ndëlesa për pyetjen direkt nga kryesi: gjyqtari nuk lejon që fëmija të pyetet drejtpërdrejt nga kryesi i veprës penale, për të mbrojtur integritetin emocional dhe ndjeshmërinë e fëmijës. -Mekanizmi alternativ për pyetje: pyetja mund të bëhet përmes përfaqësuesit të autorizuar (p.sh. avokati i të pandehurit), dhe kalon përmes gjyqtarit për të mitur, që ka funksion filtrues; -Roli mbrojtës i gjyqtarit për të mitur: gjyqtari ka detyrën aktive të parandalojë çdo pyetje që kanos fëmijën emocionalisht apo psikologjikisht apo shkakton vështirësi të panevojshme si dhe ato që sjellin ankth të tepërt dhe përjetime traumatike.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Nenet 3 dhe 12 përcaktojnë vendosjen e interesit më të mirë të fëmijës dhe të drejtën për të shprehur mendimin në një ambient të sigurt). Direktiva e BE-së 2012/29/BE (Neni 23 kërkon masa për të shmangur kontaktin e drejtpërdrejtë me të dyshuarin). Udhëzimet e OKB-së për Drejtësinë për Fëmijët Viktimë dhe Dëshmitarë të Krimeve (kërkojnë ndërhyrjen e një figure të trajnuar për të filtruar pyetjet e palës kundërshtare).	Megjithëse ndëlesa për pyetje direkte nga i pandehuri në drejtim të fëmijëve viktimë apo dëshmitarë respektohet në shumicën e rasteve, ajo nuk shoqërohet me përdorimin e mekanizmave të përshtatshëm si video-lidhjet ose qëndrimi i fëmijës në një ambient të ndarë nga salla ku zhvillohet seanca. Kjo mungesë e mekanizmave mbrojtës kufizon efektivitetin e ndalesës dhe mund të ndikojë negativisht në gjendjen emocionale të fëmijës. Zbatimi i ndalesës për pyetje direkte nga i pandehuri është më i theksuar në rastet që lidhen me vepra penale kundër integritetit seksual. Në raste të tjera penale, megjithatë, pyetjet që i adresohen fëmijës zakonisht përcillen përmes gjyqtarit, pa përfshirjen e një profesionisti të trajnuar në komunikimin me fëmijët. Mungesa e profesionistit të specializuar mund të ndikojë negativisht si në cilësinë e dëshmisë së dhënë nga fëmija, ashtu edhe në përvojën emocionale të tij gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore. Përdorimi i metodave alternative për marrjen e dëshmi, si video-konferenca apo dhomat e veçanta, mbetet shumë i kufizuar për shkak të mungesës së infrastrukturës teknologjike dhe logjistikës përkatëse në shumicën e institucioneve gjyqësore. Gjithashtu, kapacitetet e gjyqtarëve për të vlerësuar ndikimin emocional të pyetjeve janë të ndryshme dhe varen kryesisht nga përvoja individuale dhe niveli i trajnimit profesional. Në praktikë, profesionistët e përfshirë në procesin e intervistimit dhe marrjes në pyetje të fëmijëve viktimë apo dëshmitarë rrallëherë i referohen protokolleve¹⁴ ekzistuese në mënyrë të strukturuar dhe të koordinuar. Në shumicën e rasteve, referimi ndaj protokollit bëhet në mënyrë individuale dhe jo si pjesë e një qasjeje të bashkërdendur ndërmjet institucioneve për zbatimin e tij. Kjo mungesë koordinimi institucional ndikon negativisht në standardizimin e praktikave dhe në sigurimin e një qasjeje të ndjeshme dhe të harmonizuar ndaj nevojave të fëmijës gjatë procesit gjyqësor.

¹⁴ Protokollit shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale është miratuar me Vendimin nr.11/109 të datës 23.11.2022.

Masat për të mbrojtur jetën private dhe mirëqenien e fëmijëve

Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Pjesëmarrja e fëmijëve viktimë apo dëshmitarë të dhunës seksuale në procedura gjyqësore përbën një rrezik serioz për jetën e tyre private dhe mirëqenien psikologjike dhe fizike, si në të tashmen ashtu edhe në të ardhmen. Për të adresuar këtë rrezik KDM në nenin 131 ka përcaktuar një sërë masash që kanë për qëllim mbrojtjen efektive të këtyre fëmijëve gjatë procesit gjyqësor. Me kërkesë të fëmijës, prindërve, kujdestarit, përfaqësuesit të autorizuar, personit mbështetës ose edhe me iniciativë të vetë institucionit, gjyqtari kompetent, duke u bazuar në interesin më të lartë të fëmijës, mund të urdhërojë masa mbrojtëse si: ■ Fshirja e çdo informacioni identifikues nga arkivat; ■ Ndalimi i zbulimit të identitetit nga përfaqësuesit ligjorë apo publikimi i materialeve që çojnë në identifikim; ■ Mospublikimi i dokumenteve që përmbajnë të dhëna identifikuese; ■ Përdorimi i pseudonimeve ose numrave identifikues; ■ Marrja e masave për fshehjen e tipareve fizike ose përdorimi i pajisjeve që ndryshojnë figurën ose zërin; ■ Dhënia e dëshmisë përmes xhamit të patejdukshëm, me video të regjistruar paraprakisht apo përmes monitorit me qark të mbyllur; ■ Përdorimi i ekspertëve të specializuar, si përkthyes për fëmijët me aftësi të kufizuara; ■ Mbajtja e seancave të mbyllura dhe largimi i përkohshëm i të akuzuarit kur kjo pengon dëshminë e lirë të fëmijës; ■ Lejimi i pushimeve gjatë dëshmisë dhe përcaktimi i orarit të përshtatshëm për moshën dhe zhvillimin e fëmijës; ■ Çdo masë tjetër që gjykata vlerëson si të nevojshme për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës dhe ruajtjen e të drejtave të akuzuarit.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Nenet 16 dhe 40 përcaktojnë të drejtën e fëmijës për mbrojtje të privatësisë dhe dinjitetit gjatë procedurave penale). Udhëzimet e OKB-së për Drejtësinë për Fëmijët Viktimë dhe Dëshmitarë të Krimeve (theksojnë rëndësinë e ruajtjes së konfidentalitetit, mbrojtjen nga stigma publike, dhe përdorimin e pajisjeve për dëshmitë në distancë si video-lidhjet apo xhamat e patejdukshëm). Direktiva 2012/29/BE për të drejtat e viktimave (kërkon që të sigurohet që informacioni personal i viktimave, veçanërisht i të fëmijëve, të mos bëhet publik dhe që procedurat të shmangin ripërjetimin e traumës përmes përballjeve me dhunuesin apo pyetjeve të përsëritura).	Sa i përket fshirjes së të dhënave identifikuese dhe ndalimit të publikimeve, zyrtarisht parashihen dhe respektohen në praktikë. Por ajo që është shumë shqetësuese ka të bëjë me rrjedhjen e këtyre të dhënave nga profesionistët e përfshirë në rast. Fatkeqësisht kjo është bërë një 'sëmundje' shumë brengosëse, sepse kjo rrezikon jashtëzakonisht shumë jo vetëm fëmijën viktimë apo dëshmitar, por rrezikon edhe vetë profesionistët e ndërgjegjshëm që punën e tyre e kryejnë me profesionalizëm, dhe në fund të fundit dëmtojnë gjithë procesin gjyqësor. Sa i përket marrjes në pyetje dhe pranisë në seancë përmes video-lidhjeve apo masave të tjera të ndërlidhura të parashikuara në këtë dispozitë, zbatimi i tyre në praktikë lë shumë për të dëshiruar dhe është shumë larg nga përdorimi i duhur i tyre. Kjo ndërlidhet me faktin se në shumë seanca ku fëmijët janë viktimë apo dëshmitarë, këto dispozita nuk zbatohen ashtu siç kërkohet. Siç theksuam edhe më lart, në shumë salla të Gjykatave dhe Prokurorive tanimë janë të instaluar dhe të pranishme pajisjet teknologjike për marrjen në pyetje të fëmijës përmes video apo audio-lidhjeve, pa pasur nevojë për prezencën e fëmijës në të njëjtën sallë me të akuzuarin.

Masat për të mbrojtur jetën private dhe mirëqenien e fëmijëve

Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Masa të tilla janë të përcaktuara edhe Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës “Privatësia e fëmijës respektohet në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore apo administrative, duke përfshirë edhe publikimin e tyre në media.” (neni 38). Gjithashtu, neni 57 i këtij ligji përcakton që “Masat për mbështetjen e fëmijës duhet të merren në një mjedis të favorshëm për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës, duke siguruar trajtim të kujdesshëm të privatësisë së tij, përfshirë mbrojtjen nga konfrontimi me dhunuesin, akomodimin në një vend të sigurt dhe përgatitjen psikologjike për të ardhmen.”		Edhe këtu, sikurse më lart, arsyetimet për mospërdorimin e këtyre sallave dhe pajisjeve janë jo bindëse dhe në kundërshtim me interesin më të mirë të fëmijës. Si arsye time përmenden: ■ mungesa e sallave dhe pajisjeve të tilla në të gjitha sallat, ■ dhënia e përparësisë rasteve ku gjykohe në rritur, vështirësitë në përdorimin e këtyre pajisjeve, si dhe ■ frika nga rishikimi i këtyre incizimeve në rastet kur janë bërë lëshime gjatë procesit gjyqësor dhe kjo mund të shërbejë si tregues për vlerësimin e performancës dhe në raste të caktuara edhe si provë për shkelje procedurale në rastin e ankimit në Gjykatën e Apelit. Për të gjeturat e tjera në lidhje me pikat e tjera të kësaj dispozite, ju lutem shihni në tabelat përkatëse.

E drejta për kthim dhe kompensim

Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndër-kombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Neni 132 i KDM garanton të drejtën e fëmijëve viktimë për kthimin e pasurisë dhe kompensimin për dëmet e pësuar si rezultat i një veprë penale. Ky nen siguron qasje në drejtësi restauruese dhe përm-ban dispozita të rëndësishme që synojnë mbrojtjen, rehabilitimin dhe rimëkëmb-jen e fëmijës pas përjetimit të pasojave të veprës penale, dhe përfshin: ■ Informimi për të drejtën e kompensim-it: gjyqtari kompetent ka detyrimin të informojë fëmijën viktimë ose dësh-mitar, si dhe prindërit, kujdestarin apo përfaqësuesin e autorizuar të tij, lidhur me procedurat për të kërkuar kompen-sim për dëmet e shkaktuara; ■ Urdhër për kthim ose kompensim: pas dënimit të kryesit të veprës penale, gjykata, me kërkesë të prokurorit, vik-timës, prindërve, kujdestarit ose për-faqësuesit të autorizuar apo edhe me iniciativë të vetë institucionit, mund të urdhërojë masat e mëposhtme ndaj të dënuarit: 1. Kthimi ose zëvendësimi i pasurisë së dëmtuar: nëse fëmijës i është dëmtuar, humbur apo shkatërruar ndonjë pa-suri si rezultat i krimit, autorit i mund të kërkohet të kthejë pasurinë ose të paguajë vlerën e saj nëse kthimi nuk është i mundur; 2. Kompensim për dëme fizike dhe psi-kologjike: gjyqtari mund të urdhërojë që fëmija të kompensohet financiarisht për dëmet fizike ose emocionale të pë-suara nga krimi, përfshirë shpenzimet për riintegrim social e arsimor, trajtim mjekësor, kujdes për shëndetin men-dor dhe ndihmë ligjore; 3. Kompensim për largim nga familja: në rastet kur fëmija ka qenë pjesë e familjes së autorit dhe është detyruar të largohet për shkak të dhunës ose kërcënimeve, autori i veprës penale mund të urdhërohet të mbulojë shpen-zimet që lidhen me këtë largim.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Neni 6 E drejta e jetës dhe zhvillimit të fëmijës në mënyrë të plotë, që lidhet me nevojën për të adresuar dëmet e shkaktuara nga veprat penale; Neni 12 E drejta e fëmijës për të shprehur lirshëm mendimin e tij në çdo çështje që e prek, duke përfshirë edhe çështjet për kompensim dhe drejtësi; Neni 39 Garanton mbrojtje dhe ndihmë për fëmijët viktimë të keqtrajtimet, dhunës, apo çdo forme tjetër keqpërdorimi, duke përfshirë trajtim rehabilitues dhe riparues për rimëkëmbjen e tyre). Direktiva e BE-së 2012/29/EU, (thekson rëndësinë e qasjes së shpejtë në drejtësi restauruese dhe kompensim për viktimat, duke përfshirë fëmijët). Udhëzuesi për Drejtësinë Miqësore të Fëmijëve i Këshillit të Evropës (nxisin që sistemi gjyqësor të sigurojë mbrojtje adekuate dhe kompensim për fëmijët viktimë, duke u fokusuar në të mirën e tyre dhe në parandalimin e viktimizimit të mëtejshëm). Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për drejtësi restauruese (promovojnë qasjen riparuese që synon jo vetëm kompen-simin material, por edhe rehabilitimin dhe integrimin social të viktimave, duke përfshirë fëmijët). Rregullat e Pekinit dhe Rregullat e Riadit, të cilat kërkojnë që sistemet gjyqësore të ofrojnë mbrojtje dhe kompensim të përshatshëm për viktimat;	Zbatimi i kësaj dispozite nuk është i një-jtë dhe dallon varësisht nga interpre-timi që i bëjnë gjyqtarët individualisht këtij neni, si dhe nga gatishmëria e tyre për ta zbatuar njëkohësisht të drejtën për kthim dhe kompensim në procedurë penale. Ajo që zbatohet në mënyrë pothuajse unike nga të gjithë ka të bëjë vetëm me pikën e parë të kësaj dispozite, e cila ndërlidhet me informimin për këtë të drejtë. Megjithatë, vërehet hezitim në zbatimin e procedurës së bashkëng-jitur për kompensimin e dëmit, duke përfshirë edhe kërkesat pasurore-juridike, e cila si procedurë mund të kërkohej dhe vendoset si në procedurë penale ashtu edhe në atë kontestimore. Arsyetimi i gjyqtarëve për mos ven-dosjen në procedurë penale të kësaj të drejte lidhet me vonesat në vendim-marje për këtë të drejtë, gjë që do të ndikonte edhe në vonesën e vendosjes meritore për procedurën penale, dhe sipas tyre kjo nuk është në interesin e fëmijës. Zakonisht, fëmijët dhe përfaqësuesit e tyre udhëzohen që për realizimin e kësaj të drejte të veprojnë në procedurë kontestimore. Edhe në rastet kur rasti i një fëmije viktimë zgjidhet përmes procedurës kontestimore, gjykata nuk duhet të kufizohet vetëm në dhënien e kompen-simit monetar apo në trajtimin e dëmit në aspektin pasuroro-juridik.

E drejta për kthim dhe kompensim		
Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Kompensimi i dëmit, duke përfshi edhe kërkesat pasurore-juridike, mund të kërkohej dhe vendoset si në procedurë penale ashtu edhe në procedurë kontestimore. Në parim, si dhe duke marrë për bazë interesin më të mirë të fëmijës, vendimi për kompensim dhe kërkesa pasurore-juridike do të duhej të merrej në procedurë penale (si procedurë e adhesionit-procedura e bashkëngjijtjes), në mënyrë që mos të vonohej në realizimin e kësaj të drejte në procedura tjera të cilat do të ndikonin në rritjen e traumës së fëmijës përmes ballafaqimit me një proces të dytë gjyqësor, si dhe do të ndihmonim në sigurimin e një drejtësie efektive dhe të shpejtë.		Në përputhje me standardet ndërkombëtare për drejtësinë për fëmijët, kompensimi duhet të kuptohet në mënyrë më të gjerë si një formë e drejtësisë riparuese, që synon të rikthejë fëmijën në një gjendje të ngjashme me atë përpara se të ndodhte cenimi i të drejtave të tij. Kjo qasje reflekton parimet themelore të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe standardet e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës të OKB-së, që theksojnë se çdo formë dëmshpërblimi duhet të jetë e ndjeshme ndaj moshës, gjinisë dhe përvojave specifike të fëmijës. Gjithashtu, një qasje e tillë promovon jo vetëm riparimin e dëmit, por edhe parandalimin e viktimizimit të mëtejshëm, si dhe rritjen e mundësive të fëmijës për integrim të plotë në shoqëri.

3.2.2. Risitë në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës

Parimet e mbrojtjes së fëmijës		
Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës në kapitullin e II të pjesës të përgjithshme (nenet 5-9), përcakton një grup të parimeve themelore që udhëheqin mbrojtjen e fëmijës në Kosovë. Këto parime janë të derivuara nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe përbëjnë bazën normative mbi të cilën ndërtohet dhe interpretohet i gjithë legjislacioni përkatës për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. Edhe pse në përmbajtje parimet mund të duken deklarative, ato kanë fuqi obligative në kuptimin juridik, duke shërbyer si udhëzime të detyrueshme për zbatimin dhe interpretimin e dispozitivave të LMF-së, dhe sipas nevojës, edhe të legjislacionit tjetër të aplikueshëm që ka ndikim në të drejtat e fëmijës. Këto parime nuk mund të interpretohen apo të zbatohen në mënyrë të izoluar. Ato duhet të kuptohen si të ndërlikura dhe të pandashme, pasi njekohësisht kanë karakter normativ (të drejtë) dhe funksion udhëzues për të gjithë zbatuesit e ligjit, përfshirë institucionet publike, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, OJQ-të dhe të gjitha subjektet që veprojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Parimet themelore të inkorporuara në LMF nga KDF janë: ■ Interesi më i mirë i fëmijës: është shtylla themelore që duhet të udhëheqë çdo veprim, vendim apo ndërhyrje që ndikon në jetën e fëmijës, qoftë nga prindërit, institucionet publike, ofruesit e shërbimeve apo organet gjyqësore dhe administrative. Ky parim përcakton se interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata kryesore, parësore dhe mbizotëruese në çdo rast që ka të bëjë me të. Ky parim duhet të udhëheqë jo vetëm vendimarrjen praktike, por edhe hartimin, interpretimin dhe zbatimin e të gjithë legjislacionit që ndikon në mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve. Interesi më i mirë i fëmijës kërkon mbrojtjen dhe promovimin e integritetit fizik, psikologjik, moral dhe shpirtëror të tij, duke marrë gjithmonë parasysh karakteristikat individuale dhe rrethanat jetësore të secilit fëmijë;	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Interesi më i mirë i fëmijës është parimi kryesor dhe themelor i përcaktuar në nenin 3 të KDF-së dhe përbën bazën për çdo veprim, vendim apo ndërhyrje që ndikon në jetën e fëmijës, duke siguruar mbrojtjen dhe promovimin e mirëqenies fizike, psikologjike dhe sociale të fëmijës); (Zhvillimi gradual i aftësive dhe respektimi i pikëpamjes së fëmijës janë në përputhje me nenet 5 dhe 12 të KDF-së, që nxisin pjesëmarrjen aktive të fëmijës në vendimet që e prekin, duke marrë parasysh moshën dhe pjekurinë e tij). (Parimi i mosdiskriminimit, siç parashikohet në nenin 2 të KDF-së dhe dokumentet e të drejtave të njeriut, siguron trajtim të barabartë për të gjithë fëmijët, pavarësisht prejardhjes, gjinisë, etnisë, gjuhës apo statusit social). Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) (Ndonëse nuk është specifike për fëmijët, KEDNJ mbron të drejtat themelore si e drejta për jetë, e drejta për trajtim dinjitoz, e drejta për privatësi, etj., të cilat aplikohen edhe për fëmijët). Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) (ka zhvilluar jurisprudencë të konsiderueshme mbi të drejtat e fëmijëve, duke promovuar parimin e interesit më të mirë të fëmijës). Karta Evropiane për të Drejtat e Fëmijëve e Bashkimit Evropian (Neni 24 i Kartës garanton të drejtat e fëmijëve, përfshirë mbrojtjen dhe kujdesin e duhur, pjesëmarrjen në vendimarrje dhe mbrojtjen kundër diskriminimit).	Përkundër faktit që për herë të parë në legjislacionin e Kosovës inkorporohen në mënyrë unike parimet kryesore të KDF-së, ato akoma nuk kuptohen dhe interpretohen sipas asaj që ka përcaktuar KDF-ja dhe vetë LMF-ja. Siç kemi cekur edhe në të gjeturat më lart (shih tabelën që përshkruan zbatimin e parimeve në KDM), në krahasim me vitet e mëparshme është bërë përparim në aspektin e referimit tek këto parime, me theks të veçantë tek parimi i interesit më të mirë të fëmijës. Megjithatë, profesionistët në raste të rralla ofrojnë një arsyetim për këtë parim në vendimet e tyre. Në shumë raste, referenca mbetet më tepër një përshkrim tekstual sesa një arsyetim i duhur që do të përputhej me thelbin e vendimit. Interpretimi apo referimi tek parimi i interesit më të mirë mbetet vetëm deklarativ dhe jo substancial dhe i udhëhequr nga kuptimi i drejtë i këtij parimi. Në raportin ex-officio nr. 468/2022 të datës 03.04.2023, Institucioni i Avokatit të Popullit në rastin e hetimit kur fëmija ka qenë viktimë e dhunimit: "... vlerëson se autoritetet nuk e kishin vlerësuar drejt interesin më të mirë të fëmijës dhe as rrethanat e rastit, duke ua falur besimin prindërve, ndonëse vlerësimi i rrezikut ishte i lartë." Edhe pse interpretimi në rastin konkret shfaqet se ishte bërë në "interesi e fëmijës", pasojat e largimit të fëmijës nga strehimorja ishin vendimtare që fëmija, si viktimë potenciale e trafikimit, të bëhej viktimë e abuzimit seksual me pasoja shumë të rënda. Pra, në rastin konkret interesi më i mirë i fëmijës del që nuk ishte vlerësuar drejt dhe nuk ishin marrë parasysh kërkesat e ligjit, ashtu siç theksohet në LMF: "historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen."

Parimet e mbrojtjes së fëmijës		
Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
■ Zhvillimi gradual të aftësive: nënkupton se ushtrimi i të drejtave të fëmijës duhet të ndodhë në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij, duke marrë parasysh zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të fëmijës për të kuptuar, për të marrë vendime dhe për të marrë përgjegjësi; - Respektimi i pikëpamjes së fëmijës: kërkon që në të gjitha veprimet dhe vendimet që kanë ndikim mbi fëmijën, qofshin ato të marra nga prindërit, kujdestarët, institucionet shtetërore apo profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, t'i jepet fëmijës e drejta për të shprehur lirshëm pikëpamjet e tij. Ky parim e njeh fëmijën si subjekt aktiv të të drejtave, me kapacitet për të ndikuar në çështjet që e prekin, për aq sa moshë dhe shkallë e pjekurisë së tij e lejojnë. Institucionet janë të detyruara të vlerësojnë pikëpamjet e fëmijës në mënyrë të përshtatshme dhe t'i marrin ato në konsideratë gjatë vendimmarrjes. Mosdiskriminimi: çdo fëmijë ka të drejtë të gëzojë të drejtat e garantuara me ligj, pa asnjë formë diskriminimi, pavarësisht gjinisë, racës, aftësisë, statusit social, etnisë, religjionit, gjuhës apo ndonjë karakteristike tjetër personale apo familjare. Ky parim kërkon që institucionet shtetërore, ofruesit e shërbimeve dhe profesionistët për mbrojtjen e fëmijës të marrin masa proaktive dhe efektive për të parandaluar dhe adresuar të gjitha format e diskriminimit që mund të përjetojë një fëmijë në çfarëdo fushe të jetës. Gjithashtu, prindërit, kujdestarët apo persona të besueshëm që konsiderojnë se një fëmijë është trajtuar në mënyrë të pabarabartë apo diskriminuese, kanë të drejtë të iniciojnë procedura ligjore për mbrojtjen e tij, në përputhje me ligjin përkatës për mbrojtje nga diskriminimi.	Konventa e Këshillit të Evropës mbi Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual dhe Protokollit i saj (Lanzarote, 2007) (synon parandalimin dhe ndëshkimin e abuzimit seksual ndaj fëmijëve, duke siguruar mbrojtje gjithëpërfshirëse). Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (përfshijnë udhëzime për respektimin e interesit më të mirë të fëmijës në të gjitha proceset ligjore dhe institucionale). Direktiva 2016/800/EU mbi të drejtat e fëmijëve që janë viktime ose dëshmitarë në procedurat penale.	Institucionet e përfshira nuk kishin marrë për bazë të gjitha elementet e nevojshme që vendimi i tyre të ishte në plot kuptimin e fjalës në “interesin më të mirë të fëmijës”. Dhe nuk është rastësi që Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve i Kombeve të Bashkuara thekson rëndësinë e të kuptuarit të parimit të interesit më të mirë të fëmijës sipas këtyre tri koncepteve : a) Kjo është e drejtë substanciale dhe e patjetërsueshme: E drejta e fëmijës për t'ia vlerësuar dhe konsideruar si primar interesin e tij më të mirë, kur interesa të ndryshëm janë duke u konsideruar në të njëjtën kohë, dhe për të garantuar që kjo e drejtë do të zbatohet kurdo që një vendim do të duhej me u marrë në lidhje me fëmijën, për grupin e identifikuar dhe jo të identifikuar të fëmijëve apo fëmijëve në përgjithësi. b) Parim fundamental ligjor me karakter mbizotërues me rastin e interpretimeve ligjore: Nëse ndonjë dispozitë është e hapur për një apo më tepër interpretime, interpretime i cili në mënyrë efektive i shërben interesit të fëmijës duhet të përzgjedhet. Të drejtat e përcaktuara në KDF dhe Protokolet Opsionale ofrojnë kornizën për interpretim. c) Rregull procedurale që udhëheq zbatuesit e legjislationit në përgjithësi: Kurdo që një vendim duhet të mirret dhe i cili ndikon tek ndonjë fëmijë i caktuar, grupin e identifikuar apo fëmijët në përgjithësi, procesi i këtillë i vendimmarrjes duhet të përbëjë një vlerësim të ndikimit të mundshëm (pozitiv apo negativ) të vendimit në lidhje me fëmijën apo fëmijët. Vlerësimi dhe përcaktimi i interesit më të mirë të fëmijës kërkon garancione procedurale. Për më tepër, arsyetimi duhet të tregojë që e drejta e caktuar është marrë parasysh. Në këtë aspekt, shtetet anëtare duhet të sqarojnë: ■ se si është respektuar e drejta në atë vendim; ■ qka është konsideruar si interesi më i mirë i fëmijës; ■ në cilat kritere është bazuar; ■ se si interesi më i mirë i fëmijës është peshuar kundrejt konsideratave tjera;

KOMENT:

Parimi i interesit më të mirë të përcaktuar në nenin 5 të LMF, respektivisht paragrafët 1-3 nuk përbën në vetvete vetëm një të drejtë substanciale apo procedurale. Ai përbën më shumë se një parim për t'u konsideruar gjatë zbatimit të drejtave të tjera. Është për t'u theksuar se këto paragrafë krijojnë detyrime për prindërit, kujdestarin, institucionet, shërbimet, profesionistët, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative që të konsiderojnë interesin më të mirë të fëmijës në të gjitha veprimet lidhur me fëmijët. Është pikërisht detyrimi i tyre për të marrë masa për të siguruar interesin më të mirë të fëmijës si konsideratë parësore, ai që përbën prerogativën kryesore në lidhje me shtrirjen e këtij koncepti si në fushën e veprimtarisë publike, shtetërore ashtu edhe në atë private. Nga mënyra se si janë formuluar paragrafët kuptohet se interesi më i mirë i fëmijës nuk është i vetmi faktor në situata kur do të duhet të vendoset për veprime lidhur me fëmijët. Është pikërisht fraza “konsiderata mbizotëruese dhe më e larta” e cila e nënkupton këtë dhe njëkohësisht jep zgjidhjen e përparësive në interesat e ndërthurura në një situatë të caktuar. Komiteti i të Drejtave të Fëmijës i Kombeve të Bashkuara (KDFKB)¹⁵ kur ka interpretuar parimin e interesit më të mirë të fëmijës, ka theksuar që është një detyrim i vendit për të inkuorporuar apo pasqyruar parimin e interesit më të mirë të fëmijës në legjislacionin e brendshëm dhe për ta zbatuar atë në çdo procedurë për fëmijët.

¹⁵ Komiteti është një mekanizëm i krijuar nga Kombet e Bashkuara për të monitoruar zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe protokoleve opsionale.

Themelimi i Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijëve¹⁶

Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës themelohen sipas nenit 30 Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe përfaqësojnë një ndër risitë më domethënëse dhe të avancuara në kuadër të sistemit të mbrojtjes institucionale dhe profesionale të fëmijëve viktimë. Këto struktura janë konceptuar si qendra të integruara që operojnë sipas modelit “nën një kullm”, duke garantuar ndërhyrje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar. Aty fëmijës i ofrohen shërbime emergjente, mbrojtje të menjëhershme dhe strehim të përkohshëm për fëmijët që gjenden në rrezik serioz për shëndetin, sigurinë apo mirëqenien e tyre. Shtëpitë shërbejnë gjithashtu si hapësira të sigurta për zhvillimin e procedurave hetimore e gjyqësore, veçanërisht në rastet e dhunës dhe veprave penale kundër integritetit seksual, kur fëmijës është viktimë apo dëshmitar. Parimet kyçe të funksionimit të Shtëpive përfshijnë: ■ Ofrimi i shërbimeve 24/7: Të gjitha shërbimet për mbrojtjen e fëmijës ofrohen në mënyrë të pandërprerë, gjatë 24 orëve të ditës dhe shtatë ditëve të javës, në një hapësirë të vetme funksionale, me qëllim të adresimit të menjëhershëm dhe gjithëpërfshirës të nevojave të fëmijës viktimë; ■ Zbatimi i drejtësisë miqësore për fëmijët: Shtëpitë sigurojnë që fëmija të trajtohet me dinjitet dhe respekt, duke garantuar të drejtën për pjesëmarrje, informim dhe mbështetje psikologjike e ligjore. Respektohet e drejta e fëmijës për t'u dëgjuar dhe për të kontribuar në procesin që e prek atë drejtpërdrejt; ■ Reagim urgjent dhe pa vonesë të paarsyeshme: Në rastet kur ekziston rrezik për jetën apo mirëqenien e fëmijës, të gjitha vendimet dhe masat duhet të merren në mënyrë të menjëhershme, duke përjashtuar çdo lloj vonese që mund të çojë në pasojë të parikuperueshme. Prioriteti i profesionistëve duhet të jetë gjithmonë siguria dhe interesi më i mirë i fëmijës.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Neni 3 Interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë parësor në të gjitha veprimet që prekin fëmijët; Neni 12 E drejta e fëmijës për t'u dëgjuar në çdo proces që prek jetën e tij; Neni 19 Mbrojtja e fëmijës nga çdo formë dhune, keqtrajtim dhe abuzim; Neni 34 Mbrojtja nga shfrytëzimi seksual dhe keqpërdorimi). Udhëzuesi për Drejtësinë Miqësore të Fëmijëve i Këshillit të Evropës (parimet për sigurimin e trajtimit të ndjeshëm dhe mbrojtës për fëmijët gjatë procedurave gjyqësore, si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (Konventa e Lanzarotes); Konventa e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit Direktiva 2011/93/EU kundër Abuzimit dhe Shfrytëzimit Seksual të Fëmijëve; Direktiva 2012/29/EU për të Drejtat e Viktimave; Direktiva 2011/36/EU kundër Anti-Trafikimit Rrjeti Barnahus Standarde dhe Praktika më të Mira (standardet operationale të Barnahus) Organizata Botërore e Shëndetësisë, (Qasja multi disiplinore dhe e integruar për trajtimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve.	Përkundër shumë iniciativave për themelimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve, ato ende nuk janë themeluar dhe funksionalizuar. Megjithatë, deri më tani janë ndërmarrë disa hapa përgatitorë, përfshirë miratimin e aktit nënligjor që përcakton fushëveprimin dhe organizimin e shtëpive, si dhe zhvillimin e standardeve minimale strukturore dhe funksionale, përfshirë edhe procedurat standarde të veprimit. Gjithashtu, është ndarë buxhet¹⁷, për themelimin e disa prej shtëpive. Edhe pse vetë mungesa e themelimit të këtyre shtëpive paraqet një sfidë dhe shqetësim serioz, sidomos duke pasur parasysh që kanë kaluar më shumë se gjashtë vite nga hyrja në fuqi e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës (LMF), ajo që paraqet shqetësim edhe më të madh është fakti që në mesin e profesionistëve ekzistojnë ende dilema dhe interpretime të ndryshme lidhur me mandatin e këtyre shtëpive. Këto dilema kanë të bëjnë pikërisht me konceptin bazë dhe mandatin e këtyre shtëpive. Edhe pse ato ende nuk janë themeluar dhe nuk janë testuar në praktikë, profesionistët kanë ngritur që tani dyshime dhe qëndrime paragjyqëse për sa i përket mundësisë së zbatimit të konceptit të paraparë, sipas të cilit brenda 72 orëve duhet të ndërmerret një trajtim i menjëhershëm për rastet e fëmijëve viktimë të abuzimit seksual. Kjo qasje paragjyqëse dhe mungesa e konsensusit profesional rreth mandatit të qartë të këtyre shtëpive rrezikon ta zbehtë qëllimin themelor të tyre, që është ofrimi i një reagimi të koordinuar, gjithëpërfshirës dhe të menjëhershëm në rastet e ndjeshme ashtu siç e ka përcaktuar LMF.

¹⁶ Në momentin e realizimit të vlerësimit, Shtëpitë për Mbrojtjen e Fëmijës akoma nuk janë themeluar

¹⁷ Qeveria e Kosovës ka ndarë mjete të veçanta buxhetore për ndërtimin e shtëpive të mbrojtjes së fëmijëve. Sipas Ligjit Nr. 07/L-041 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, është ndarë një shumë prej 300,000 eurosh për këtë qëllim (shih Tabela 3.2 – Projektet kapitale në nivel qendror, faqe 66). Gjithashtu, në bazë të Ligjit Nr. 08/L-193 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, janë paraparë 160,000 euro për vitin 2024 dhe 175,000 euro për vitin 2025 (shih Tabela 4.2 – Financimi i investimeve kapitale komunale, faqe 111).

Themelimi i Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijë		
Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
■ Qasje shumë disiplinore dhe bashkëpunim ndër institucional: Shtëpitë funksionojnë mbi bazën e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet profesionistëve nga fusha të ndryshme (psikologë, punonjës socialë, mjekë, prokurorë, policë etj.) dhe institucioneve përkatëse, për të siguruar një reagim të harmonizuar, gjithëpërfshirës dhe jo traumatizues për fëmijën. ■ Shërbime gjithëpërfshirëse dhe të arritshme: Fëmijës dhe prindit apo kujdestarit jo-abuzues u ofrohen shërbime që adresojnë jo vetëm nevojat emergjente dhe të sigurisë, por edhe ato psiko sociale, edukative dhe ligjore, me qëllim të rimëkëmbjes së plotë të fëmijës. Garancia e standardeve të larta profesionale: Profesionistët që punojnë në Shtëpi pajisen me trajnime të specializuara dhe resurse të përstatshme për të ofruar një qasje të ndjeshme ndaj traumës, të drejtë dhe efektive për fëmijët viktimë apo dëshmitarë. Zbatim efikas dhe profesional brenda afateve ligjore: Të gjitha shërbimet dhe ndërhyrjet ofrohen në përputhje me standardet ligjore dhe brenda afateve të përcaktuara, duke shmangur çdo pengesë burokratike që mund të cenojë mbrojtjen e fëmijës.		Mos funksionalizimi i shtëpive jo vetëm që vonon trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijëve viktimë, por lë zbrazëti të mëdha në zinxhirin institucional të mbrojtjes, duke krijuar një rrezik të drejtpërdrejtë për përsëritje të abuzimit apo për përkeqësim të gjendjes së fëmijës. Prandaj, është e domosdoshme që përveç aspekteve teknike dhe buxhetore, të investohet edhe në rritjen e vetëdijes dhe kapaciteteve të profesionistëve për të kuptuar dhe përkrahur funksionin e këtyre shtëpive në përputhje me standardet e mbrojtjes së fëmijës.
Modeli Barnahus (Shtëpia e Fëmijës) si model ndërkombëtar! Prezanton një qasje ndërkombëtare inovative për mbrojtjen e fëmijëve viktimë të dhunës dhe abuzimit, e cila ka nisur në Islandë dhe është përhapur në shumë vende të Evropës dhe botës. Ky model ofron një ambient të sigurt dhe mbrojtës ku fëmijët mund të japin dëshminë e tyre një herë, ndërkohë që në të njëjtin vend bashkëpunojnë dhe koordinohen institucionet e drejtësisë, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale. Barnahus minimizon nevojën për intervista dhe procedura të shumta traumatike për fëmijët dhe përmirëson cilësinë e mbrojtjes së tyre. Shtetet në të cilat është prezent ky model: Islandë, Suedi, Norvegji, Danimarkë, Finlandë¹⁸ etj		

¹⁸ Për të kuptuar më tepër për konceptin dhe vendet që zbatojnë klikoni në këtë webfaqe: <https://barnahus.eu/barnahus/about-barnahus/>

Sistemi institucional formal dhe linja e telefonit për fëmijë¹⁹

Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Sistemi institucional formal dhe linja e telefonit për fëmijë përfaqëson një mekanizëm thelbësor të mbrojtjes së fëmijëve në kuadër të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, i cili synon të ofrojë ndihmë të menjëhershme, këshillim profesional dhe referim institucional për fëmijët që përballen me dhunë, abuzim, neglizhencë apo trafikim. E dizajnuar si një shërbim falas dhe i disponueshëm 24/7 në gjithë territorin e Kosovës, linja ofron mbështetje pa diskriminim mbi bazën e moshës apo prejardhjes. Ajo funksionon si një kanal i drejtpërdrejtë për raportimin e rasteve nga fëmijët, prindërit apo profesionistët, duke mundësuar ndërhyrje emergjente, mbështetje emocionale dhe orientim për trajtim të mëtejshëm. Linja menaxhohet nga punonjës të specializuar të mbrojtjes së fëmijës, dhe luan rol kyç në identifikimin, koordinimin dhe ndërlidhjen e shërbimeve mbështetëse, duke vepruar gjithmonë në përputhje me interesin më të mirë të fëmijës.	Funksionimi i sistemit bazohet në parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijës, duke garantuar të drejtën për mbrojtje, pjesëmarrje dhe trajtim të dinjitetshëm. Linja telefonike është në përputhje me praktikat ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve dhe rekomandimet e institucioneve të specializuara si UNICEF dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Ofrimi i mbështetjes 24/7 dhe pa diskriminim reflekton standardet më të larta të qasjes në shërbime të mbrojtjes së fëmijëve. Menaxhimi nga profesionistë të trajnuar garanton mbrojtje psikologjike dhe konfidencialitet, duke u siguruar fëmijëve një ambient të sigurt për raportim dhe ndihmë.	Edhe sistemi institucional dhe linja telefonike për fëmijë, njësoj si shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës, ndonëse ishin promovuar si ndër reformat më të mëdha në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë, fatkeqësisht, edhe pas më shumë se gjashtë vitesh nga hyrja në fuqi e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, vazhdojnë të ndajnë të njëjtin fat: ato ende nuk janë krijuar dhe funksionalizuar. Njësoj, si në rastin e shtëpive për mbrojtje, edhe këtu janë ndërmarrë disa hapa përgatitorë. Konkretisht, është zhvilluar një udhëzues dhe një hartë konceptuale për krijimin dhe funksionalizimin e këtij mekanizmi, që parashihet me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës. Ky udhëzues përmban në mënyrë të detajuar elementet themelore të nevojshme për operimin e linjës, përfshirë format organizative, mënyrën e themelimit, buxhetin e nevojshëm, strukturën e stafit të angazhuar, si dhe aspekte të tjera teknike që lidhen me funksionimin efektiv të këtij shërbimi. Megjithatë, vonesa në zbatimin praktik të këtij mekanizmi ka pasoja të drejtpërdrejta për fëmijët, duke lënë një zbrazëti të rëndësishme në sistemin e mbrojtjes. Linja telefonike për fëmijë është një prej mjeteve më të shpejta dhe më të qasshme për raportim, mbrojtje emergjente dhe orientim drejt shërbimeve të duhura, veçanërisht për fëmijët në situata të dhunës, abuzimit apo neglizhencës. Mos funksionalizimi i saj e zbeh mundësinë që fëmijët të kenë një kanal të besueshëm komunikimi dhe ndihme, dhe e vështirëson ndjeshëm ndërhyrjen në kohë nga autoritetet kompetente.

¹⁹ Në momentin e realizimit të vlerësimit, Linja e Telefonit për Fëmijë akoma nuk është funksionale

Drejtësia miqësore		
Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Neni 55 i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës vendos parimet themelore të drejtësisë mike ndaj fëmijëve, duke garantuar që të gjitha procedurat penale, civile apo administrative të respektojnë plotësisht të drejtat e fëmijës, në përputhje me moshën, nevojat dhe pjekurinë e tij. Ky nen përcakton që procedurat duhet të jenë të përshtatshme, të ndjeshme, të shpejta dhe të orientuara drejt mirëqenies së fëmijës. Ai obligon institucionet të krijojnë kushte të sigurta për dëshminë e fëmijës, të shmangin ndërhyrjet e panevojshme dhe të garantojnë ndihmë juridike, psikologjike, sociale dhe financiare, si dhe praninë e personave mbështetës gjatë procedurave. Po ashtu, përcaktohet që fëmijët dëshmitarë dhe viktimat të kenë qasje në mjedise të përshtatura dhe të intervistohen nga profesionistë të trajnuar, gjithmonë duke ruajtur distancën nga kryerësi i supozuar dhe duke i dhënë prioritet çështjeve që i përfshijnë ata.	Konvent për të Drejtat e Fëmijës (Nenet 3, 12, 19, 37, 40 të cilat mbrojnë interesin më të mirë të fëmijës, të drejtën për të dëgjuar dhe për të mos u viktimizuar gjatë procedurave.); Udhëzuesi për Drejtësinë Miqësore të Fëmijëve i Këshillit të Evropës (kërkojnë procedura të ndjeshme dhe të përshtatura për fëmijët në kontakt me sistemin e drejtësisë).	Zbatimi i kësaj dispozite mbetet i kufizuar dhe sporadik, pavarësisht ekzistencës së një baze të qartë ligjore dhe të Udhëzimit Administrativ të nxjerrë nga Ministria e Drejtësisë, i cili është në fuqi tashmë për më shumë se pesë vite. Niveli i njohurive për këtë udhëzim vijon të jetë i ulët në mesin e profesionistëve të sistemit të drejtësisë dhe institucioneve të përfshira, çka reflekton mungesën e trajtimeve të strukturuar dhe ndërgjegjësimi institucional. Në praktikë, një numër i konsiderueshëm i fëmijëve, si viktimat ashtu edhe dëshmitarë, vazhdojnë të intervistohen në ambiente të papërshtatshme dhe nga profesionistë që shpesh veprojnë në mënyrë formale dhe jo të ndjeshme ndaj nevojave të fëmijës. Një shqetësim i veçantë përbën prania e zyrtarëve të policisë me uniformë gjatë trajtimit të rasteve kur fëmija është viktimë, veçanërisht gjatë intervistimit, një fazë thelbësore që kërkon qasje të kujdesshme psikologjike dhe emocionale. Edhe pse në të kaluarën janë ndërmarrë disa përpjekje për të shmangur këtë praktikë, rikthimi i uniformës së fundmi përbën regres dhe rrezikon të cenojë rëndë mirëqenien dhe sigurinë emocionale të fëmijës, si dhe të dëmtojë integritetin e procesit hetimor. Po ashtu, mungon një mekanizëm funksional për monitorimin e zbatimit të udhëzimit, dhe nuk parashihen sanksione për rastet e moszbatimit. Moszbatimi i kësaj dispozite cenon seriozisht mirëqenien e fëmijës, duke e ekspozuar atë ndaj traumës shtesë, rrezikut të viktimizimit të përsëritur dhe mungesës së mbështetjes adekuate gjatë procesit penal. Kjo ndikon negativisht në cilësinë e hetimeve dhe besueshmërinë tek sistemi të drejtësisë, duke përbërë një shkelje të të drejtave themelore të fëmijës të garantuara me ligj dhe instrumente ndërkombëtare.

Ndihma juridike dhe qasja në organet e drejtësisë

Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Neni 56 garanton ndihmë juridike falas për fëmijët që janë viktime, kryes të veprave kundërligjore apo dëshmitarë, me qëllim mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të tyre gjatë procedurave ligjore. Ai përfshin përfaqësimin ligjor, këshillimin për të drejtat dhe interesin më të mirë të fëmijës, si dhe informimin e plotë dhe të menjëhershëm për proceset dhe vendimet gjyqësore. Po ashtu, fëmijës i garantohet e drejta të shprehë mendimet dhe shqetësimet e tij gjatë gjithë procesit, duke siguruar që ato të merren parasysh me ndjeshmëri dhe respekt, duke forcuar kështu një qasje të drejtësisë miqësore ndaj fëmijëve.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Nenet 12, 37 dhe 40 e drejta e fëmijës për të shprehur mendimin dhe për të marrë mbrojtje gjatë proceseve ligjore.) Standardet e Drejtësisë për të Mitur të Kombeve të Bashkuara (Rregullat e Pekinit) (garantim i trajtimit të ndjeshëm dhe të përshtatshëm ligjor për fëmijët). Udhëzuesi për Drejtësinë Miqësore të Fëmijëve i Këshillit të Evropës (theks mbi mbrojtjen dhe mbështetjen ligjore të fëmijëve). Direktiva 2013/48/EU mbi të drejtën për qasje në avokat në procedurat penale dhe për të informuar një palë të tretë në lidhje me privimin nga liria. Direktiva 2012/29/EU për vendosjen e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimin.	Siç është theksuar më herët (shih më lartë tabelën për mbrojtjen ligjore), ndihma juridike falas, ndonëse e paraparë me legjislacion, në praktikë ofrohet kryesisht për të përmbyshur një kërkesë formale procedurale, dhe jo si një mbështetje e mirëfilltë dhe e specializuar për rastet që përfshijnë fëmijë. Shpesh mungon ekspertiza e nevojshme për trajtimin e ndjeshëm dhe të duhur të rasteve që lidhen me fëmijët. Ka mungesë të dukshme të specializimit në mesin e profesionistëve që ofrojnë ndihmë juridike, përfshirë avokatët dhe mbrojtësit e viktimave, të cilët shpesh nuk janë të trajnuar posaçërisht për të punuar me fëmijët. Kjo cenon cilësinë e përfaqësimit ligjor dhe ndikon negativisht në trajtimin e ndjeshëm dhe të përshtatshëm të rasteve që përfshijnë fëmijë, duke rritur rrezikun që të drejtat dhe interesat e tyre të mos mbrohen siç duhet. Kjo dispozitë, përveçse rregullon ofrimin e ndihmës juridike falas, garanton gjithashtu të drejtën thelbësore të fëmijës për qasje efektive në organet e drejtësisë. Megjithatë, kjo e drejtë shpesh keqkuptohet ose anashkalohet nga profesionistët, duke mos u zbatuar në përputhje me përmbajtjen e dispozitës dhe standardet ndërkombëtare për drejtësi të përshtatshme për fëmijët. Si rezultat, fëmijët përballen me barriera serioze në realizimin e të drejtave të tyre ligjore dhe pjesëmarrjen aktive në proceset që i prekin drejtpërdrejt. Niveli i zbatimit të pjesës të dispozitës që ndërlidhet me qasjen në organet e drejtësisë mbetet larg standardeve të pritura. Praktika aktuale në sistemin e drejtësisë ende nuk e trajton fëmijën si subjekt aktiv dhe të përfshirë thellësisht në procesin gjyqësor, si një person me të drejta dhe kapacitet për të marrë vendime, aty ku kjo është e mundur. Përkundrazi, fëmija vazhdon të shihet kryesisht si një individ i varur nga të tjerët, me kapacitete të kufizuara për vendosje dhe pjesëmarrje në çështjet që e prekin të drejtat dhe interesat e tij apo saj.

Ndihma mjekësore, psikologjike, rehabilitimi dhe masat për re integrim

Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Neni 57 i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës garanton ofrimin e ndihmës mjekësore dhe psikologjike falas për fëmijët viktimë, me qëllim rehabilitimin dhe ri integrimin e tyre në shoqëri. Ai përfshin trajtim emergjent, kujdes afatgjatë, mbrojtje nga kontaktet me abuzuesin dhe ndalimin e presionit apo manipulimit ndaj fëmijës. Ligji thekson nevojën për asistencë të vazhdueshme që përfshin mbështetje edukative, profesionale dhe psikologjike deri në rehabilitimin e plotë, gjithmonë duke ruajtur privatësinë, sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës. Po ashtu, komunat janë të obliguara të ndajnë buxhet për një fond emergjent për t'iu përgjigjur rasteve urgjente në përputhje me standardet e përcaktuara.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Nenet 19 dhe 39 përcatojnë të drejtën për rehabilitim fizik dhe psikologjik pas abuzimit apo neglizhencës). Udhëzuesi për Drejtësinë Miqësore të Fëmijëve i Këshillit të Evropës dhe Standardet e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit (theksojnë nevojën për shërbime të specializuara dhe mbështetje gjithëpërfshirëse për viktimat fëmijë). Protokollet opsionale të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, (obligojnë shtetet të ofrojnë mbështetje gjithëpërfshirëse për viktimat fëmijë, përfshirë shërbimet pasuese dhe kthimin në jetën normale).	Të gjithë profesionistët e intervistuar ndajnë të njëjtin mendim në mënyrë unanime: institucionet nuk arrijnë të ofrojnë mbështetjen e nevojshme për fëmijët viktimë, jo vetëm në zbatimin e kësaj dispozite specifike, por në mënyrë të përgjithshme gjatë gjithë trajektore së mbrojtjes. Ky dështim është veçanërisht i dukshëm në fazën post-gjyqësore, e cila konsiderohet nga profesionistët si një prej periudhave më kritike dhe sfiduese për fëmijën. Pavarësisht rezultatit të procesit gjyqësor, qoftë me dënim apo jo të autorit, fëmijët vazhdojnë të përballen me pasojat psikologjike, sociale dhe edukative të dhunës së përjetuar. Pas përfundimit të procedurës, mbështetja institucionale shpesh ndërpritet ose dobësohet ndjeshëm, duke lënë fëmijën dhe familjen të ekspozuar ndaj sfidave të mëtejshme pa mbështetje të strukturuar. Megjithatë në periudhën para dhe gjatë procesit gjyqësor disa elemente janë përgjithësisht e qasshme siç është ndihma mjekësore apo ajo e strehimit emergjent, por shërbimet psikologjike dhe ato të rehabilitimit janë të kufizuara, sidomos në nivel komunal. Në rastet kur fëmijët nuk mund të qëndrojnë në familje për shkak të rrezikut të lartë ose mungesës së aftësive prindërore, Qendra për Punë Sociale, në koordinim me Prokurorinë, ka mandat të sigurojë mbrojtje përmes vendosjes së përkohshme në kujdes alternativ, si strehimi rezidencial. Aktualisht në Kosovë funksionojnë tri strehimore për fëmijët viktimë të abuzimit dhe trafikimit, njëra publike dhe dy të menaxhuara nga OJQ-të. Këto ofrojnë strehim dhe shërbime rehabilituese, përfshirë mbështetjen psikologjike dhe sociale. Përkundër progresit në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të këtyre strehimoreve në vitin 2025, mungesa e programeve për riintegrim afatgjatë mbetet një sfidë madhore. Fëmijët që dalin nga strehimoret shpesh përballen me rrethana të vështira dhe janë të rrezikuar të rikthehen në situata të abuzimit. Gjithashtu, mungesa e mbështetjes për familjet biologjike, si dhe kapacitetet e kufizuara të Qendrave për Punë Sociale, pengojnë procesin e rikthimit të sigurt të fëmijës në shtëpi dhe risin rrezikun e riviktimizimit.

Ndihma mjekësore, psikologjike, rehabilitimi dhe masat për re integrim

Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
		Komunat nuk ndajnë fonde të dedikuara për mbështetjen e fëmijëve në situata të rrezikut apo emergjencave. Në disa raste të izoluar, disa komuna kanë alokuar mjete të tilla, por këto mbeten përjashtim dhe ndodhin shumë rrallë. Në pjesën më të madhe të komunave, një fond i tillë nuk ekziston fare. Si pasojë, reagimi institucional në situata urgjente shpesh varet nga ndihma e organizatave joqeveritare ose donatorëve ndërkombëtarë, duke krijuar një varësi të pasigurt që e rrezikon qëndrueshmërinë dhe koherencën e sistemit të mbrojtjes së fëmijës. Kjo situatë është identifikuar dhe ngritur në mënyrë të vazhdueshme si shqetësim nga profesionistët që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, të cilët theksojnë se mungesa e fondeve emergjente kufizon ndjeshëm aftësinë e mekanizmave lokalë për të vepruar në kohë dhe në mënyrë të koordinuar ndaj rasteve të rrezikut akut. Po ashtu, koordinimi ndër institucional është i dobët. Mungon një qasje gjithëpërfshirëse për rehabilitim dhe re integrim, dhe rastet shpesh trajtohen në mënyrë të fragmentuar. Nuk ka monitorim të strukturuar apo vlerësim të cilësisë së shërbimeve të rehabilitimit, as tregues për të matur progresin e riintegrit.

Personat e dënuar për abuzim seksual apo shfrytëzim të fëmijës		
Çka është synuar!	Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare?	Niveli aktual zbatimit!
Neni 58 parashikon masa mbrojtëse kundër rrezikut nga personat e dënuar për abuzim seksual apo shfrytëzim të fëmijëve, duke u ndaluar atyre ushtrimin e profesioneve që përfshijnë kontakt me fëmijët, në përputhje me Kodin Penal. Po ashtu, ky nen obligon Këshillin Gjyqësor të Kosovës të krijojë një bazë të të dhënave me ADN-të e personave të dënuar për vepra kundër integritetit seksual, ndërsa institucionet arsimore ndalohen të punësojnë persona të tillë në sistemin e tyre. Këto masa synojnë të parandalojnë rikthimin në veprime abuzuese dhe të garantojnë sigurinë e fëmijëve në ambientet publike dhe edukative.	Konventa për të Drejtat e Fëmijës, veçanërisht neni 19 (mbrojtja nga abuzimi) dhe neni 34 (mbrojtja nga shfrytëzimi seksual). Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (Konventa e Lanzarotes), (obligon shtetet të ndalojnë punësimin në profesione që përfshijnë kontakt me fëmijët për persona të dënuar për abuzim seksual). Standardet e BE-së dhe praktikat më të mira të vendeve anëtare në lidhje me kontrollin dhe verifikimin penal për personat që aplikojnë për punë me fëmijët. Parimet e Parandalimit dhe Mos diskriminimit të Kombeve të Bashkuara në fushën e mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna seksuale.	Rregullorja Nr. 18/2024 për Regjistrat e Personave të Dënuar për Veprat Penale Kundër Integritetit Seksual, e miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës më 5 dhjetor 2024, ka hyrë në fuqi më 1 janar 2025. Përkundër vonesave nxjerrja e kësaj rregullore është për tu përshëndetur. (Më tepër rreth të gjeturave shih tabelën: Mbrojtja e fëmijëve nga kontakti me kryerësit e veprës penale)

3.2.3. Të gjeturat e përmbledhura që ndërlidhen me zbatimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur

Arritjet, sfidat dhe pengesat

Përkundër arritjeve të pakta në zbatimin praktik të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, të cilat përfshijnë përmirësime në respektimin e interesit më të mirë të fëmijës dhe krijimin e disa mekanizmave ligjorë për mbrojtjen e fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë, zbatimi në terren vazhdon të hasë në sfida dhe pengesa të konsiderueshme. Mungesa e kapaciteteve të specializuara, infrastruktura jo e përshtatshme, trajnimi i pamjaftueshëm i profesionistëve dhe koordinimi i dobët ndërinstitucional ndikojnë drejtpërdrejt në mbrojtjen efektive të fëmijëve gjatë kontaktit me sistemin e drejtësisë. Këto pengesa rrisin rrezikun e viktimizimit të mëtejshëm dhe pengojnë realizimin e plotë të të drejtave të fëmijëve në proceset gjyqësore.

- **Kodi i Drejtësisë për të Mitur është në përputhshmëri me instrumente ndërkombëtare:** nga analiza e dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, rezulton se ky Kod është në përputhje të konsiderueshme me standardet ndërkombëtare dhe evropiane për drejtësinë për fëmijë. Dispozitat e tij pasqyrojnë parimin e interesit më të mirë të fëmijës, garantojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë, dhe

sigurojnë ruajtjen e integritetit procedural edhe në raste komplekse. Në tërësi, KDM ofron një bazë të fortë për ndërtimin e një sistemi të drejtësisë për fëmijët, në përputhje me instrumentet ndërkombëtare përkatëse, përfshirë Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe Direktivat e Bashkimit Evropian.

■ **Zbatueshmëria e ulët e pjesës së pestë të Kodit të Drejtësisë për të Mitur:**

dispozitat e pjesës së pestë të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, të cilat rregullojnë aspektet procedurale, masat dhe garancionet për mbrojtjen e fëmijës viktimë dhe dëshmitarë, mbeten larg zbatimit të plotë dhe efektiv. Fatkeqësisht, një pjesë e këtyre dispozitave nuk zbatohen fare, zbatohen vetëm pjesërisht, ose në disa raste zbatohen në mënyrë të pasaktë dhe në kundërshtim me qëllimin e përcaktuar nga ligjvënësi. Kjo mospërputhje ndërmjet legjislacionit dhe praktikës paraqet një pengesë serioze për funksionimin e drejtë dhe të drejtë të sistemit të drejtësisë për fëmijë;

■ **Mos kuptim ose referim të gabuar të terminologjisë:** Është evidentuar një mungesë e theksuar e kuptimit të saktë, si dhe referime të gabuara në përdorimin e terminologjisë përkatëse nga ana e profesionistëve. Termat si «i mitur», «fëmijë», «i dëmtuar» apo «viktimë», në raste të caktuara janë përdorur në mënyrë të ndërrueshme, pa vetëdijen se përdorimi jo i saktë i këtyre termave mund të ndikojë negativisht në statusin e fëmijës si viktimë dhe potencialisht të favorizojë kryesin e veprës penale. Kodi i Drejtësisë për të Mitur, në nenin 3, përcakton qartazi dallimet ndërmjet këtyre koncepteve dhe thekson rëndësinë e përdorimit të drejtë të terminologjisë, si bazë për garantimin e trajtimit të duhur të fëmijës në procedurat penale. Këtë të gjetur e konstaton edhe raporti i Institucioni të Avokatit të Popullit²⁰ i cili: *“vëren se autoritetet shtetërore, që kishin qenë të përfshira në rast, por edhe disa media, fëmijën 11 vjeç e përmendin si të mitur, që në frymën e zbatimit të këtij kodi dhe rrethanave të tjera jo që është vetëm shtrembërim i fakteve por mund të konsiderohet si riviktimizim i fëmijës, shto këtu faktin pa konstatuar moshën e të dyshuarve për veprën në fjalë, mes tjerash e ngre nivelin e përgjegjësisë të viktimës po ashtu edhe të personit/ave si kryerës të veprave penale...”*

■ **Fëmijët dëshmitarë mbeten nën hijen e fëmijëve viktimë:** edhe pse legjislacioni në fuqi, në pjesën më të madhe të dispozitave që lidhen me mbrojtjen e fëmijës, parashikon në mënyrë të barabartë mbrojtjen e fëmijëve pavarësisht statusit të tyre në procedure, qoftë si viktimë apo dëshmitarë, mbetet shqetësues fakti që në praktikë profesionistët rrallëherë u kushtojnë fëmijëve dëshmitarë të njëjtin kujdes dhe vëmendje sikurse fëmijëve viktimë. Kjo situatë

²⁰ Raport ex-officio nr.468/2022 Detyrimet pozitive të shtetit për mbrojtjen e fëmijës nga dhuna (nr.protokoli 607/2023 datë 03.04.2023).

shpesh vjen si rezultat i paqartësive lidhur me statusin procedural të fëmijës, sidomos në rastet e dhunës në familje apo të formave të tjera të ndërlidhura të dhunës, ku fëmija mund të jetë njëkohësisht si viktimë ashtu edhe dëshmitar. Për pasojë, fëmijëve dëshmitarë shpeshherë nuk u ofrohet mbrojtja dhe trajtimi i duhur gjatë procedurave. Për më tepër, në emër të 'efikasitetit të procedurës', ndodh që të drejtat e tyre të mos respektohen plotësisht, duke i ekspozuar ata ndaj trajtimeve të papërshtatshme dhe mungesës së mbështetjes apo shërbimeve që u takojnë me ligj.

- **Mungesa e profileve të specializuara:** vazhdon të jetë një nga boshllëqet më serioze në sistemin e drejtësisë për fëmijë në Kosovë. Përkundër më shumë se dy dekadave të reformave institucionale në këtë fushë, që kanë përfshirë hartimin e dhjetëra kurrikulave, udhëzimeve praktike dhe doracakëve për trajtimin e rasteve me fëmijë viktime apo dëshmitarë, sistemi ende nuk ka arritur të krijojë dhe ruajë një kornizë të qëndrueshme të profesionistëve të specializuar. Edhe në rastet kur janë caktuar policë, prokurorë apo gjyqtarë të dedikuar për të mitur, specializimi i tyre në drejtësinë për fëmijë është shpesh i pjesshëm. Më shqetësuese është tendenca që edhe ata profesionistë që kanë ndërtuar kapacitete në këtë fushë transferohen në sektorë të tjerë për arsye karriere ose avancohen në nivele më të larta gjyqësore dhe prokuroriale, siç është rasti me kalimin e tyre në Gjykatën apo Prokurorinë e Apelit. Kjo krijon boshllëk të vazhdueshëm institucional dhe cenon ndërtimin e një kuadri të qëndrueshëm profesional, i cili është thelbësor për mbrojtjen dhe trajtimin e ndjeshëm dhe të duhur të fëmijëve në kontakt me sistemin e drejtësisë.

- **Profesionistët për mbrojtjen e fëmijës ende punojnë sipas modelit të punës në zyrë:** pavarësisht zotimeve institucionale, përpjekjeve të ndërmarra dhe disa të arritave të prekshme, profesionistët që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijës vazhdojnë të funksionojnë kryesisht sipas modelit tradicional të punës së bazuar në zyrë. Ky model nënkupton se është fëmija ai që duhet të shkojë tek profesionistët dhe jo anasjelltas. Në vend që këta profesionistë të jenë proaktivë dhe të ofrojnë mbështetje dhe shërbime aty ku ndodhet fëmija dhe ku identifikohet nevoja, praktika institucionale vazhdon të mbështetet në qasje formale, duke kërkuar që fëmija të përshtatet me strukturat ekzistuese dhe të ndjekë procedurat burokratike, shpesh të papërshtatshme për moshën dhe situatën e tij. Megjithatë korniza ligjore është ndërtuar në përputhje me standardet ndërkombëtare, zbatimi në praktikë i qasjes "me fëmijën në qendër" mbetet i kufizuar.

- **Burokracia mbi qasjen miqësore ndaj fëmijës:** disa prej profesionistëve për mbrojtjen e fëmijës ende e konsiderojnë të vështirë ose të pamundur zbatimin në praktikë të konceptit të drejtësisë së orientuar drejt fëmijës dhe të bazuar në qasje miqësore. Është evidentuar se profesionistët kanë më shumë lehtësi të veprojnë sipas modelit burokratik tradicional, sesa të adoptojnë një qasje miqësore dhe të ndjeshme ndaj fëmijës. Kjo qasje burokratike shpesh rezulton në vendosjen e procedurave mbi nevojat individuale të fëmijës dhe cenon parimin e interesit më të mirë të tij. Për më tepër, Udhëzimi Administrativ për drejtësinë miqësore ndaj fëmijës²¹, i cili ofron standarde dhe udhëzime për zbatim praktik, vazhdon të mos implementohet në mënyrë konsistente në nivel institucional.
- **Mungesa e përshtatshmërisë së dukjes dhe ambienteve për fëmijët viktimë:** fatkeqësisht, gjatë fazës së hetimeve edhe në disa raste edhe fazat tjera, praktika institucionale shpesh nuk është e ndjeshme ndaj nevojave të fëmijës. Zyrtarët e policisë, paraqiten me uniformë zyrtare edhe gjatë ndërveprimit me fëmijën, çka mund të shkaktojë frikë apo ankth te fëmija. Për më tepër, intervistimi dhe veprimet e tjera procedurale shpesh zhvillohen në ambiente zyrtare të papërshtatshme për fëmijët, si në zyrat e prokurorisë, qendrat për punë sociale apo hapësira të tjera institucionale që nuk ofrojnë një mjedis të sigurt, të ngrohtë dhe të favorshëm për një komunikim të hapur dhe të qetë. Kjo jo vetëm që ndikon negativisht në mirëqenien emocionale të fëmijës, por gjithashtu rrezikon cilësinë dhe saktësinë e dëshmisë së dhënë prej tij.
- **Mospërdorimi i dhomave miqësore për fëmijë:** në disa institucione kyçe, si Policia, Prokuroria, Gjykatat apo edhe Qendrat për Punë Sociale, janë themeluar dhoma miqësore me qëllim krijimin e një ambienti të përshtatshëm dhe të sigurt për fëmijët gjatë procedurave penale. Megjithatë, pavarësisht ekzistencës së këtyre hapësirave, në shumë raste ato mbesin të pashfrytëzuara ose përdoren vetëm në raste të konsideruara si më të rënda. Ky përdorim selektiv tregon një mungesë të qasjes së standardizuar dhe të institucionalizuar për zbatimin e drejtësisë miqësore ndaj fëmijës. Mosshfrytëzimi i rregullt i dhomave miqësore kufizon mundësinë për të mbrojtur fëmijët nga trauma shtesë gjatë procesit të drejtësisë dhe për të respektuar në mënyrë të plotë të drejtat dhe nevojat e tyre emocionale dhe psikologjike.
- **Mungesa e njohurive profesionale në nivel mbështetës:** Një pjesë e konsiderueshme e stafit mbështetës në prokurori dhe gjykata përfshirë: recepsionistët, procesmbajtëset, përkthyesit, zyrtarët ligjorë dhe bashkëpunëtorët profesionalë etj, nuk janë të trajnuar në mënyrë adekuate për të kuptuar rolin

²¹ Udhëzim Administrativ (QRK) -nr. 02/2021 për zbatimin e drejtësisë mike ndaj fëmijës në procedurën penale, civile dhe administrative.

thelbësor që luajnë dhe përgjegjësinë e lartë që mbajnë në ndërveprimet e tyre me fëmijët viktimë dhe dëshmitarë. Kjo mungesë e njohurive dhe përgatitjes profesionale rrit ndjeshëm rrezikun për cenimin e të drejtave të fëmijëve dhe përkeqësimin e përvojës së tyre në kontakt me sistemin e drejtësisë.

- **Dallime ndërmjet të dhënave, si dhe mungesa e të dhënave të kategorizuara:** është evidentuar mungesa e të dhënave të kategorizuara sipas kriterëve të rëndësishme si mosha, gjinia, lloji i veprës dhe aspekte tjera statusore. Për më tepër, në disa raste, të dhënat që ekzistojnë nuk përputhen ndërmjet burimeve të ndryshme, duke vështirësuar analizën dhe monitorimin e saktë të situatës.
- **Bashkëpunimi ndër sektorial i zbehtë:** Bashkëpunimi ndërmjet Policisë, QPS-së, Avokatëve, ZMNV, Prokurorisë dhe Gjykatës në trajtimin e rasteve me fëmijë viktimë dhe dëshmitarë shpesh mbetet formal dhe burokratik, duke munguar koordinimi efektiv dhe i orientuar drejt parimit “fëmija në qendër”. Kjo situatë shkakton procedura të fragmentuara, vonesa dhe rrezik për traumatizim të fëmijëve për shkak të trajtimit të ndarë dhe mungesës së shkëmbimit të informacionit në kohë reale. Për të përmirësuar mbrojtjen e fëmijëve në sistemin e drejtësisë, bashkëpunimi duhet të jetë i integruar, me veprime të përbashkëta, të koordinuara dhe të shpejta, që minimizojnë kontaktet e panevojshme dhe sigurojnë trajtim të ndjeshëm dhe të përshtatshëm për fëmijët gjatë gjithë procesit.

3.2.4. Të gjeturat e përmbledhura që ndërlidhen me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës

Arritjet, sfidat dhe pengesat

Përkundër arritjeve të pakta në zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, si për shembull ngritja e disa mekanizmave institucionalë dhe rritja e ndërgjegjësimit për të drejtat e fëmijës, zbatimi praktik i këtij ligji përballet me sfida dhe pengesa të shumta. Mungesa e infrastrukturës, resurseve njerëzore dhe financiare, kapacitetet e kufizuara të profesionistëve të përfshirë në mbrojtjen e fëmijëve, si dhe koordinimi i dobët ndërmjet institucioneve përgjegjëse, pengojnë funksionimin efektiv të sistemit të mbrojtjes. Zbatimi i dispozitave ligjore shpesh mbetet fragmentar dhe jo i njëtrajtshëm në nivel komunal, duke kufizuar qasjen e barabartë të fëmijëve në shërbime mbrojtëse dhe duke rrezikuar cenimin e të drejtave të tyre themelore.

- **Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës është në përputhje me standardet ndërkombëtare:** Nga analiza e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, rezulton se ky ligj është harmonizuar në masë të konsiderueshme me normat dhe standardet ndërkombëtare dhe evropiane për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Dispozitat e tij promovojnë dhe sigurojnë respektimin e interesit më të mirë të fëmijës, garantojnë mbrojtjen nga çdo formë e keqtrajtimit, dhunës dhe abuzimit, si dhe krijojnë mekanizma për mbështetjen dhe përfshirjen aktive të fëmijëve në proceset që ndikojnë në jetën e tyre. Ligji parashikon masa gjithëpërfshirëse për mbrojtjen ligjore, sociale, shëndetësore dhe psikologjike të fëmijëve, duke krijuar një kornizë të fortë ligjore që përputhet me Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe Direktivat relevante të Bashkimit Evropian.
- **Vonesa në implementimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës:** përkundër miratimit të tij më shumë se gjashtë vite më parë, zbatimi i tij ka qenë i ngadalshëm dhe fragmentar, duke vënë seriozisht në pikëpyetje efektivitetin dhe qëllimin e ekzistencës së këtij ligji në praktikë. Në vend që të shërbejë si bazë solide për ndërtimin e një sistemi funksional të mbrojtjes së fëmijëve, shumë prej dispozitave të tij kanë mbetur të pazbatuara. Një nga vonesat më të dukshme ka qenë miratimi i akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e Ligjit. Edhe pse ky proces është përmbyllur vetëm në vitin e kaluar, zbatimi praktik i këtyre akteve është larg nga ajo që kërkohet me ligj, si në aspektin e strukturave institucionale ashtu edhe në nivelin e burimeve njerëzore dhe financiare. Po ashtu ende nuk janë themeluar dhe krijuar shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës, linja telefonike 24/7, harmonizimi i kurrikulave arsimore dhe trajnimeve akademike. Këto mungesa, së bashku me qasjen joserioze të institucioneve përgjegjëse, kanë penguar jo vetëm zbatimin efektiv të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, por edhe kanë thelluar hendekun midis dispozitave ligjore dhe realitetit në terren, duke e bërë ligjin një instrument kryesisht formal dhe jo funksional në praktikë.
- **Mungesa e njohurive rreth Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës:** një nga shqetësimet më serioze që u evidentua gjatë intervistave me profesionistët është mungesa e njohurive të thelluara rreth Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës. Shumica e profesionistëve të përfshirë në sistemin e drejtësisë për fëmijë nuk janë të familjarizuar në mënyrë të mjaftueshme me përmbajtjen dhe qëllimin e Ligjit. Njohuritë e tyre në këtë drejtim janë shpesh të përgjithshme dhe nuk përfshijnë aftësinë për të përdorur apo referuar në mënyrë aktive dispozitat specifike të këtij ligji gjatë trajtimit të rasteve. Në praktikë, referencat ligjore që përdoren janë thujse ekskluzivisht ato që burojnë nga Kodi i Drejtësisë për të Mitur, duke e lënë Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës në hije, megjithëse ky i fundit ofron bazë të gjerë dhe detyrime konkrete për institucionet publike dhe profesionistët.

- **Mos themelimi i Organit të Kujdestarisë:** paraqet një nga dështimet më të mëdha dhe më të vazhdueshme të sistemit të mbrojtjes së fëmijës në Kosovë. Duke pasur parasysh mandatin thelbësor të Qendrave për Punë Sociale dhe rolin udhëheqës të tyre në mbrojtjen e fëmijës, mungesa e këtij organi për më shumë se dy dekada²² ka bllokuar ose ka dobësuar funksionimin efektiv të një sërë ligjesh të rëndësishme, përfshirë Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, Kodin e Drejtësisë për të Mitur, Ligjin e sapo miratuar për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligji e Familjes etj. Ky boshllëk institucional nuk është vetëm një çështje teknike apo procedurale, është një mungesë sistemike që ka pasur pasoja të drejtpërdrejta dhe të rënda në jetën e fëmijëve. Në mungesë të këtij mekanizmi të domosdoshëm ligjor, janë cenuar të drejtat bazë të fëmijëve për mbrojtje dhe përfaqësim adekuat, duke bërë që në raste të caktuara fëmijët jo vetëm të mos mbrohen, por edhe të rrezikohen më tej nga viktimizimi dytësor.
- **Keqpërdorimi i besimit të fëmijëve:** Shumica e profesionistëve të intervistuar kanë ngritur shqetësime serioze lidhur me faktin se një ndër faktorët kryesorë që ndërlidhet me dhunimin dhe abuzimin seksual të fëmijëve është keqpërdorimi i besimit nga persona të rritur, përmes mashtrimit dhe manipulimit, shpesh duke përfshirë përdorimin e substancave narkotike dhe joshjet përmes komunikimit online. Veçanërisht alarmues është fakti se viktimat në këto raste janë shpesh fëmijë të moshës shumë të re. Për shkak të kufizimeve kohore dhe mungesës së të dhënave të sistemuara dhe të verifikuara, ky konstatim nuk ka mundur të dokumentohet në mënyrë të plotë. Megjithatë, duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrezikshmërinë e lartë të këtij fenomeni, është vlerësuar e domosdoshme përfshirja e tij si një e gjetur e rëndësishme, e shoqëruar më poshtë me një rekomandim përkatës.
- **Autoritetet dhe strukturat qendrore dhe lokale janë pakt të njohura:** Komiteti Ndërmnistror për të Drejtat e Fëmijës, Këshilli për të Drejtat e Fëmijës, Ekipi Komunal për të Drejtat e Fëmijës dhe Tryezat Multidisiplinare për Menaxhimin e Rastit, megjithëse tashmë të themeluara dhe në funksion, mbeten ende shumë pak të njohura nga profesionistët e drejtësisë. Kjo mungesë njohjeje dhe përdorimi i pakët i këtyre mekanizmave paraqet një shqetësim serioz, pasi dobëson koordinimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, duke minuar efektivitetin e mbrojtjes së fëmijëve në sistem.
- **Sfidat në ofrimin e mbrojtjes së përkohshme dhe mungesa e programeve për riintegrim afatgjatë:** Pavarësisht përparimeve në aspektin ligjor dhe rritjes së financimit institucional për strehimoret në vitin 2025, mbeten sfida serioze në zbatimin e plotë të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës

²² Baza ligjore e këtij organi është përcaktuar që në vitin 2004 me miratimin e Ligjit për Familjen Nr.2004/32.

që ndërlidhen me ofrimin e mbrojtjes së përkohshme dhe mbështetjes pas daljes nga strehimoret. Në rastet kur fëmijët nuk mund të qëndrojnë në familje për shkak të rrethanave të rrezikshme, Qendrat për Punë Sociale (QPS), në koordinim me Prokurorinë, janë të obliguara të vendosin fëmijët në forma alternative të kujdesit, siç është strehimi rezidencial. Aktualisht në Kosovë funksionojnë tri strehimore të licencuara për fëmijët viktimë të abuzimit dhe trafikimit, njëra në menaxhim publik dhe dy të tjera nga OJQ-të, të cilat ofrojnë shërbime 24/7 përmes mbështetjes psikologjike, sociale dhe rehabilituese. Megjithatë, një nga boshllëqet më të theksuara sistimore mbetet mungesa e programeve dhe shërbimeve të strukturuar për riintegrimin afatgjatë të fëmijëve pas përfundimit të strehimit rezidencial. Ky boshllëk e bën të vështirë rikthimin e fëmijëve në një jetë të qëndrueshme dhe rrit rrezikun e rikthimit në situata abuzive. Në disa raste, fëmijët përjetojnë një cikël të vazhdueshëm të viktimizimit, duke u kthyer përsëri në strehimore për shkak të mungesës së zgjidhjeve të qëndrueshme.²³

- **Mungesa e punës së strukturuar në fuqizimin e familjes dhe aftësimin prindëror:** Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës parasheh një sërë masash për aftësimin prindëror dhe fuqizimin e familjes në rastet kur fëmija viktimë largohet nga familja dhe vendoset në forma alternative të kujdesit, me synimin të përgatisin prindërit për rikthimin e fëmijës në familje pas përfundimit të masës mbrojtëse. Megjithatë, familjet shpesh nuk marrin mbështetjen e nevojshme. QPS-të përballen me mungesë stafi dhe burimesh, çka e kufizon punën e tyre vetëm në ndërhyrje emergjente dhe menaxhim të rasteve të menjëhershme, duke pamundësuar ndjekjen afatgjatë të procesit të riintegrit.

3.3. Konkluzion

Të gjitha instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale përcaktojnë kritere të qarta përmes të cilave u bëhet thirrje shteteve të sigurojnë mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës. Në këtë drejtim, edhe **legjislacioni dhe politikat aktuale në Kosovë kanë inkorporuar këto standarde** me qëllim garantimin e mbrojtjes së fëmijëve.

Hyrja në fuqi e Kodit të Drejtësisë për të Mitur dhe Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës ka përforcuar kornizën ligjore për mbrojtjen e fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë të dhunës dhe formave të ndërlidhura. Këto ligje janë hartuar në **mënyrë gjithëpërfshirëse, duke rregulluar jo vetëm aspektet materiale dhe**

²³Të dhënat bazohen në informacionin e përditësuar nga organizatat menaxhuese të strehimoreve dhe Qendrat për Punë Sociale, të mbledhura gjatë procesit të vlerësimit.

procedurale, por edhe duke paraparë krijimin e mekanizmave, organeve dhe institucioneve për të adresuar boshllëqet e mëparshme në sistem.

Bazuar në vlerësimin e realizuar, mund të **konstatohet se këto ligje dhe politikat përkatëse kanë kontribuar në ndërtimin e disa komponentëve të sistemit** të drejtësisë për fëmijë në Kosovë. Megjithatë, harmonizimi i tyre me kërkesat dhe standardet ndërkombëtare **mbetet i pjesshëm dhe jo në nivel të kënaqshëm**.

Aktualisht, sistemi i drejtësisë për fëmijë **nuk e promovon në mënyrë aktive dhe të qëndrueshme përdorimin e masave dhe garancive procedurale për mbrojtjen dhe trajtimin e duhur** të fëmijëve gjatë gjithë fazave të procedurës penale, përfshirë edhe periudhën pas përfundimit të saj, që lidhet me rehabilitimin dhe ri-integrimin e fëmijëve në familje dhe shoqëri.

Pavarësisht përparimeve në ndërtimin e pjesshëm të këtij sistemi, vlerësimi ka identifikuar se **zbatimi praktik i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodit të Drejtësisë për të Mitur**, në pjesën që rregullon mbrojtjen e fëmijëve viktimë apo dëshmitarë, **mbetet i kufizuar dhe nuk përputhet plotësisht me qëllimet e ligjvënësit dhe standardet ndërkombëtare**.

Mungesa e njohurive të duhura për këto dy ligje, pastaj vonesat e konsiderueshme në nxjerrjen e akteve nënligjore të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, që kanë tejkaluar afatet ligjore të parashikuara, mos-themelimi i shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve, mungesa e një linje telefonike funksionale për raportim dhe mbështetje, si dhe zbatimi i mangët i dispozitave që parashohin masa mbrojtëse për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë, **kanë ndikuar dukshëm në efektivitetin e punës së profesionistëve dhe kanë pamundësuar zbatimin e plotë** të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, Kodit të Drejtësisë për të Mitur dhe legjislacionit tjetër përkatës. Si pasojë e të gjitha këtyre mangësive, **mbrojtja adekuate e fëmijëve viktimë apo dëshmitarë është vënë në pikëpyetje serioze, duke rrezikuar cenimin e të drejtave të tyre dhe ekspozimin e tyre ndaj viktimizimit të mëtejshëm**.

Konkluzione të ngjashme ka nxjerrë për shtetet anëtare të KDF-së, edhe Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës i cili: *“vlerëson përpjekjet e ndërmarra nga shtetet dhe aktorë të tjerë për parandalimin dhe trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve, por njëkohësisht thekson se **këto përpjekje mbeten, në përgjithësi, të pamjaftueshme**. Kornizat ligjore në shumicën e shteteve nuk ndalojnë plotësisht çdo formë dhune ndaj fëmijëve dhe, **edhe atje ku ekzistojnë ligje adekuate, ato shpesh nuk zbatohen siç duhet**. Qasjet sociale dhe kulturore që normalizojnë dhunën ndaj fëmijëve vazhdojnë të jenë të përhapura, ndërkohë që **politikat dhe masat e marra shpesh janë të fragmentuara dhe reaktive**, duke u fokusuar më shumë në trajtimin e pasojave sesa në adresimin e shkaqeve rrënjësore të dhunës.*

Mungesa e të dhënave, e analizës së mirëfilltë dhe e burimeve adekuate njerëzore dhe financiare përbën një tjetër faktor që kufizon ndikimin real të këtyre përpjekjeve” (Komenti i Përgjithshëm nr. 13, paragrafi 12).

Adresimi i këtyre sfidave është thelbësor për të siguruar që dispozitat ligjore të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodit të Drejtësisë për të Mitur, sidomos ato që lidhen me masat dhe mekanizmat për mbrojtjen e fëmijëve, **të mos mbesin vetëm në letër, por të zbatohen në praktikë**, në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme. Fillimi i **zbatimit të masave të reja, krijimi i mekanizmave** dhe strukturave institucionale, **bugjetimi i shërbimeve** si dhe **ngritja e kapaciteteve profesionale, përbëjnë elemente kyçe për ta përafruar** sistemin e drejtësisë për fëmijë në Kosovë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe për të garantuar mbrojtjen gjithëpërfshirëse të fëmijëve në kontakt me ligjin.

Për të mbështetur zbatimin e të gjeturave të identifikuara, **vlerësimi përmban një sërë rekomandimesh** që synojnë të ndihmojnë institucionet e drejtësisë, dhe jo vetëm ato, në forcimin e zbatimit të sistemit të drejtësisë për fëmijë dhe në sigurimin që ky sistem të ofrojë mbrojtjen e synuar për fëmijët, përmes një zbatimi efikas të masave dhe mekanizmave për mbrojtjen e tyre.

3.4. Rekomandimet

Për të adresuar sfidat dhe pengesat e evidentuara gjatë vlerësimit të zbatimit të masave për mbrojtjen e fëmijëve viktimë apo dëshmitarë në Kosovë, rekomandohet ndërmarrja e një sërë veprimesh konkrete që synojnë përmirësimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi. Këto veprime duhet të garantojnë një qasje më efektive, të drejtë dhe të qëndrueshme ndaj mbrojtjes së fëmijëve në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë jo vetëm zbatimin e ligjeve ekzistuese, por edhe forcimin e masave mbështetëse dhe garancive procedurale që sigurojnë mbrojtjen e plotë të të drejtave të fëmijës në çdo fazë të procedurës.

3.4.1. Rekomandimet afatshkurta:

■ **Funksionalizimi dhe fuqizimi i institucioneve, mekanizmave dhe këshillave që derivojnë nga LMF:** Ministria e Drejtësisë dhe komunat, të ndërmarrin masa të menjëhershme për:

- themelimin dhe funksionalizimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve,
- krijimin e linjës telefonike,
- themelimin e organeve të kujdestarisë,
- fuqizimin e këshillave,
- sigurimin që të gjitha materialet trajnuese dhe edukative për profesionistët

të jenë të harmonizuara dhe në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës (LMF).

- **Krijimi dhe funksionalizimi i një fondi emergjent:** Komunat duhet të planifikojnë dhe alokojnë buxhetin për krijimin e fondit emergjent të përhershëm për ofrimin e ndërhyrjeve të menjëhershme, si strehimi emergjent, përkrahja psikologjike dhe mjekësore, transporti i sigurt, apo përmbushja e nevojave themelore të fëmijës. Për këtë qëllim, është e nevojshme që komuna të zbatojë në mënyrë të plotë obligimet ligjore për ndarjen e buxhetit të dedikuar dhe të forcojë bashkëpunimin ndër sektorial për të garantuar mbrojtje efektive dhe të barabartë për çdo fëmijë, pa dallim vendbanimi.
- **Ndihma dhe mbështetja e fëmijës në procedurën post-gjyqësore:** Qendra për Punë Sociale duhet ta koordinojë procesin e rehabilitimit emocional dhe psikologjik, si dhe reintegrimin në mjedisin familjar, shkollor dhe shoqëror. Këto janë procese delikate që kërkojnë: a) përfshirje të qëndrueshme dhe të koordinuar të profesionistëve të shëndetit mendor, punëtorëve socialë, psikologëve shkollorë dhe aktorëve të tjerë lokalë; b) mbështetje dhe edukim të anëtarëve të familjes, që të kenë kapacitete për të qenë faktor mbështetës e jo shtesë rreziku; c) qasje të vazhdueshme në shërbime rehabilituese dhe sociale, që e ndihmojnë fëmijën të zhvillojë strategji përballuese dhe të rimëkëmbet nga trauma.
- **Të zhvillohen mekanizma monitorues dhe hetues:** të specializuar për identifikimin dhe parandalimin e abuzimeve që përfshijnë manipulimin e fëmijëve përmes substancave narkotike dhe platformave digjitale. Njëkohësisht të investohet në programe edukimi dhe vetëdijesimi për fëmijët dhe prindërit për rreziqet që lidhen me komunikimin online dhe ndërtimin e marrëdhënieve të rrezikshme me të rritur.
- **Zbatimi efektiv i parimit të urgjencës dhe fuqizimi ndër-institucional:** të gjitha institucionet që janë në kontakt me fëmijën duhet të sigurojnë zbatimin e parimit të urgjencës në trajtimin e rasteve që përfshijnë fëmijët viktime dhe dëshmitarë, duke rritur nivelin e koordinimit ndër-institucional në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Të gjithë profesionistët e përfshirë, përfshirë organet e drejtësisë, shërbimet sociale, policia, institucionet shëndetësore dhe edukative duhet të veprojnë sipas parimit “fëmija në qendër” dhe “profesionistët tek fëmija”, duke garantuar një qasje të integruar, të ndjeshme dhe të koordinuar në çdo hap të procesit.

- **Përdorimi pa përjashtime i teknologjisë dhe profesionistëve:** të gjithë fazat e procedurës penale që përfshijnë fëmijët viktimë të zhvillohen me ndihmën e teknologjisë së disponueshme në prokurori dhe gjykata, si dhe nën asistimin e psikologëve dhe profesionistëve të tjerë përkatës. Përdorimi i teknologjisë, përfshirë intervistat në distancë dhe video-regjistrimin e deklaratave apo dëshmimeve, mundëson shmangien e kontaktit të drejtpërdrejtë me të dyshuarin dhe redukton ekspozimin e fëmijës ndaj mjediseve traumatizuese. Përfshirja e psikologëve dhe ekspertëve të tjerë siguron një qasje të ndjeshme ndaj moshës dhe gjendjes emocionale të fëmijës, duke kontribuar në mbrojtjen e mirëqenies së tij dhe në sigurimin e një dëgjimi të drejtë, të përshtatshëm dhe jo traumatizues gjatë gjithë procesit penal.
- **Zhvillimi i programeve të strukturuar për riintegrim afatgjatë të fëmijëve viktimë:** Rekomandohet që institucionet përgjegjëse, të zhvillojnë dhe financojnë programe të qëndrueshme për riintegrimin afatgjatë të fëmijëve viktimë. Këto programe duhet të synojnë krijimin e kushteve për një jetë të qëndrueshme dhe të parandalojnë rikthimin e fëmijëve në ciklin e viktimizimit.
- **Zbatimi i masave për aftësimin prindëror dhe fuqizimin e familjes:** Si pjesë e përgatitjes për rikthimin e fëmijës viktimë në mjedisin familjar pas përfundimit të masës mbrojtëse, rekomandohet komunat të investojnë në fuqizimin e kapaciteteve të Qendrave për Punë Sociale, duke rritur numrin e stafit profesional dhe burimet e nevojshme për ndjekjen sistematike dhe afatgjatë të rasteve, me qëllim që ndërhyrja të mos jetë vetëm emergjente, por shërbimet të vazhdojnë deri në rehabilitim dhe reintegrim afatgjatë.
- **Zbatimi i rregullores Nr. 18/2024:** Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duhet ti jepë prioritet zbatimit dhe mbikëqyrjes të vazhdueshme dhe serioze për krijimin dhe funksionalizimin regjistrat të personave të dënuar për vepra penale kundër integritetit seksual. Ky regjistër është një mekanizëm thelbësor për mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimin e përfshirjes së personave të dënuar në role të cenueshme për sigurinë e tyre dhe sigurinë publike. Regjistri duhet të jetë funksional, lehtësisht i përdorshëm nga autoritetet kompetente dhe të administrohet në përputhje me standardet për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtave të njeriut.
- **Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore.** Të gjitha institucionet e përfshira në procedurat ku fëmijët janë viktimë dhe dëshmitarë duhet të fuqizohen përmes rritjes së kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore. Në veçanti, është urgjente plotësimi i mungesave me staf të trajnuar, sidomos në shërbimet sociale dhe me psikologë, të cilët duhet të jenë të përfshirë në mënyrë të përhershme dhe të vazhdueshme në procesin gjyqësor. Po ashtu,

duhet të sigurohen burimet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve mbështetëse si: shërbime psikologjike, përkujdesja mjekësore dhe psikiatrike, mbrojtja gjatë procedurave gjyqësore, mbështetja sociale dhe edukative, si dhe programet për ri integrim.

- **Kompensimi i dëmit dhe mbështetja pas-gjyqësore duhet të shkojnë përtej aspektit monetar.** Gjykatat, gjatë vendimmarrjes për kompensimin e dëmit, nuk duhet të kufizohen vetëm në elementët pasurorë, por të marrin parasysh edhe masat jo pasurore të riparimit të dëmit për fëmijët viktimë. Aty ku është e mundur, vendimi gjyqësor duhet të garantojë qasje në mbështetje psikologjike, përkujdesje mjekësore dhe shërbime psikiatrike sipas nevojës; mbështetje për rehabilitim edukativ dhe social për të mundësuar një ri integrim të qëndrueshëm; si dhe zhvillimin e aftësive për jetë përmes trajnimeve dhe përkrahjes arsimore e sociale, në mënyrë që të forcohet autonomia dhe vetëbesimi i fëmijës. Institucionet e tjera përkatëse duhet të mbështesin fëmijën në zbatimin e vendimit gjyqësor dhe të ofrojnë mundësi shtesë mbështetjeje, aty ku kjo është e realizueshme.
- **Specializimi i profesionistëve për mbrojtjen e fëmijës:** të gjitha institucionet që punojnë në sistemin e drejtësisë për fëmijë, përfshirë Policinë, Avokatinë, ZMN, Shërbimet Sociale-QPS-të, Prokuroritë, Gjykatat, si dhe çdo profesionist tjetër që është në kontakt me fëmijët, duhet të angazhohen në zhvillimin dhe caktimin e profesionistëve të specializuar për fëmijë viktimë apo dëshmitarë. Kjo duhet të bëhet përmes programeve atraktive dhe gjithëpërfshirëse të trajnimeve, duke përfshirë edhe sistemin e trajnimeve të detyrueshme dhe certifikimeve. Njëkohësisht, është e nevojshme të zhvillohen mekanizma motivues dhe mbështetës që sigurojnë qëndrueshmëri dhe angazhim afatgjatë të këtyre profesionistëve në pozitat përkatëse;
- **Personi mbështetës:** Në rast se QPS-të nuk kanë mundësi për të punësuar një person të dedikuar për këtë rol, atëherë duhet të parashikohet përgatitja e përkohshme e stafit aktual për të marrë përsipër këtë funksion, duke u pajisur me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për përmbushjen e përgjegjësisë të përcaktuara në Kornizën e Drejtësisë për të Mitur.
- **Fushata vetëdijësuese dhe informuese:** të gjitha institucionet e drejtësisë të zhvillojnë dhe zbatojnë programe të rregullta vetëdijësimi dhe informimi për stafin e tyre, në mënyrë që të rritet njohuria dhe kuptimi i thellë i qëllimeve dhe parimeve të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

3.4.2. Rekomandimet afat mesme dhe afat gjate:

- **Vazhdimësia e nxjerrjes së raporteve ex-officio:** Institucioni i Avokatit të Popullit të sigurojë vazhdimësinë e hetimit dhe monitorimit ex-officio, si dhe të publikimit të raporteve për rastet që përfshijnë fëmijët viktime apo dëshmitarë. Aty ku është e mundur, ky institucion duhet të ndjekë edhe ndonjë proces gjyqësor nga fillimi deri në përfundim, me qëllim të vlerësimit nga afër të zbatimit të dispozitave ligjore dhe garantimit të të drejtave të fëmijëve në praktikë. Kjo qasje do të siguronte një mekanizëm të pavarur mbikëqyrës, do të ndihmonte në identifikimin e mangësive dhe do të kontribuonte në propozimin e masave konkrete për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të drejtësisë për fëmijë.
- **Të zhvillohen trajnime të detyrueshme dhe të përshtatura:** për të gjithë stafin mbështetës (receptionistët, përkthyesit gjyqësorë, procesmbajtëset, zyrtarët ligjorë, bashkëpunëtorët profesional) në institucionet e drejtësisë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për qasjen e ndjeshme ndaj fëmijëve viktime dhe dëshmitarë dhe për forcimin e standardeve të sjelljes profesionale.
- **Fuqizimi i qasjes për fëmijët me aftësi të kufizuara:** Këshilli Prokurorial dhe Këshilli Gjyqësor duhet të sigurojnë zbatim të plotë dhe monitorim sistematik të përdorimit të pajisjeve për komunikim në gjuhën e shenjave në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë. Duhet të realizohen vlerësime të rregullta të ndikimit të këtyre pajisjeve në përmirësimin e qasjes në drejtësi për fëmijët me aftësi të kufizuara, si dhe të zhvillohen trajnime të detyrueshme për përdorimin efektiv të tyre. Po ashtu, rekomandohet zgjerimi i këtyre masave në të gjitha institucionet relevante, përfshirë policinë dhe qendrat për punë sociale, për të garantuar mbështetje gjithëpërfshirëse për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara.
- **Realizimi i studimit apo hulumtimit:** Ministria e Drejtësisë, në partneritet me universitetet dhe institucionet hulumtuese vendore, duhet të ndërmarrë një studim kombëtar gjithëpërfshirës mbi fëmijët që përfshihen si viktime dhe dëshmitarë të veprave penale, me fokus të veçantë në ato që prekin integritetin seksual të fëmijës. Ky hulumtim duhet të synojë: a) Vlerësimin e përmasave dhe trendeve të përfshirjes së fëmijëve si viktime dhe dëshmitarë në vepra penale kundër integritetit seksual; b) Përpilimin e një profili socio-demografik të këtyre fëmijëve (mosha, gjinia, statusi arsimor, familjar dhe ekonomik); c) Identifikimin e faktorëve dhe shkaqeve që ndikojnë në mashtrimin, manipulimin apo keqpërdorimin e besimit të fëmijëve nga persona të rritur, përfshirë përdorimin e substancave narkotike dhe teknologjisë digjitale; d) Analizën e masave mbrojtëse të ndërmarra deri më tani, vlerësimin e efektivitetit të tyre dhe identifikimin e boshllëqeve ekzistuese në sistemin aktual të drejtësisë për fëmijë.

- **Zbatimi i plotë dhe i qëndrueshëm i konceptit të drejtësisë miqësore për fëmijët:** gjatë gjithë fazave të procedurës. Kjo përfshin përdorimin sistematik të dhomave miqësore të pajisura dhe të dizajnuara posaçërisht për të ofruar një ambient të sigurt, të qetë dhe jo-frikësues për fëmijën, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira. Koncepti duhet të zbatohet nga profesionistë të trajnuar, duke respektuar moshën, gjininë, pjekurinë psikologjike dhe nevojat emocionale të fëmijës, me qëllim që të shmanget ri viktimizimi dhe të garantohet dëgjimi i fëmijës në mënyrë të ndjeshme dhe efektive. Zbatimi i këtij koncepti duhet të përfshijë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe sigurimin e kapaciteteve të nevojshme teknike dhe njerëzore për një qasje sa më gjithëpërfshirëse dhe mbrojtëse ndaj fëmijëve në proceset e drejtësisë.
- **Zhvillimi i modulit për parimet për mbrojtjen e fëmijës:** të zhvillohet një modul i veçantë trajnues pranë Akademisë së Drejtësisë dhe Institutit Kosovar për Administratë Publike, i dedikuar për zbatimin e drejtë dhe kuptimplotë të parimeve themelore për mbrojtjen e fëmijës, me theks të veçantë në parimin e interesit më të mirë të fëmijës. Ky modul duhet të përfshijë udhëzime praktike dhe shembuj konkretë për aplikimin e këtyre parimeve në të gjitha hallkat e sistemit të drejtësisë dhe shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, duke siguruar që vendimmarrja të jetë gjithmonë e ndjeshme ndaj nevojave, moshës dhe mirëqenies së fëmijës.
- **Përmirësimi i njohurive të aktorëve të drejtësisë për fëmijë:** të organizohen seri trajnimesh individuale dhe të përbashkëta për policë, avokatë, mbrojtës të viktimave, zyrtarë të shërbimeve sociale, përfaqësues të strehimoreve, prokurorë, gjyqtarë. Këto trajnime duhet të fokusohen në zbatimin e duhur të dispozitave ligjore që rrjedhin nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Kodit i Drejtësisë për të Mitur, me theks të veçantë në risitë që këto ligje sjellin në praktikë. Qëllimi është harmonizimi i qasjes ndërinstitucionale dhe forcimi i kapaciteteve për të siguruar një sistem drejtësie më mbrojtës, gjithëpërfshirës dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të fëmijës.
- **Të sigurohet zbatimi i drejtë i konceptit të qasjes në drejtësi për fëmijët:** duke ri menduar mënyrën se si trajtohet roli i tyre në sistemin e drejtësisë. Profesionistët që punojnë në mbrojtjen e fëmijëve duhet të kalojnë nga një qasje që e sheh fëmijën si subjekt të varur, në një qasje që e njeh fëmijën si individ me të drejta të plota. Kjo përfshin njohjen dhe garantimin e të drejtës së tij për pjesëmarrje aktive në procedurat që e prekin, të drejtën për të shprehur mendimin e vet, si dhe për të marrë vendime në përputhje me moshën dhe pjekurinë. Një qasje e tillë jo vetëm që përforcon subjektivitetin juridik të

fëmijës, por edhe harmonizohet me standardet ndërkombëtare, veçanërisht me Konventën për të Drejtat e Fëmijës.

- **Përmirësimi i mbledhjes dhe harmonizimit të të dhënave statistikore:** institucionet e drejtësisë të sigurojnë mbledhjen sistematike dhe të përditësuar të dhënave të kategorizuara sipas kriterëve relevante, si mosha, gjinia, lloji i veprës penale dhe statusi i fëmijës (viktimë apo dëshmitar). Po ashtu, është thelbësore që të harmonizohen formatet dhe metodologjitë e raportimit ndërmjet institucioneve për të shmangur mospërputhjet dhe për të mundësuar një analizë dhe monitorim të saktë dhe të krahasueshëm të situatës. Kjo do të kontribuonte në planifikimin më të mirë të ndërhyrjeve dhe politikave për mbrojtjen e fëmijëve në sistemin e drejtësisë.

3.5. Praktikrat e mira

Përkundër sfidave të shumta në zbatimin e legjislacionit respektivisht masave për mbrojtjen e fëmijës, vlerësimi ka gjetur se në sistemin e drejtësisë për të fëmijë ka edhe praktika të mira të cilat duhet të fuqizohen dhe replikohen sa më shumë që të jetë e mundur. Këto janë disa nga praktikrat e mira:

1. Nxjerrja e raporteve ex-officio nga Institucioni i Avokatit të Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërmarrë iniciativa për të hetuar dhe monitoruar raste që përfshijnë fëmijët viktimë, përmes kompetencës ex-officio që derivon nga Ligji për IAP. Kjo praktikë ndihmon në zbardhjen e shkeljeve sistematike dhe të përsëritura ndaj të drejtave të fëmijëve, si dhe në nxjerrjen në pah të pengesave strukturore dhe institucionale që ndikojnë në mbrojtjen efektive të tyre. Raportet e tilla janë të rëndësishme për të ndikuar në përmirësimin e politikave publike dhe për të promovuar llogaridhënien në raste të ndjeshme që përfshijnë fëmijët.

2. Krijimi i infrastrukturës dhe ambienteve miqësore

Disa institucione kyçe, si policia, prokuroria dhe gjykatat, kanë filluar krijimin e dhomave dhe hapësirave miqësore për fëmijët, të cilat janë të dizajnuara për të minimizuar stresin dhe traumën gjatë ndërveprimit të fëmijës me sistemin e drejtësisë. Këto ambiente të veçanta janë më të ngrohta, të sigurta dhe më pak lënduese krahasuar me hapësirat tradicionale të bazuara në zyre. Kjo praktikë e bën procesin më të pranueshëm për fëmijët dhe ndihmon në krijimin e një atmosfere ku ata mund të ndihen të dëgjuar dhe të mbrojtur. Ky model duhet të institucionalizohet dhe të shtrihet në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha

institucionet përkatëse për të garantuar qasje të barabartë dhe cilësore për të gjithë fëmijët.

3. Përfaqësimi ex-officio dhe angazhimi i mbrojtësve të viktimave

Zbatimi i përfaqësimit ex-officio për fëmijët viktimë, nga ana e avokatëve si dhe përfaqësimit nga ana e mbrojtësve të viktimës, përbën një avancim të rëndësishëm në garantimin e të drejtave procedurale dhe substanciale të fëmijëve në sistemin penal. Këta përfaqësues profesionalë ofrojnë ndihmë ligjore, e cila ndihmon fëmijët që të përballen me procedurat komplekse gjyqësore, të kuptojnë të drejtat e tyre dhe të mbrohen nga ekspozimi ndaj situatave të rrezikshme apo traumatizuese. Kjo praktikë jo vetëm që duhet të vazhdohet, por edhe të përforcohet përmes trajnimeve të specializuara për këta profesionistë dhe vlerësimit të rregullt të cilësisë së shërbimeve të ofruara.

4. Ndryshimi i formës së intervistimit nga Instituti i Mjekësisë Ligjore

Instituti i Mjekësisë Ligjore ka ndërmarrë hapa për të ndryshuar metodologjinë e intervistimit të fëmijëve, duke synuar shmangien e intervistimit të shumëfishtë dhe të panevojshëm. Kjo qasje ndihmon në ruajtjen e mirëqenies psikologjike të fëmijëve, zvogëlon traumën sekondare dhe siguron që dëshmitë të merren në një mënyrë më humane, të ndjeshme dhe të përshtatshme për moshën. Përdorimi i intervistave të strukturuar dhe regjistrimi i tyre për përdorim të mëvonshëm në procesin penal është një praktikë që duhet të bëhet standard në të gjitha rastet që përfshijnë fëmijët viktimë apo dëshmitarë. Kjo praktikë gjithashtu ndihmon në forcimin e provave në gjykim dhe në shmangien e ritraumatizimit të fëmijëve.



KAPITULLI IV:

ANEKSE

4.1. Burimet e referencave

Legjislacioni vendor

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve (Ligji nr. 06/L-084)
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur (Kodi nr. 06/L-006)
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Kodi nr. 06/L-074) dhe Ligji nr. 08/L-188 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit Penal nr. 06/L-074
- Kodi i Procedurës Penale (Kodi nr. 08/L-032) dhe Ligji nr. 08/L-187 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale nr. 08/L-032
- Ligji për Familjen (Ligji nr. 2004/32)
- Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare (Ligji nr. 08/L-255)
- Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore (Ligji nr. 08/L-185)
- Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit (Ligji nr. 04/L-218)
- Rregullorja (QKR) nr. 18/2024 për përcaktimin e procedurave efektive për identifikimin, raportimin dhe referimin e shfrytëzimit, neglizhencës dhe abuzimit ndaj fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë ruge
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 03/2024 për bashkëpunimin e strukturave dhe mekanizmave institucionalë me OJQ-të për zbatimin e politikave të të drejtave dhe ofrimit të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve
- Rregullorja (QKR) nr. 07/2024 për organizimin dhe fushëveprimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve
- Rregullorja (QKR) nr. 23/2023 për procedurat e punës në tryezat shumë disiplinore për ndihmë në menaxhimin e rasteve
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 06/2023 për përcaktimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse për të ndaluar pjesëmarrjen e fëmijëve në klube nate dhe hapësira të ngjashme
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 05/2023 për masat për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi me drogë
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 04/2023 për trajtimin mjekësor dhe psikologjik të fëmijëve viktimë të abuzimit, për rehabilitim dhe ri-integrim
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 08/2022 për Këshillin për të Drejtat e Fëmijës
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 07/2022 për autoritetet për të drejtat e fëmijës
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës

- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 04/2022 për masa për mbrojtjen e fëmijëve nga faqet e internetit me përmbajtje pornografike dhe që dëmtojnë shëndetin dhe jetën e fëmijës
- Udhëzimi Administrativ (QKR) nr. 02/2021 për zbatimin e drejtësisë miqësore për fëmijët në procedurat penale, civile dhe administrative.

Instrumentet Ndërkombëtare:

- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (ECHR), ETS Nr. 5, 1950 dhe Protokollet
- Konventa e Këshillit të Evropës për Veprim Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore
- Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual
- Protokolli Opsional për Konventën për të Drejtat e Fëmijës mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë me fëmijë
- Direktiva 2011/93/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për luftimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë
- Direktiva 2012/29/BE për standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit
- Direktiva 2011/36/BE për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave
- Direktiva 2016/800/BE për garancitë procedurale për fëmijët që janë të dyshuar ose të akuzuar
- Strategjia e BE për të Drejtat e Fëmijëve (2021–2024)
- Udhëzimet e Këshillit të Evropës për Drejtësi Miqësore për Fëmijët (2010)
- Rekomandimi CM/Rec (2018)7 për të drejtat e fëmijëve në ambientin digjital
- Rekomandimi CM/Rec (2012)2 për pjesëmarrjen e fëmijëve nën 18 vjeç
- Rekomandimi CM/Rec (2011)12 për të drejtat e fëmijëve dhe shërbime sociale miqësore
- Udhëzime për kujdes shëndetësor miqësor për fëmijët (2011)
- Rekomandimi CM/Rec (2009)10 për strategji të integruara për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna
- Rekomandimi R (98)8 për pjesëmarrjen e fëmijëve në jetën familjare dhe shoqërore
- Komentet e Përgjithshme të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve (Nr. 1, 5, 6, 8, 10, 12)
- Rezoluta 2002/12 mbi Parimet Themelore për përdorimin e Programeve të Drejtësisë Restauruese në çështje penale

Instrumentet ndërkombëtare, protokolle, strategji, libra, studime dhe raporte

- Protokolli shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale (Vendimi i Qeverisë nr. 11/109, datë 23.11.2022)
- Raporti vjetor i Institucioni të Avokatit të Popullit (vitet 2023 dhe 2024)
- Raport ex-officio Rasti nr.381/2020 në lidhje me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës (nr.protokoli 1213/2021 datë 17.08.2021)
- Raport ex-officio nr.468/2022 Detyrimet pozitive të shtetit për mbrojtjen e fëmijës nga dhuna (nr.protokoli 607/2023 datë 03.04.2023)
- Raport ex-officio nr.37/2023 në lidhje me themelimin e organit të kujdestarisë (nr.protokoli 1654/2023 datë 12.10.2023)
- Kartelat e Raportit KOMF për kujdesin ndaj fëmijëve (2023, 2024)
- Vlerësimi i mbështetjes së BE-së për drejtësinë për të mitur në Kosovë (Raport përfundimtar 2018)
- Korniza Ligjore për të Drejtat e Fëmijës në Kosovë (UNICEF, 2014)
- Strategjia për Mbrojtjen e Fëmijëve 2021–2030 (UNICEF)
- Reimagine Justice for Children (UNICEF, 2021)
- Vlerësimi i sistemeve administrative të të dhënave për drejtësinë për fëmijët (UNICEF, 2021)
- Qasja e barabartë e fëmijëve në drejtësi – Evropa Qendrore dhe Lindore (UNICEF, 2015)
- Strategjia Sektoriale për Punë dhe Mirëqenie Sociale (2018–2022)
- Standardet Minimale për Shërbimet Sociale (Standardet 1, 2, 3, 6 dhe 13)
- Hartimi dhe Vlerësimi i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Kosovë (Zyra e Kryeministrit, 2012)
- Raportet e Komisionit Evropian për Kosovën (2016–2024)
- Kompensimi i viktimave të dhunës në familje (Instituti i Kosovës për Drejtësi & CLARD, 2023)
- Vlerësimi i trajtimit të rasteve të dhunës seksuale nga sistemi i drejtësisë në Kosovë (EULEX, 2022)
- Raportet e EULEX për Monitorimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë (2021–2024)
- Drejtësi e orientuar drejt fëmijës – Parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës ndaj fëmijëve në sistemet e drejtësisë për fëmijë (PRI, TDH, AIMJF, 2025)
- African Charter on Human and Peoples' Rights, 27 June 1981, CAB/LEG/67/3 rev. 5, 21 I.L.M. 58 (1982)
- Cappelaere, G., Grandjean, A., Naqvi, Y., *Children Deprived of Liberty: Rights and Realities*, Editions Jeunesse et Droit, 2005

- Children's Legal Centre and United Nations Children's Fund, 'Administrative Detention of Children: A Global Report', New York, 2011
- Cipriani, D., 'Children's Rights and the Minimum Age of Criminal Responsibility: A Global Perspective', Ashgate, 2009
- Ellison, Louise, 'Cross-examination and the intermediary: bridging the language divide?', *Criminal Law Review*, 114, 118, 2002
- Inter-Parliamentary Union and United Nations Children's Fund, 'Child Protection: A handbook for Parliamentarians, Inter-Parliamentary Union, No. 7', Geneva, 2004
- Johnstone, G., 'Restorative Justice: Ideas, Values, Debates', 2002
- Klaus, J.F., Handbook on Probation Services: Guidelines for Probation Practitioners and Managers, United Nations
- Morris, A. and Maxwell, G., 'Restorative Justice in New Zealand: Family Group Conferences as a Case Study', *Eastern Criminology Review*, 1998
- F. Ross, M. P. Togliatti, *Perspectives on Children's Testimony*, New York: Springer Verlag, 1989
- Seymour, J., *Dealing with Young Offenders*, The Law Book Company, Sydney, 1988. United Nations
- United Nations Office on Drugs and Crime, Model Law on Juvenile Justice, 2011
- United Nations Office on Drugs and Crime and UN-Habitat, 'Crime Prevention Assessment Tool', United Nations, New York, 2009.

4.2. Lista e profesionistëve të intervistuar, takimet e zhvilluara dhe grupet fokusit

Emri dhe Mbiemri	Pozita/Institucioni
1. Anita Kalanderi	Sekretare e Përgjithshme Ministria e Drejtësisë
2. Blerim Shabani	Drejtor i Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare - Ministria e Drejtësisë
3. Qëndresa Ibra-Zariqi	Zyrtare e Lartë për të Drejtat e Fëmijës Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë
4. Adile Basha-Shaqiri	Udhëheqëse e Divizionit për Shërbime Sociale-DPSF Ministria e Drejtësisë
5. Adnan Isufi	Gjyqtar për të Mitur Gjykata Themelore Prishtinë
6. Lumnije Krasniqi	Gjyqtare për të Mitur Gjykata Themelore Prishtinë
7. Sahit Boroci	Gjyqtar për të Mitur Gjykata Themelore Gjilan
8. Mimoza Shala	Prokurore për të Mitur Prokuroria Themelore në Prishtinë
9. Rabije Jakupi	Prokurore për të Mitur Prokuroria Themelore Gjilan
10. Isuf Sadiku	Prokuror i Shtetit Prokuroria Themelore në Gjilan
11. Baki Gimolli	Këshilltar i Lartë Juridik Institucioni i Avokatit të Popullit
12. Ramadan Ahmeti	Drejtor i Policisë në Bashkësi Policia e Kosovës
13. Luljeta Limani Sylejmani	Drejtor Parandalimi dhe Hetimi i Dhunës në Familje - Policia e Kosovës
14. Nilgyn Kosova	Shef i Sektorit për Parandalim të Delikuencës së të Miturve - Policia e Kosovës
15. Dr.Bergita Curri	Specialiste e Mjekësisë Ligjore Instituti për Mjekësinë Ligjore

16. Burhan Maxhuni	Menaxher i zyrës Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmë Viktimave
17. Yll Zekaj	Avokat me seli në Prishtinë
18. Sherif Sherifi	Avokat me seli në Gjiilan
19. Abaz Gjigolli	U.D Drejtor Asociacioni i Qendrave për Punë Sociale
20. Mursel Zymberi	Drejtor Qendra për Punë Sociale në Gjiilan
21. Makfirete Shamolli	Drejtor Qendra për Punë Sociale - Lipjan
22. Amir Bushi	Drejtor Qendra për Punë Sociale - Hani i Elezit
23. Arrita Dervishi	Zyrtare e Shërbimeve Sociale Qendra për Punë Sociale Gjakovë
24. Berlina Dushi	Zyrtare e Shërbimeve Sociale Qendra për Punë Sociale Gjakovë
25. Teuta Abrashi	Drejtoreshë Ekzekutive - Qendra MVPT
26. Arilona Kastrati	Zyrtare - Qendra MVPT
27. Gresa Kelmendi	Menaxhere Programi - MVPT
28. Afërdita Kçiku	Psikologe klinike - QKMF Gjiilan
29. Dren Rexha	Specialist i Politikave Sociale - UNICEF
30. Feride Dashi	Zyrtare për Mbrojtjen e Fëmijëve - UNICEF
31. Donjeta Kelmendi	Drejtoreshë Ekzekutive - KOMF
32. Klevis Vaçari	Menaxhere Projektesh - KOMF
33. Fjolla Hoxha	Menaxher e Programit të Drejtësisë - TDH
34. Jussi Valtteri Ohisalo	Justice Monitor - Case Monitoring Unit EULEX
35. Verginiya Micheva-Ruseva	Justice Monitor - Case Monitoring Unit EULEX

